

1 E premte, 22 prill 2022

2 [Seancë e hapur]

3 [I akuzuari hyn në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca fillon në orën 9.30

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

6 Mirëmëngjesi.

7 Znj. Sekretare, ju lutem paraqitni lëndën.

8 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar
9 Gjykatës. Ko është lënda me numër KSC-BC-2020-05, Prokurori i
10 Specializuar kundër Salih Mustafës.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

12 Faleminderit.

13 Së pari, u kërkoj të pranishmëve të prezantohen.

14 Z. Prokuror, kush janë të pranishëm?

15 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Mirëdita. Sivlia D'Ascoli,
16 Ndhmësprokurore; Julie Mann, menaxheri i lëndës; Filippo De
17 Minicis, Ndhmësprokuror, paraqiten në emër të Prokurorisë
18 sot.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

20 Mbrojtësja e Viktimave keni fjalën.

21 ZNJ. PUES: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar Gjykatës.

22 Mirëdita të gjithëve. Viktimat pjesëmarrëse sot përfaqësohen
23 nga Brechtje Vossenberq bashkëmbrojtësja ime dhe unë vetë,
24 Anni Pues si Mbrojtëse.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

1 Avokat keni fjalën.

2 Z. VON BONE: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar Gjykatës.
3 Mbrojtja përfaqësohet sot nga Bashkëmbrojtësi im z. Betim
4 Shala; unë vetë Julius von Bone; përkthyes dhe hetues Fatmir
5 Pelaj. Dhe në sallë është i pranishëm edhe z. Mustafa, i
6 akuzuari.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
8 Faleminderit. Për procesverbalin, ky proces zhvillohet përpara
9 Trupit Gjykses numër 1.

10 Përpara se të vijojmë me dëshminë e Dëshmitarit 1400, do
11 të lëshoj një urdhër gojarisht në emër të Trupit Gjykses. Ky
12 urdhër i drejtohet ZPS-së.

13 Trupi Gjykses vëren parashtrimin e protokolluar të ZPS-së
14 me numër 376, njoftim i ZPS-së i nxjerrjes sipas Rregullës
15 102(1)(b) dhe kërkesa e lidhur, këtej e tutje e quajtur
16 kërkesa e datës 8 prill 2022, në të cilën ZPS-ja jep njoftim
17 të nxjerrjes së materialit të ri që janë nota zyrtare ku
18 shënohen deklarata e marrë rishtazi nga një dëshmitar në këtë
19 çështje gjyqësore. Materiali i ri jepet në Shtojcën 1 të
20 kërkesës duke pasur parasysh skadimin e afatit kohor për
21 nxjerrjen e materialit sipas Rregullës 102(1)(b) që është
22 vendosur nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake, si data 1
23 dhjetor 2020, ZPS-ja i kërkon Trupit Gjykses leje që të
24 nxjerrë zyrtarisht materialin e ri, sipas Rregullës 102(1)(b).

25 Mbrojtja nuk i është përgjigjur kërkesës.

1 Trupi Gjykues vëren se, materiali i ri lind nga kontaktet
2 e nisura nga vetë dëshmitari në lidhje me zhvillimin e
3 seancave gjykuese. Dhe se ZPS-ja e ka marrë këtë material jo
4 më parë se data 25 mars 2022 dhe ky material i ri nuk ka qenë
5 i disponueshëm përpara skadimit të afatit për nxjerrjen e
6 materialeve të Rregullës 102(1)(b).

7 Krahas kësaj, Trupi Gjykues vëren se materiali i ri ka
8 lidhje me akuzat e ngritura duke qenë se lidhet me ngjarjet që
9 pretendohet që kanë ndodhur në kompleksin e ndalimit.

10 Rrjedhimisht, Trupi Gjykues konstaton e ZPS-ja ka dhënë
11 arsye për nxjerrje me vonesë të materialit të ri dhe autorizon
12 ZPS-në që të nxjerrë zyrtarisht materialet e renditura në
13 Shtojcën 1 të kërkesës, sa më shpejt.

14 Trupi Gjykues, gjithashtu i jep urdhër ZPS-së që të
15 dorëzojë një listë të përditësuar të provave materiale,
16 përfshirë materialin e ri brenda të premtës 29 prill 2022.

17 Këtu mbyllet ky urdhër gojarisht.

18 Tani do të lëshoj një urdhër të dytë gojarisht.

19 Trupi Gjykues vëren parashtrimin e protokolluar numër
20 392, parashtrim të Mbrojtjes së Viktimave për Ekspert për
21 Llogaritjen e Dëmtimeve Materiale të datës 21 prill 2022. Për
22 të marrë një vendim të informuar për caktimin, Trupi Gjykues
23 urdhëron Mbrojtësen e Viktimave që të dorëzojë në
24 procesverbalin e çështjes gjyqësore kurikulumin e ekspertit të
25 propozuar.

1 Këtu mbyllet ky urdhër i dytë i lëshuar gojarisht.

2 Tani mund të vijojmë me dëshminë e Dëshmitarit të
3 mbrojtjes numër 1400, Z. Selatin Krasniqi.

4 Znj. Asistente e sallës, ju lutem shoqërojeni dëshmitarin
5 të hyjë në sallë.

6 [Dëshmitari hyn në sallën e gjyqit]

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
8 Krasniqi, mirëmengjesi. Mirë se erdhët në Dhomat e
9 Specializuara. Më dëgjoni mirë?

10 DËSHMITARI: Po. Mirëmengjesi, mirë se ju gjeta.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Si
12 jeni? A patët mundësi me pushu nga pak?

13 DËSHMITARI: Po, mirë shumë.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
15 rregull. Z. Krasniqi. Ju rikujtoj se jeni ende nën betim për
16 të thënë vetëm të vërtetën.

17 DËSHMITARI: Po.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do
19 t'ia jap tani fjalën Avokatit të Mbrojtjes për pyetjet e tij
20 plotësuese.

21 Z. Avokat i Mbrojtjes, keni fjalën.

22 DËSHMITARI: SELATIN KRASNIQI [Vijon]

23 Z. VON BONE: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar
24 Gjykatës.

25 Pyetje vijuese nga z. von Bone: [Përkthim]

1 Py. Mirëmëngjesi, z. Dëshmitar.

2 Z. VON BONE: [Përkthim] Dëshiroj t'i kërkoj Sekretares së
3 Gjykatës të nxjerrë edhe njëherë në ekran një fotografi me
4 numër DSM00028.

5 Py. Z. Dëshmitar, i kam disa pyetje lidhur me fotografinë. Në
6 veçanti për ndërtesën e shënuar me 4A, në fotografi. Dje, --
7 sepse dëshirojmë që ta sqarojmë.

8 Z. VON BONE: [Përkthim] Dje, në transkriptin e seancës,
9 faqja 93, rreshti 22, u diskutua se çfarë kishte brenda asaj
10 ndërtese. Gjithashtu duam që të sqarojmë edhe çështjen e
11 këtyre rrënojave, mbase mund ta sqarojmë edhe njëherë.

12 Py. Ju kujtohet dje që folëm ose më saktë Prokuroria ju bëri
13 pyetje se çfarë kishte aty dhe u përmend edhe deklarata që ia
14 keni dhënë ekipit të Mbrojtjes dhe referenca është si në
15 vijim.

16 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Mbase mund të ndihmoj, është
17 faqja 3 e deklaratës së datës 19 prill, 2021.

18 Z. VON BONE: [Përkthim]:

19 Py. Po, është në deklaratën e Mbrojtjes. Do të citoj se çfarë
20 keni thënë ju z. Dëshmitar, lidhur me këtë ndërtesë të
21 veçantë. Keni dhënë përgjigje:

22 "Po, kjo është e saktë. Nuk përdorej fare sepse ishte e
23 pabanueshme. Nuk qëndronte dot njeriu aty".

24 Ju thatë gjithashtu, se u përmend që kishte shumë
25 material aty, nuk e di se çfarë fjale përdorët, çfarë fjale

1 përdorët tamam, tamam?

2 Pë. Materiale të bujqësisë. Pajisje bujqësore, kam thënë, që
3 ka pas aty.

4 Py. Po. Dhe makineri të bujqësisë. Kur thua makineri të
5 bujqësisë, për çfarë lloj makinerie bujqësore bëhej fjalë?

6 Pë. Jo makineri, mjete. Makineria është diçka tjetër, mjetet
7 janë diçka tjetër.

8 Py. Dhe kur thoni "mjete", për çfarë lloj mjetesh e keni
9 fjalën?

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shoh
11 që z. Prokuror është ngritur në këmbë.

12 Z. Dëshmitar, ju lutem hiqini dëgjueset.

13 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Në këtë çast nuk jam shumë i
14 qartë se për cilën periudhë kohore po flasim. Sepse, me sa më
15 kujtohet dje, këto -- makineria bujqësore për të cilën e
16 kishte fjalën dëshmitari, ishte përpara në vitet '90, në të
17 shkuarën, Nuk e di nëse e ka fjalën për periudhën prill '99,
18 apo një periudhë të mëhershme, sa i takon pranisë së këtyre
19 makinerive.

20 Sigurisht nëse kjo do të sqarohej, do të ishte e
21 dobishme.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
23 Faleminderit.

24 Z. Avokat, keni fjalën.

25 Z. VON BONE: [Përkthim] Të sqarojmë një herë çështjen e

1 fjalës "rrënoja" dhe pastaj me kohën.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mbase
3 është më mirë të sqarojmë periudhën kohore, për cilën periudhë
4 kohore po flasim. Pastaj të vazhdoni me këtë çështje.

5 Z. VON BONE: [Përkthim]:

6 Py. Z. Dëshmitar, siç sapo jua citova që ishte e pabanueshme,
7 pyetja e parë: në periudhën mars dhe prill të vitit 1999, për
8 atë periudhë e kishit fjalën që ishte e pabanueshme?

9 Pë. Diku prej '95, ndoshta '94, nuk është përdor ajo për
10 kurrgjë. I kena lanë disa pjesë, pajisje bujqësore aty dhe ma
11 s'u përdor. Tash s'jam i saktë. Por në '98-'99, jo që jo. S'ke
12 mund me banu aty.

13 Py. Këto mjetet bujqësore të cilat sapo i ceke, për çfarë
14 lloj mjetesh bëhet fjalë? Nuk është makineri bujqësore, por
15 thatë mjete bujqësore. Çfarë janë?

16 Pë. Lopata, leraqka, rrafshuese e shumë të tjera.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
18 Dëshmitar, mund t'i afroheni më afër mikrofonit, ju lutem? Që
19 të dëgjoheni edhe më mirë për përkthyesit. Znj. Asistente e
20 sallës do të përpiqet që t'jua afrojë mikrofonat.

21 Të shohim nëse tani do të funksionojë më mirë.

22 Faleminderit znj. Asistente e sallës.

23 Z. Avokat, mund të vazhdoni.

24 Z. VON BONE: [Përkthim] Një moment, të nderuar Gjykatës.

25 Py. Z. Dëshmitar, a përmendët gjë fjalën bllaçka [sipas

1 përkthimit] dje?

2 Pë. Po. Po s'po di qysh i thonë.

3 Py. Një moment ju lutem. A mund të shpjegoni çfarë është
4 bllaçka [sipas përkthimit]?

5 Pë. Është një rrafshuese, është me thepa edhe e ngreh mbas
6 traktorit ose mbas.

7 Py. Faleminderit shumë.

8 Z. VON BONE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, mund t'i
9 kërkojmë dëshmitarit të heqë dëgjueset?

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

11 Hiqini dëgjueset ju lutem. Faleminderit z. Dëshmitar.

12 [Përfaqësuesit e Prokurorisë këshillohen]

13 Z. VON BONE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, mbase është
14 dhe një kërkesë për përkthimin. Ne besojmë se dje në pjesën që
15 u citua, fjala që unë sapo përmenda, më duket se u përkthye si
16 vathë dhensh, vendi ku rrinë dhentë. Që është një lloj
17 rrethuese të themi, si kafaz.

18 Nëse dëshiron t'i mbyllësh diku delet, është ajo lloj
19 gjëje. Prandaj dhe iu kthjem kësaj çështje, sepse me sa duket
20 ka qenë bllaca [sipas përkthimit] që është një lloj tjetër
21 vegle, mjeti bujqësor.

22 Prandaj dhe unë e pyeta dëshmitarin, për ta sqaruar se
23 çfarë është në të vërtetë kjo. Sepse ai tha që e përdori këtë
24 fjalë edhe dje.

25 Në mbyllje të kësaj pjese, dëshirojmë të kërkojmë që

1 shërbimi i përkthimit t'i hedhë edhe një herë një sy kësaj
2 fjale dhe të shohim si është përkthyer.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
4 lutem, t'i jepni Trupit Gjykues referencën e saktë në
5 transkript të seancës së djeshme. Dhe pas kësaj do t'i kërkoj
6 Njësisë së Shërbimit të Përkthimit që ta dëgjojë dhe njëherë
7 atë çka u tha dje.

8 Z. VON BONE: [Përkthim] Është faqja 93, rreshti 22. Këtu
9 lindi kjo çështje.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Vetëm
11 rreshti 22?

12 Z. VON BONE: [Përkthim] Po. Aty e shohim fjalën "sheep
13 pens" [fonetik] që është vendi ku rrinë dhentë.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po.
15 Unë mendoj që është më mirë që të kemi rreshtat e EKZAKT
16 përpara dhe më pas, sepse nuk duhet ta caktojë njësia e
17 përkthimit se ku është fillimi dhe ku është mbarimi. Thjesht
18 për të dhënë një ide të qartë.

19 Z. VON BONE: [Përkthim] Unë këtë desha që të bëja tani.

20 [Anëtarët e Trupit Gjykues këshillohen]

21 Z. VON BONE: [Përkthim] Më duket se përkthyesja sapo tha
22 diçka.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,
24 mundet.

25 PËRKTHYESJA: Dje përkthyesit dëgjuan fjalën "vathë", e

1 cila në shqip është pikërisht vatha e dhenve. Kjo shpjegon pse
2 u përkthye kështu dje.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
4 Avokat i Mbrojtjes, unë nuk besoj se kemi nevojë për sqarim
5 apo ridëgjim të kësaj pjese, sepse ka qenë një keqkuptim.
6 Është shumë mirë që e sqaruar tani.

7 Z. VON BONE: [Përkthim] Prandaj dhe iu rikthyem kësaj.
8 Falënderojmë shumë edhe përkthyesit.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
10 Falënderojmë përkthyesen për këtë sqarim.

11 Z. VON BONE: [Përkthim] Mbase duhet të dimë tani se si
12 përkthehet fjala për të cilën sapo folëm.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] U
14 përkthye tashmë me fjalën niveluese, shkruftuese e tokës. Por
15 ajo që unë do të doja që të pyesja është, sa i madh ishte ky
16 mjet bllaça në fjalë. Sepse shoh një derë në anën e majtë,
17 kështu që vras mendjen se si hynte bllaça në këtë ndërtesë.
18 Mbase nuk është shumë e madhe, mbase është më e vogël se dera.
19 Nuk e imagjinoj dot se si është bllaça.

20 Z. VON BONE: [Përkthim] Në fakt edhe ne menduam një fjalë
21 tjetër kur e pamë këtë, që është shkruftuese e tokës apo "drag
22 harrows" në anglisht. Megjithatë, çështja ishte vetëm që të
23 dallohej nga fjala "rrënojë" më shumë edhe nga një fjalë
24 tjetër apo materiale të vjetra.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

1 Pyetja ime është tjetër, në fakt. Desha të pyes sa e madhe
2 është ajo vegël që në anglisht quhet "rake" apo që është
3 niveluese apo shkriфтuese e tokës, një lloj shkriфтuesi.

4 Z. VON BONE: [Përkthim]

5 Py. Z. Dëshmitar, ju falënderoj shumë.

6 Po flisnit dje për mjetet bujqësore të cilat ju sapo i
7 përshkruat. Sa e madhe është ky mjet që ju sapo e përmendët?

8 Pë. Dikun ka 50-60 centimetra, por palohet. Është me tri
9 pjesë.

10 Py. Me tre pjesë besoj? Po. Atëherë, nëse shikojmë
11 fotografinë edhe shohim ndërtesën 4A, a hyn nëpër atë derë ai
12 mjet, ajo vegël?

13 Pë. Po, hynë. Se palohet.

14 Py. Nuk ka nevojë që ta zmadhojmë fotografinë.

15 Ishin materiale të vjetra këto që qëndronin aty?

16 Pë. Po, të vjetra. Po, po. Vitet '80.

17 Py. Ju kuptoj.

18 Z. VON BONE: [Përkthim] Shpresoj që e kemi sqaruar, të
19 nderur Gjykatës, çështjen e rrënojave. Meqenëse pati shumë
20 diskutim dje. Mund të vazhdojmë me një temë tjetër.

21 Py. Z. Dëshmitar, me qenë se kemi të njëjtën fotografi në
22 ekran dhe shohim ndërtesën 4A. A është përdorur ndonjëherë kjo
23 si bazë nga BIA? Kjo ndërtesë?

24 Pë. Po BIA ka qëndruar këtu.

25 Py. Brenda asaj ndërtese ka qëndruar?

1 Pë. Brenda asaj ndërtese. E tregova edhe më herët që s'ka
2 jetu kurrkush, s'ka banu kurrkush.

3 Py. Dhe kjo ndërtesë, ka ndonjë kat të sipërm, kat të
4 poshtëm, apo ishte vetëm me një kat?

5 Pë. 4A?

6 Py. Po, 4A.

7 Pë. Është ashtu qysh është. Veç një kat.

8 Py. Faleminderit shumë. Prokuroria parashtroi se janë mbajtur
9 njerëz në atë ndërtesë, brenda asaj ndërtese, në katin
10 përdhes. Ju çfarë kishit për të thënë për këtë?

11 Pë. Unë ju thashë edhe dje. Nuk ka pas njerëz të ndaluar, as
12 nuk kam pa, as ka pas, domethënë. Edhe nuk mundet me thanë
13 kurrkush që ka pas njerëz të ndaluar aty.

14 Py. Z. Dëshmitar, --.

15 Z. VON BONE: [Përkthim] Të konsultohemi për një çast, të
16 nderuar Gjykatës.

17 [Përfaqësuesit e Mbrojtjes këshillohen]

18 Z. VON BONE: [Përkthim]

19 Py. Z. Dëshmitar, a ju kujtohet të jeni takuar me përfaqësues
20 anëtarë të Prokurorisë, vjet?

21 Pë. Po. Më ka thirr Prokurori Cezary Mihajlov. Kërkoj falje
22 nëse s'po mundem me ia theksu emrin qysh e ka. Dhe ka kërku me
23 dalë në vendin ku po pretendojnë ata se.

24 Py. Po. Z. Michalczuk ishte vetëm asokohe?

25 Pë. Kanë qenë 3 makina. Nuk e di sa vetë veç janë kanë 3

1 makina.

2 Py. Ndonjë prej Prokurorëve që shihni këtu të pranishëm në
3 sallë sot, a ishte i pranishëm edhe atëherë?

4 Pë. Nëse s'gabo, më duket se, po. Ka qenë ajo Prokurorja.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Për
6 cilin apo cilën e keni fjalën?

7 DËSHMITARI: Në rend të parë, nëse s'gabo. Ashtu a kanë
8 një, se a kanë --.

9 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Nëse mund t'ju ndihmoj, mund të
10 konfirmoj që kemi qenë të dy ne, të pranishëm aty.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
12 Prokurori sapo informoi se të dy Prokurorët e pranishëm këtu,
13 kanë qenë të pranishëm edhe atje.

14 Z. VON BONE: [Përkthim] Faleminderit.

15 Py. Në momentin që u takuat me ta, ata a ju treguan ndonjë
16 fotografi?

17 Pë. Jo.

18 Py. Sa zgjati ai takim?

19 Pë. Ndoshta, 1 orë krejt sa kanë ndejt aty edhe tek shkolla.

20 Veç ka qenë tu ra shi. Edhe kam dëgjuae prej familjarëve që
21 Prokurori ka thënë këtë që, nuk na kanë pritur mirë në fshat.
22 Gjoja se i kena këqyr dikush m'rojt. Veç të sqaroj, Avokat.

23 Py. Patjetër.

24 Pë. Atë ditë veç unë jam konë aty, janë konë edhe disa
25 punëtorë, por janë konë qenë shumë larg. Diku 40 metra prej

1 aty. S'ka pas të tjerë njerëz përpos meje. Dhe ka qenë tu ra
2 shi, këta e dinë.

3 Py. Shkoni sërish, shkoni përsëri në atë vendndodhje, në atë
4 vend pronë të familjes?

5 Pë. Unë?

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Një
7 moment, një moment.

8 Z. Avokat, nuk është e qartë, nëse më lejoni ta
9 përfundoj. Pra, nuk është e qartë se për çfarë vendndodhje
10 bëhet fjalë, vend.

11 Z. VON BONE: [Përkthim] E kam fjalën për vendin që këtu
12 në sallë është quajtur si kompleksi i Zllashit.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E
14 kuptoj.

15 Z. VON BONE: [Përkthim] Përbërja që u diskutua dje, vendi
16 ku ndodhen ndërtesat që paraqiten në këtë fotografi.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
18 Avokat i Mbrojtjes, për mua nuk është e qartë nëse ne e kemi
19 fjalën për këtë, sepse nuk e përcaktuam fillimisht vendin, që
20 pastaj të bënim një pyetje pasuese lidhur me këtë.

21 Unë propozoj që ta perifrasoni pyetjen.

22 Z. VON BONE: [Përkthim]:

23 Py. Vendi që duket në këtë fotografi që keni përpara në
24 ekran, a shkoni ende aty, a shkoni sërish aty?

25 Faleminderit. Dhe cila ndërtesë ende qëndron edhe sot.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Më
2 falni, por--

3 Z. VON BONE: [Përkthim] Po flasim për vendin këtu në
4 fotografi.

5 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë, z. Avokat.
6 Por nuk kemi përgjigjen e dëshmitarit në transkript.

7 Z. VON BONE: [Përkthim] Më falni, por mua mu duk sikur e
8 tha, po.

9 Py. Ju lutem, flisni me zë më të lartë ju lutem, në mënyrë që
10 njerëzit në përkthim t'ju dëgjojnë.

11 Pë. Z. Avokat, unë çdo ditë shkoj atje në orën 8.00. Çdo
12 mëngjes, përpos që jam këtu që një jave. Se çdo ditë shkoj.
13 Është vendi im, çdo ditë shkoj. Punoj atje.

14 Py. Po. Në rregull. Shumë faleminderit. Pyetja që kam unë
15 është kjo -- ne kemi qenë atje dhe Prokuroria ka qenë atje.
16 Por, nga të gjitha ato ndërtesa që diskutuam dje, cila nga ato
17 ndërtesa është akoma ekzistuese?

18 Pë. Veç hambari është. Atë e kena rinovu para dy vitesh, nëse
19 s'gaboju.

20 Py. Në rregull.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
22 Avokat.

23 DËSHMITARI: Hambari është një vend ku e lëmë grurin.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Cili
25 numër do të ishte në fotografinë që pamë dje?

1 DËSHMITARI: Numër 1.

2 Z. VON BONE: [Përkthim] Nuk jam i sigurt, por dëshmitari
3 tha "hambari".

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do të
5 preferoja që të na e shpjegojë dëshmitari se çfarë nënkupton
6 me "hambarin" kur flet në lidhje me fotografinë.

7 Z. VON BONE: [Përkthim] Dje, ne bëmë disa shënime në një
8 fotografi, znj. Sekretare.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
10 Sekretaria e ka shfaqur në ekran.

11 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, në qoftë
12 se nuk gabohe, bëhet fjalë për dokumentin DSM00016. Është
13 ndërtesa që besoj që po mundohet që të përshkruajë Avokati i
14 Mbrojtjes.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
16 rregull. Faleminderit z. Prokuror.

17 Aktualisht kemi një fotografi në ekran me shënimet që ka
18 bërë dëshmitari dje. Mendoj që kjo fotografi do të na ndihmojë
19 për të sqaruar se kush është ahuri apo kush është vendi ku
20 mbahen drithërat ose hambari, që thotë dëshmitari që ende
21 ekziston sot.

22 Z. Dëshmitar, a e shikoni fotografinë që e keni aty
23 përpara në ekran?

24 DËSHMITARI: Po, e shoh. Numri 13 është.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në

1 rregull. Faleminderit. Na e sqaruat.

2 Z. VON BONE: [Përkthim]

3 Py. Kur e keni vizituar me Prokuroren, me Prokurorët,
4 Prokurorisë a i keni thënë ndonjë gjë...

5 Pë. Jo, nuk kena bis...

6 Py. Një sekondë se nuk kam përfunduar. Prokurorisë, a i keni
7 dhënë ndonjë indikacion apo i keni thënë ndonjë gjë që në atë
8 zonë ose në atë vend, do të ketë pasur më përpara një qendër
9 ndalimi?

10 Pë. Jo, nuk kemi bisedu për kurr gjë me Prokurorin. Më ka
11 thirr edhe mbas një kohe me sqaru do sende. Pasi jam kanë
12 dëshmitar i Mbrojtjes, s'kam pranuar.

13 Py. E kuptoj. Të lutem.

14 Pë. Ma ka thirr edhe djalin 15 vjeç tri herë. Herën e parë me
15 verifiku numrin. Dy herë, nuk e di pse e ka thirr. Djali im i
16 ka 15 vjet. A është konë gabim, a s'e di pse e kanë thirr. Ose
17 ndoshta që djali mban emrin a axhës Kadrisë. Këtë nuk kam mujt
18 me e kuptu.

19 Py. Do të të bëj këtë pyetje. Në qoftë se Prokuroria thotë
20 se, ju keni dhënë informacion ose keni dhënë indikacion se ku
21 gjendej ndërtesa e ndalimit, çfarë do të thoshit juve në
22 përgjigje të kësaj?

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
24 lutem, hiqini kufjet z. Dëshmitar.

25 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Nuk e di se nga del kjo. Dhe

1 kjo është fare pa vend. Nuk e di se cila është baza për këtë
2 gjë.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
4 Avokat, as unë nuk e kam të qartë se ku doni të dilni. Ju
5 lutem, a mund të na jepni një sqarim përpara se sa t'i bëni
6 pyetjen dëshmitarit? A mund të na thoni se, pse po e bëni këtë
7 pyetje dhe cila është baza e kësaj pyetje?

8 Z. VON BONE: [Përkthim] Baza është dokumenti i
9 Prokurorisë i identifikuar me numrin 100949, që është njoftimi
10 zyrtar i Zyrës së Prokurorisë sa i takon vizitës në Zllash.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
12 rregull z. Von Bone.

13 Z. VON BONE: [Përkthim] I referohet dëshmitarit ky
14 dokument dhe kjo është baza ime.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A
16 mund ta citoni këtë dokument?

17 Z. VON BONE: [Përkthim] Patjetër.
18 Py. Pozicioni i ndërtesës së ndalimit, është rikrijuar
19 mbështetur në deklaratën e dëshmitarit të Prokurorisë në fotot
20 e 2006-s, si dhe mbështetur në indikacionet që ka dhënë
21 Selatin Krasniqi për Mbrojtjen gjatë intervistës së tij dhe që
22 i ka dhënë gjithashtu edhe ekipit të ZPS-së në terren.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A
24 mund të kërkojmë shfaqen e këtij dokumenti? Nuk është pyetje
25 në fakt, por kërkoj që të shfaqet ky dokument, por dua që të

1 jepet referenca.

2 Z. VON BONE: [Përkthim] Po. Kjo është referenca që kam
3 unë. Kjo është referenca që sapo jua dhashë.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A
5 mund ta përsërisni për Sekretaren? Znj. Sekretare, a është e
6 mjaftueshme kjo për ta nxjerre dokumentin?

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jo, të nderuar
8 Gjykatës. Nuk e di në qoftë se Avokati mund të na japë numrin
9 ERN të dokumentit.

10 Z. VON BONE: [Përkthim] Nuk e ka dokumenti numrin ERN.
11 Por jepet numri ERN i përmbajtjes së diskut, që me sa duket
12 është regjistruar kjo që thashë unë. Mendoj se ajo çfarë mund
13 të them në këtë rast, është që bëhet fjalë për Notën Zyrtare
14 të datës 1 qershor 2021. Dhe numri ERN është 100949. Jepet në
15 cep në anë të djathtë të dokumentit ky numër.

16 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës. Në qoftë
17 se më lejoni të jap numrin ERN. Numri ERN është 100949 deri në
18 100951 RED.

19 Z. VON BONE: [Përkthim] Në rregull.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
21 Prokuror, a dëshironi të komentoni lidhur me atë se çfarë po
22 identifikon Avokati?

23 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Në qoftë se Avokati i Mbrojtjes
24 mund të lexojë pjesën e Notës Zyrtare që sugjeron atë çfarë
25 tha dhe faqen që mbështet sugjerimin që iu bë dëshmitarit,

1 atëherë mund ta nisim nga kjo pikë.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A
3 mund te na thoni se ku në këtë faqe thuhet kjo që lexuat?

4 Z. VON BONE: [Përkthim] Është në paragrafin e katërt, të
5 nderuar Gjykatës. Është nga fjalia e dytë e në vijim.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Një
7 moment, se janë dy vetë në këmbë. Avokatja e Viktimave ishte e
8 para, kështu që fjala për ju.

9 ZNJ. PUES: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.
10 Nuk e di në qoftë se dokumenti është në ekranin e dëshmitarit.
11 Sepse, në qoftë se do të ishte në ekranin e dëshmitarit, i
12 takon që do të minonte, do të cenonte në fakt diskutimin që po
13 bëjmë.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Kam
15 përshtypjen që çdo gjë është në ekran, por u hoq nga ekрани.

16 ZNJ. PUES: [Përkthim] Mbase do të ishte mirë që të
17 mbaronim diskutimin mbi këtë çështje njëherë dhe pastaj të
18 mund të vazhdonim me dokumentet, në mënyrë që të mos ndikonin
19 në përgjigjen e dëshmitarit.

20 [Trupi Gjygues dhe Sekretarja e Gjykatës
21 këshillohen]

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.
23 Sekretare, a mund ta shoqëroni dëshmitarin ta nxirrni nga
24 salla?

25 Z. Dëshmitar, znj. Sekretare do t'ju nxjerrë nga salla.

1 Do të diskutojmë për një çështje që ka të bëj me një pyetje që
2 do t'ju bëhet më pas. Sapo ta shtjellojmë këtë çështje, do
3 t'ju sjellim përsëri në sallën e gjyqit. Faleminderit.

4 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.
6 Sekretare, ju lutem na i shfaqni edhe njëherë dokumentet në
7 ekran.

8 Z. Prokuror, e keni ju fjalën.

9 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Faleminderit. Paragrafi që i
10 referohet Avokati thotë qartë që:

11 "Në fakt pozicioni i ndërtesave të ndalimit është
12 rikrijuar mbi bazën e deklaratave të dëshmitarëve të
13 Prokurorisë me fotot e 2006 të bëra për UNMIK-n në çështjen
14 2002-0014 si dhe indikacioneve të Selatin Krasniqit të bëra
15 për Mbrojtjen gjatë intervistës dhe me bisedat me ekipin e
16 ZPS-së në terren".

17 Në qoftë se doni, mund ta diskutojmë këtë gjë. Por ne
18 kemi qenë në terren dhe z. Krasniqi duke qenë pronari dhe duke
19 qenë i njohur me organizimin e vendit në atë kohë, na ndihmoi
20 që të kuptonim se çfarë ndërtesash kanë qenë aty, të cilat nuk
21 janë ndërtesa ekzistuese tani.

22 Kështu që harta e vendit të ndalimit -- ne nuk është se
23 kemi pretenduar ndonjëherë, siç thuhet nga Avokati i
24 Mbrojtjes, që z. Krasniqi na ka thënë neve se ku ishte godina
25 ose ndërtesa e ndalimit. Thjesht Avokati i Mbrojtjes po bën

1 një interpretim të asaj çfarë është në Notën Zyrtare. Dhe në
2 fakt kjo nuk qëndron. Neve kemi specifikuar që ka disa faktorë
3 që na kanë ndihmuar neve që të rikrijojmë konfigurimin ose
4 planimetrinë e ndërtesave aty. Pra, kemi identifikuar që kjo
5 është mbështetur në fotografitë, nga çështjet e UNMIK-u etj.

6 Kështu që, propozimi ose pyetja që i drejton Avokati
7 dëshmitarit, nuk është pyetje e drejtë. Është thjesht një
8 sugjerim që nuk mund të nxirret nga ajo çfarë citohet nga Nota
9 Zyrtare prej Avokatit.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

11 Faleminderit, z. Prokuror.

12 Z. Avokat, është për ju.

13 Z. VON BONE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës. Në qoftë se
14 ka ndonjë gjë të padrejtë, gjëja e padrejte është ajo se çfarë
15 shkruhet në këtë paragraf. Nuk thuhet "ndërtesa", por thuhet
16 "ndërtesa për ndalimin". Kështu që, ky është problem që e ka
17 përdorur Prokuroria, ndërkohë që Z. Krasniqi nuk ka parë
18 asnjëherë asnjë prej fotografive që kanë qenë pjesë e këtij
19 dokumenti, siç e dëshmoi. Nuk ka thënë asnjëherë asnjë gjë,
20 nuk ka bërë asnjë lloj indikacioni ose nuk është se ka treguar
21 në një fotografi konkrete se çfarë ka pasur. Dhe pavarësisht
22 kësaj, prapë, Prokuroria del në përfundimin që në fakt z.
23 Krasniqi ka dhënë informacion për ekipin e ZPS-së në terren,
24 ose që i ka dhënë Mbrojtjes. Por në fakt realiteti është që ai
25 asnjëherë nuk ka dhënë një gjë të tillë, nuk ka dhënë një

1 informacion të tillë.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Propozoj që ju ta pyesni dëshmitarin në qoftë se ai ka dhënë
4 ndonjëherë ndonjë informacion, indikacion juve si Mbrojtje,
5 ose ZPS-së, se ka pasur një qendër ndalimi në ato ambiente.

6 Z. VON BONE: [Përkthim] Po ka pasur, sipas Prokurorisë.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo.

8 Mund ta bëni pyetjen në qoftë se ai e di, në qoftë se ka pasur
9 një qendër ndalimi atje. Dhe mund ta pyesni në qoftë se jua ka
10 thënë një gjë të tillë juve apo ZPS-së. Dhe mendoj që kjo
11 është një pyetje e drejtë, një pyetje me vend. Dhe nuk mendoj
12 se ia vlen që t'ia tregojmë këtë Notë Zyrtare, se do ta
13 ngatërronim më shumë. Sepse ka mënyra të ndryshme se si mund
14 ta lexosh atë. Nuk është se do të shprehem tani se si duhet
15 të lexohet ky paragraf. Megjithatë, e kuptoj të drejtën tuaj
16 për të pyetur në qoftë se ai është shprehur apo ka thënë diçka
17 të tillë, qoftë para jush apo përpara Prokurorisë. Por dua që
18 të jetë e kufizuar deri këtu.

19 Z. VON BONE: [Përkthim] Mendoj që e bëra këtë pyetje,
20 pyetje që më thatë juve por do ta t'ia bëj prapë.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo.

22 Pyetja jua jua nënkuptonte që ZPS-ja e ka thënë këtë gjë.

23 Ndërkohë që, do ju sugjeroja që pyetja të jetë më e qartë,
24 domethënë në qoftë se ai e ka thënë këtë gjë apo jo. Pa shtuar
25 dhe pa thënë që ZPS-ja pretendon që ai e ka thënë këtë gjë.

1 Tani do të kërkoj që ta sjellin sërish dëshmitarin në
2 sallë dhe nuk mendoj që për momentin të kemi të shfaqur në
3 ekran këtë dokument.

4 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës. Elementi i
5 fundit. Duam që ta kemi procesverbalin e qartë. Pra, duam që
6 të reflektohet në procesverbal që Nota Zyrtare ose teksti që u
7 lexua, nuk sugjeron që ne pretendojmë që z. Krasniqi na tha
8 neve që këtu ka qenë qendra e ndalimit.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
10 Pozicioni juaj është i qartë dhe mendoj që edhe pozicioni i
11 Avokatit Mbrojtës është i qartë. Dua të them që, tani për
12 momentit nuk do të marr asnjë vendim apo pozicion lidhur me
13 këtë.

14 [Dëshmitari vijon dëshminë]

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
16 Faleminderit, znj. Sekretare.

17 Z. Avokat, ju lutem vazhdoni.

18 Z. VON BONE: [Përkthim]

19 Py. Z. Dëshmitar, a keni thënë ndonjëherë, a keni dhënë
20 ndonjë indikacion për Mbrojtjen në qoftë se ka pasur një
21 qendër ndalimi, në qoftë se ka pasur një shtëpi për ndalimin e
22 njerëzve ose një strukturë për ndalim, në vendin në Zllash që
23 kemi diskutuar bashkë?

24 Pë. Jo. S'kam dhënë, se s'ka pasur. S'kam pas çka me dhanë.

25 As për Prokurorin, që tha kemi biseduar. Duhet me e sqaru

1 Avokat.

2 Py. Në rregull.

3 Pë. E çfarë kam biseduar me Prokurorin vetëm e kam pyet, qysh
4 janë Salih Mustafa e këta të tjerët që janë, Hashimi, Kadria.
5 Vetëm për ata e kam pyt, a janë mirë me shëndet. Ma shumë
6 s'kena diskutu.

7 Py. A more përgjigje për pyetjen që bëtë?

8 Pë. Më tha, mirë janë.

9 Py. Në rregull. A ke dhënë ti ndonjëherë ndonjë informacion
10 për Zyrën e Prokurorisë, ndërkohë që kanë qenë në atë vizitë
11 në vendin për të cilën po diskutojmë, që ka pasur një qendër
12 për ndalimin një godinë ose një strukturë për ndalimin apo çdo
13 vend tjetër ku qëndronit të ndaluar njerëzit? A ke thënë
14 ndonjëherë për Prokurorinë?

15 Pë. Jo, jo, kurrë hiç. Në realitet unë s'kam ndej me këta
16 hiç, kam ndej tek hambari se ka qenë duke rënë shi. Këta kanë
17 ndej tek ajo pema aty ku është, ku duket në fotografi. Kanë
18 fotografuar.

19 Py. Në rregull. A është diskutuar ndonjë gjë tjetër me ju?

20 Pë. Jo. Se përkthyes, nëse s'gaboj -- jo, a kanë përkthyesi
21 por s'kena fol. Edhe kanë qenë shumë veta këta. Kena vazhdu
22 tek shkolla e Zllashit. Edhe aty i kanë bërë do fotografi.

23 Py. Prit pak. Më lejoni t'ju ndërpres këtu, sepse dua që të
24 qëndrojmë tek hambari, tek vendi. A ju bënë ndonjë pyetje ata
25 të Prokurorisë, për ndonjë ndërtesë që ka ekzistuar aty më

1 përpara?

2 Pë. Jo, jo. Jo.

3 Py. Z. Dëshmitar, dje thatë se kur ke ardhur për në Hagë, t'u
4 kujtua data 17 prill. A të kujtohet që e thatë këtë gjë dje?

5 Pë. Po.

6 Py. T'u kujtua sepse disa politikanë po flinin, apo nga
7 lajmet që po shikonit? A mund të na e rifreskoni kujtesën, a
8 mund të na e përmendi edhe njëherë se çfarë ju bëri juve ta
9 kujtoni këtë datë?

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dua
11 që sa më shpejt të jetë e mundur të mund të na jepni
12 referencën. Në mënyrë të tillë që ta konfrontojmë menjëherë
13 dëshmitarin menjëherë me atë çfarë ka thënë. Sepse është mirë
14 që t'i referohemi.

15 Ju lutem citoni referencën e dëshmitarit dhe pastaj mund
16 të bëjmë një pyetje pasuese, pasi të kemi identifikuar atë
17 çfarë ka thënë ai dje. Ju lutem, vazhdoni.

18 Z. VON BONE: [Përkthim]

19 Py. Çfarë dëgjuat ju nga lajmet?

20 Pë. I shikova lajmet dhe pashë Orhan Ismajlin. Çshtë në
21 Partinë Demokratike të Kosovës. Kish shku me vizitu varrezat
22 në fshatin Marec, në Viti të Marecit. Edhe tani mu kujtuan
23 ngjarjet. Pashë edhe familjarët.

24 Py. Në rregull. Shumë faleminderit. A ke qenë ndonjëherë vetë
25 i përfshirë me politikën ti?

1 Pë. Jo, jo.

2 Py. Ke qenë ndonjëherë anëtar i ndonjë partie politike? Ke
3 mbështetur ndonjëherë një politikan të caktuar?

4 Pë. Po.

5 Py. Dhe me kë parti është ky politikan?

6 Pë. Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës. Deri në vitin 2000 jena
7 kanë krejt me Lidhjen Demokratike të Kosovës si familje, si
8 fashat. Mbas vitit 2000 kemi vazhdu, dikush andej, dikush.

9 Py. Në rregull.

10 Z. VON BONE: [Përkthim] Çështja e fundit që ka të bëjë me
11 këtë gamë.

12 Py. Ndërkohë që keni qenë me UÇK-në, pavarësisht njësitit ku
13 keni bërë pjesë, a keni pasur ndonjë ndjesi në atë kohë, e kam
14 fjalën për 1999, mars-prill 1999, në qoftë se ka pasur ndonjë
15 dallim ndërmjet personave që ishin anëtarë të një grupimi
16 politik ose ndonjë dallim tjetër që kanë qenë anëtarë të UÇK-
17 së apo jo? A kishte ndonjë dallim të kësaj natyre?

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
19 lutem hiqni kufjet, z. Dëshmitar.

20 Z. DE MINICIS: [Përkthim] A mund të na shpjegojë Avokati,
21 ju lutem, se si rrjedh kjo nga kundër pyetjet tona, çfarë baze
22 ka kjo pyetje?

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do të
24 pyes Avokatin e Mbrojtjes, por nuk është se jam kaq strikte
25 për sa i takon pyetjeve që lejoj që të bëhen. Por ndoshta

1 është mirë që të na e sqaroni se, pse doni që ta bëni këtë
2 pyetje?

3 Z. VON BONE: [Përkthim] Nuk e di, doja ta pyesja në qoftë
4 se ky politikan ka qenë pjesë e UÇK-së, ndërkohë që edhe dje
5 diskutonim për anëtarësimin në UÇK. Thjesht doja ta bëja të
6 qartë nëse kishte ndonjë ndarje në UÇK, apo jo.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Për
8 çfarë ndarje e keni fjalën?

9 Z. VON BONE: [Përkthim] Politike, për ndarje politike.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
11 UÇK?

12 Z. VON BONE: [Përkthim] Po.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E
14 kuptoj argumentin e Prokurorisë se nuk duket sikur është e
15 lidhur me diskutimin që bëmë dje. Megjithatë, do t'ju lejoj që
16 ta bëni pyetjen.

17 Për referencë, më thuhet që është faqja 154, nga rreshti
18 3 deri në 4. Dhe dëshmitari thotë që: ju keni dëgjuar, keni
19 parë lajmet. Çfarë patë në lajme?

20 "Në lajme pashë disa politikanë, anëtarë familjesh që
21 shkuan në Viti të Marecit".

22 Z. VON BONE: [Përkthim] Besoj se u bë një pyetje lidhur
23 me këtë edhe nga Avokatja e Viktimave. Referenca nuk ka
24 rëndësi.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo,

1 ka rëndësi. Se duhet që ta kemi në procesverbal.

2 Z. VON BONE: [Përkthim] Është faqja 75, rreshtat nga 9
3 deri në 12.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Kemi
5 dy referenca dhe do t'i kontrollojmë ato të dyja. Ju lutem,
6 vazhdoni.

7 Avokat, ju lutem mos më ndërprisni. Nuk është çështja se
8 më ndërprisni mua, por është çështja e të gjithë të tjerëve që
9 nuk e flasin anglishten. Është e rëndësishme që të më lini të
10 shprehem deri në fund dhe pastaj të merrni fjalën.

11 Ju lutem vazhdoni me këtë pyetje, por do të insistoja që
12 të mos bëni shumë pyetje lidhur me këtë pikë. Mos e zgjasni
13 shumë me këtë pikë.

14 Z. VON BONE: [Përkthim] Faleminderit. Kjo është pyetja e
15 fundit që kam lidhur me këtë temë. Ju lutem, vendosni
16 dëgjueset.

17 Py. Z. Dëshmitar, kur keni qenë pjesëtar i UÇK-së,
18 pavarësisht njësitit ku keni bërë pjesë, a keni vënë re
19 ndonjëherë apo a keni përjetuar, a keni dëgjuar apo a keni
20 parë me sytë tuaj apo dëgjuar nga persona të tjerë rreth jush
21 që bëhej një dallim në bazë të përkatësisë politike, sa i
22 takon kyçjes në UÇK?

23 Pë. Jo, z. Avokat. Dhe vlen të ceket se gjithë familja jonë,
24 se e kam ndi edhe në aktakuzë që përmendet Lidhja Demokratike
25 e Kosovës, gjithë familja kena qenë në Lidhjen Demokratike të

1 Kosovës, gjithë fshati Zllash, krejt Gollaku. Themeluesi i
2 Lidhjes Demokratike të Kosovës Shefki Gashi, që jemi krenar që
3 e kemi, është i fshatit Mramor, ka qenë dhe ai pjesë e luftës.
4 Ismet Beqirin e kam në lagje. Dhe ai ka qenë një ndër
5 themeluesit e LDK-së për atë pjesë. E ka pas shumë të tjerë të
6 Lidhjes Demokratike të Kosovës edhe aty, dhe s'ka pas kurrfarë
7 bindje domethënë. Qëllimi ka qenë i njëjtë, me çliru Kosovën.

8 Nuk e di kush është ai që i shpik këto sende, se i vetmi
9 qëllim ka qenë çlirimi i Kosovës. Nuk ka pas bindje politike
10 me cilën parti je, me kë je, çka je.

11 Py. Në rregull.

12 Pë. Bile, kisha kërkuar, nëse i keni mundësitë, me i thirr
13 edhe ata dëshmitarë këtu. Shefkinë, Ismet Beqirin, e shumë të
14 tjerë, Alushin. Të cilët kanë prurë ndihma në shtëpinë tonë.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
16 Dëshmitar, le t'i qëndrojmë pyetjes. Të japim përgjigje për
17 pyetjen që ju bë. Faleminderit.

18 [Përfaqësuesit e Mbrojtjes këshillohen]

19 Z. VON BONE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës. Kemi
20 përfunduar me pyetjen e dëshmitarit.

21 Py. Faleminderit për kohën dhe kontributin z. Dëshmitar.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
23 Dëshmitar, dua t'i kthehem edhe njëherë një fotografie që ju
24 është treguar nga Avokati i Mbrojtjes. Znj. Sekretare, dua që
25 të shfaqni dokumentin 00-0015, që është fotografia që ka disa

1 godina, disa ndërtesa.

2 Z. Dëshmitar, ajo çfarë dua të di është kjo: ne shohim
3 këtu godinën ndërtesën 4A. Kjo ndërtesa 4A, a ishte e lidhur
4 me ndërtesën numër 5?

5 DËSHMITARI: Jo. E ka pas një zbrazëtinë.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
7 mirë.

8 DËSHMITARI: Por shumë e vogël domethënë --

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
10 rregull. Faleminderit për sqarimin. Midis ndërtesës 4A dhe
11 ndërtesës në të djathë ku keni bërë ca shënime, a kishte
12 ndonjë lidhje në nivelin e tokës ndërmjet këtyre dy godinave?

13 DËSHMITARI: Veç një metër domethënë është e lidhur.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A
15 mund të kaloje ti nga godina 4A, në godinën që është në të
16 djathë?

17 DËSHMITARI: Jo.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
19 rregull. Kjo mjafton.

20 Ndoshta, znj. Sekretare, a është e mundur që ta zmadhoni
21 pak më shumë fotografinë duke u përqendruar tek ndërtesa 4A
22 dhe ndërtesa tjetër në të djathë të ndërtesës 4A?

23 Pra, ju thoni që ndërtesa 4A dhe ndërtesa ngjitur, ishin
24 të lidhur për nja 1 metër, do të thuash mur më mur? Këtë do të
25 thuash? Domethënë nuk kishte boshllëk, nuk kishte distancë?

1 DËSHMITARI: Jo. Veç ka qenë e lidhur.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
3 mirë. Mjafton hëpërhë, z. Dëshmitar. Faleminderit.

4 Pyetje plotësuese nga ZPS-ja?

5 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Jo, asnjë, të nderuar Gjykatës.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

7 Mbrojtësja e Viktimave, ju ka mbetur ndonjë pyetje?

8 ZNJ. PUES: [Përkthim] Jo, faleminderit.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
10 rregull. Z. Krasniqi, ju ka bërë pyetje Avokati i Mbrojtjes,
11 Zyra e Prokurorit të Specializuar, si edhe Mbrojtësja e
12 Viktimave dje. Tani rendin e ka Trupi Gjykses për t'ju bërë
13 pyetje, për të na dhënë mundësinë të jemi më të qartë lidhur
14 me atë çka keni deklaruar dje dhe sot, edhe pse disa pyetje
15 janë bërë.

16 Tani do t'iu drejtohem kolegëve të mi, anëtarëve të
17 Trupit Gjykses, nëse kanë pyetje dhe do t'ju informoj.

18 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

19 GJYKATËSI DEKKERS: [Përkthim] Faleminderit, jo. Pyetja
20 ime e mori përgjigjen për shkak të pyetjes që bëtë ju.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] [Nuk
22 ka mikrofon].

23 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Faleminderit znj. Kryetare e
24 Trupit Gjykses.

25 Pyetje nga Trupi Gjykses:

1 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Z. Dëshmitar, dje, më duket
2 se në faqen 108 dhe 109, thatë që: në shkurt dhe në mars e
3 kuptova se kishte një Brigade 153 dhe një njësit gueril BIA.

4 E kam fjalën për kompleksin në Zllash ku ishim.

5 Pastaj thatë që: "Personi nga Karadaku u largua dhe shkoi
6 në një bazë tjetër".

7 Pra, e kam kuptuar saktë që kishte aty një njeri një
8 person nga Karadaku në atë kompleks, por ky person u largua në
9 shkurt apo në mars?

10 Pë. I nderuar Gjykatës, jo një person por kanë qenë disa
11 persona të zonës së Karadakut. Deri sa e kanë formuar zonën e
12 vet, kanë qëndruar disa pjesëtarë në shtëpinë tonë aty.
13 Domethënë, ka pas pjesëtarë edhe të zonës së Karadakut.

14 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Po, por nuk është saktësisht
15 siç u tha dje, por e kuptoj tani.

16 Në faqen 110, rreshti 25 i transkriptit të seancës së
17 djeshme, ju po flisnit për një takim midis anëtarëve të UÇK-së
18 dhe anëtarëve të familjes suaj në vitin 1998. Gjatë atij
19 takimi u pajtuat që ky kompleks në Zllash të përdoret nga UÇK-
20 ja.

21 Ju përmendët një person me emrin Agron. E kishit fjalën
22 për Agron Xhemajlin?

23 Pë. Po. Atë nuk e kam taku ma mbas, nuk e di në cilën pjesë
24 ka shkuar.

25 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Pra, nuk e dini se çfarë roli

1 kishte ai në UÇK, apo se çfarë po bënte në vitin 1998 apo
2 1999?

3 Pë. Jo, jo. Nuk e di.

4 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Në rregull. Dje po flisnit
5 për një moment kur jeni kthyer në Prishtinë më 3 prill. Është
6 na faqen 62. Thatë që keni shkuar në Prishtinë dhe jeni
7 kthyer, me sa duket brenda të njëjtës ditë.

8 Por, në deklaratën që i keni dhënë Avokatit të Mbrojtjes
9 me numër DSM00028 [sipas përkthimit] kur ju bë pyetja: "Keni
10 qëndruar gjatë gjithë kohës nga nëntori 1998 deri në prill
11 1999", ju i jeni përgjigjur: "Deri sa u zhvillua ofensiva pak
12 a shumë, më të shumtën e kohës kam qëndruar në këtë vend. Me
13 raste kam shkuar edhe në Prishtinë. Aty qëndroja 2 ditë, por
14 asnjëherë më shumë se 3 ditë".

15 Pra, më datë 3 prill shkuat dhe qëndruat vetëm 1 ditë,
16 apo qëndruat diçka më shumë në Prishtinë.

17 Pë. I nderuar Gjykatës, e thashë më 3 se nuk jam i sigurt, më
18 3 a 4. Se s'mund me dit. Pasi familja ime më 1 prill ka ardhur
19 në Zllash. Kanë qëndruar 3 ditë, nëse s'gabo, në shtëpitë
20 tona aty. Kam kërkuar prej babës me gjet një vend diku afër
21 aty edhe kanë shkuar në një shtëpi tjetër diku 250 metra larg
22 shtëpisë tonë.

23 Edhe kam shkuar në Prishtinë kam marrë gjëra ushqimore
24 edhe i kam pru.

25 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Pyetja ime është kjo: Sa

1 qëndrova në Prishtinë. Se zakonisht ke qëndruar në Prishtinë
2 2-3 ditë, por jo që të shkonit dhe te ktheheshit brenda të
3 njëjtës ditë. Nuk e kuptoj pse.

4 Pë. Kam shkuar, kam marrë ushqimin e jam kthyer. Nuk kam
5 qëndruar atë ditë. Po të vij në 12-13 orë -- se shumicën e
6 kohës kena ec në këmbë, me traktora.

7 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Në rregull. Mbase nuk jeni
8 kthyer brenda të njëjtës ditë?

9 Pë. Jam kthyer diku natën. Tash s'po di saktë. Thashë, 12 orë
10 ashtu.

11 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Në rregull. Kam një pyetje
12 tjetër. Në faqen 48 të transkriptit të djeshëm, rreshti 11
13 thatë që: "Dikush më thirri".

14 A kishit telefon?

15 Pë. Për datën 24 e ke fjalën, 27 mars?

16 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Po.

17 Pë. Telefona s'kena pas në atë kohë. Thashë, erdhën më
18 thirrën kur isha duke banuar tek lagja afër Medresës së
19 Prishtinës.

20 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Dje, në faqen 41, rreshti 1
21 dhe 2, po flisnit për serbët që kanë ardhur para 23 vitesh
22 tashti po me atë ditë, më 21 prill 1999 në Zllash dhe ju thatë
23 se serbët e shkatërruan. E kishit fjalën që shkatërruan
24 kompleksin ku jetonit ju?

25 Pë. Gjithçka shkatërruan. Çfarë kanë pas përpara.

1 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Se po të shohësh fotografitë
2 që janë bërë në vitin 2006, kjo s'është e vërtetë. Se
3 kompleksi nuk është shkatërruar. Ndërtesat aty janë, disa prej
4 tyre. Pse po thoni atëherë që është shkatërruar?

5 Pë. Objekti, oda, se me numër s'po më kujtohet, nëse ma qet
6 hartën mundem me ta shpjegue, është i granatum.

7 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Do t'i kërkoj Sekretares.
8 Faleminderit shumë, znj. Sekretare.

9 Pra, në fotografinë që kemi përpara po më thoni se, nëse
10 ju kuptova mirë, që 3, 4 dhe 5 janë shkatërruar nga granatimi.
11 Por, granatimi nuk ka prekur 13, 14, 11 dhe 10. Këtë po thoni?
12 Pë. I nderuar Gjykatës, 2, 3, 4 dhe 5 janë djegur këto. Janë
13 djegur këto tërësisht. 12, 19 janë te granatuar me tank.
14 Shihen edhe në fotografitë që janë.

15 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] 12 dhe cili tjetër? Nuk ka
16 19.

17 Pë. 19, 14 nuk a kanë. Në realitet në atë kohë, veç 13 a kanë
18 i paprekur.

19 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Por, po të shikojmë
20 fotografinë 12 është ende në këmbë, në vitin 2006. Po kështu
21 dhe 10, 13, 14. Po të ishte granatu, ato do të ishin
22 shkatërruar.

23 Pë. I nderuar Gjykatës. Është i demoluar prej tankut. Shihe
24 mirë në fotografi, unë kam edhe fotografi të tjera mbas luftës
25 që i kam ba. Nuk e di Avokati a e ka ndihmën një, duket shumë

1 mirë qysh e kanë granatu.

2 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Një moment, ju lutem.

3 Granatimi nuk është e njëjta siç është kur hyn tanku edhe
4 demolon plotësisht. U granatu me topa nga larg, a hynë tanket
5 aty? Si e keni fjalën?

6 Pë. Tanku e ka gjuajt prej afër këtë. Me sa kemi mundur të
7 kuptojmë ne. Se muret, tash nëse e shef fotografinë prej anës
8 së majtë. A mundem? Në këtë drejtim e kanë granatue. Janë edhe
9 fotografitë, nëse s'gaboj i ka, duhet me i pas Avokati një.
10 Jena dy persona duke ecur aty në fotografi.

11 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Pra, po më thoni që tanket
12 serbe po granatonin nga distanca, mbase distancë e shkurtër
13 por prapë nga distanca dhe po e granatonin kompleksin. Dhe po
14 më thoni që serbët nuk kanë hy, nuk kanë ardhur në kompleks.
15 Nuk hynë brenda kompleksit me tanket e tyre, apo hynë me
16 tanket?

17 Pë. Nuk e di, z. Gjykatës. Se unë s'kam qenë aty. Veç sipas
18 qysh e kena pa pastaj objektin, numri 12 është i gjuajtur me
19 tank. 2, 3, 4, 5 e këto të tjerat i ka djegë.

20 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Në rregull. Pak a shumë
21 kompleksi është goditur më së shumti me granatim predhash.

22 Z. VON BONE: [Përkthim] Mbase për të ndihmuar, të nderuar
23 Gjykatës. Ka një fotografi. Nëse shkojmë tek shtojcat, që i
24 janë bashkëlidhur, është 9, 11, 7.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Me

1 numër DSM00034. Kjo është lidhja numër 11.

2 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderur Gjykatës. Më duket se
3 DSM00032 tregon kompleksin nga jashtë, nga ana që e ka treguar
4 dëshmitari.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

6 Atëherë kjo është lidhja numër 9.

7 Z. VON BONE: [Përkthim] Edhe një tjetër.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

9 Avokat, nëse doni ta ndihmoni Trupin Gjykses, mjafton të
10 sugjeroni një. Sepse na keni sugjeruar disa fotografi. Nëse ka
11 një fotografi e cila do të na ndihmonte më shumë.

12 Z. VON BONE: [Përkthim] Mendoj se lidhja numër 9.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

14 Atëherë me numër DSM00032.

15 Znj. Sekretare po e kërkon.

16 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Atëherë, a është kjo ndërtesa
17 -- jo, një moment. Së bashku me këtë fotografi, a mundet ta
18 nxjerrim edhe fotografinë e mëparshme për ta pyetur nëse kjo
19 ndërtesë është ndërtesa 12. Por, ma merr mendja nga ana
20 tjetër.

21 Pë. Po, i nderuar Gjykatës. Kjo ndërtesë është.

22 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Dhe kjo fotografi është bërë
23 nga jashtë kompleksit, nga ana tjetër. Saktë e kam?

24 Pë. Po.

25 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Dhe ju po thoni që tanket

1 kanë gjuajtur, kanë granatu dhe është një pjesë që është
2 shkatërruar, që është në të majtë të kësaj fotografie. Është
3 një derë faktikisht dhe majtas derës është goditur nga tanku.
4 Pë. E rrumbullakosa këtu në dy vende. U demolua kjo, se kjo
5 ka qenë me llaç, shihet.

6 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Por, kur thoni u demolu,
7 është demolu nga granatimi?

8 Pë. Nga tanket, se granatimi.

9 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Ju kuptova, ju kuptova.
10 Faleminderit shumë për këtë, z. Dëshmitar.

11 Ju lutem, ta mbajmë fotografinë në ekran.

12 Kam edhe një pyetje të fundit.

13 Në atë ndërtesë, që është ndërtesa me numër 12, për atë
14 ndërtesë ju keni shpjeguar si në deklaratën që ia keni dhënë
15 Avokatit të Mbrojtjes, por edhe dje Mbrojtëses së Viktimave,
16 që është në faqen 153, se muret janë bërë prej llaçi, baltë
17 dhe bar i thatë, kashtë. Ka dhe një bodrum të asaj shtëpie, të
18 shënuar me numrin 12 të cilën e shohim edhe tek fotografia që
19 është këtu në të djathtë, dhe ju thatë dje që në atë ndërtesë
20 dhe bodrumi ishte bërë me llaç e kashtë.

21 Ju, a keni shkuar në atë bodrum?

22 Pë. Aty jam rrit shumicën e kohës. Çdo pushim e kam kaluar
23 aty. Beton nuk ka pas. Përpos të numrit 2, që ka qenë me
24 beton, të tjerat krejt janë ba me llaç.

25 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Në atë bodrum, thatë që muri

1 s' ishte i mirë, ishte i dobët. Është në DSM00011. A ju
2 kujtohet nëse në atë bodrum mund të shikoje matanë murit,
3 domethënë a hynte drita nëpër mur, nëpër vrima të murit?
4 Pë. I nderuar Gjykatës, ka pas edhe dritare. Nuk di a shihet
5 në fotografi. Është në një fotografi tjetër ku duket që ka pas
6 dritare.

7 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Pra, bodrumi i ndërtesës
8 kishte edhe një dritare?

9 Pë. Po. Kqyre mirë se ka një dritare.

10 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Në rregull. Nuk kam pyetje të
11 tjera. Faleminderit shumë për sqarimet.

12 Faleminderit znj. Kryetare e Trupit Gjykses.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Kam
14 unë një pyetje të fundit përpara se ta mbyllim dëshminë tuaj,
15 z. Dëshmitar.

16 Dje thate se BIA ka qëndruar në Zllash. Dhe referenca
17 është faqja 11, rreshti 2 deri në 5.

18 Pra, njerëz të BIA-s, nëse e kuptova mirë, kanë qëndruar
19 atje?

20 Pë. Po.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po
22 kështu, na thatë se drejtuesi i BIA-s dhe prit që ta shikoj --
23 ju thatë që e kuptuat që drejtuesi i BIA-s ishte Cali.

24 Pë. Po.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dhe

1 është në faqen 111, rreshti 3 deri në 12.

2 Pë. Po.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Por,
4 po e lexoja edhe njëherë deklaratën që i keni dhënë Mbrojtjes,
5 që është me numër DSM00013. Pra, është deklarata që ia keni
6 dhënë Avokatit Mbrojtës. Pyetja është:

7 "Cali, a kishte ndonjë autoritet në atë vend"?

8 Dhe për kontekstin besoj se bëhet fjalë për Zllashin, më
9 saktë për shtëpitë e familjes suaj.

10 Pë. Po, po.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
12 jeni përgjigjur: "Cali vinte një apo dy ditë, nuk e dinte
13 askush se kush ishte. Të tjerët nuk e njihnin. Një person i
14 mirë, i urtë modest..."

15 Pë. Po.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
17 "...Nuk kishte influencë". Unë e kuptoj që s'kishte influencë
18 në atë vend, por a kishte ai influencë ndikim tek anëtarët e
19 njësitit BIA të cilët ndodheshin në Zllash?

20 Pë. Po normal që ata e kanë dëgjuar, e kanë pas komandant. Ka
21 qenë gjithçka në rregull me e dëgju këto.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo,
23 për ta pasur të qartë, se këtu Mbrojtjes i keni thënë se "s'ka
24 pas ndikim, influencë". Një moment. Se si mund të jesh
25 udhëheqës drejtues e të mos kesh influence. Por, sepse në

1 rastin konkret kur je udhëheqës, jep dhe urdhra, je ti që jep
2 urdhrat.

3 Pë. Varet çfarë përshtypje krijojnë njerëzit për ty. Ka
4 qenë...

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
6 Megjithatë, të mos hyjmë tek kjo. Ishte drejtues i BIA-s...

7 Pë. Po.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
9 ...kështu na thatë.

10 Pë. Po.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ka
12 pasur ushtarë të BIA-s që kanë qenë në Zllash, dhe nëse ju
13 kuptova mirë kur thatë që nuk kishte influencë, nuk desha të
14 thosha që s'kishte influencë mbi anëtarët e tij.

15 Pë. Unë këtë influencë, s'po e kuptoj mirë çka po don me
16 thanë.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
18 Mustafa, duke qenë se ishte udhëheqës i BIA-s, a kishte
19 pushtet autoritet mbi anëtarët e BIA-s të cilët ndodheshin në
20 Zllash?

21 Pë. Z. Mustafa kur ka ardhur atje, e kanë respektu krejt
22 domethënë --

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo,
24 pyetja ishte: A kishte autoritet mbi anëtarët e BIA-s të cilët
25 ndodheshin aty?

1 Pë. Normal që ka pas autoritet.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Faleminderit. Në këtë rast ma sqaruat pyetjen.

4 Shumë mirë. Jemi në fund të dëshmisë suaj, z. Krasniqi.

5 Dëshiroj t'ju falënderoj shumë për përpjekjet që keni bërë për

6 të dhënë dëshminë tuaj gjithë ditën dje edhe sot, deri tani.

7 Ju uroj udhëtim të mbarë në kthim. Ngul këmbë që të mos

8 bisedoni për dëshminë që keni dhënë këtu para Dhomave të

9 Specializuara me askënd. Faleminderit edhe njëherë.

10 DËSHMITARI: Faleminderit edhe prej jush e nderuar

11 Gjykatëse. Shpresojmë edhe besojmë në drejtësinë e juaj.

12 Faleminderit shumë.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

14 Faleminderit.

15 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

17 Faleminderit znj. Asistente e sallës.

18 Është thuar se ora 11.00. Do të bëjmë pushim deri në orën

19 11.30. Pastaj do të vazhdojmë me dëshminë e Dëshmitarit me

20 numër 1500, dëshmitari me emrin Muhamet Ajeti.

21 Ndërpritet këtu seanca.

22 --- Pauza fillon në orën 10.54

23 --- Seanca rifillon në orën 11.30

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

25 Mirë se u rikthyet.

1 Vë re që ka një ndryshim në ekipin e të pranishmëve. I
2 jap fjalën ZPS-së.

3 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Po, të nderuar Gjykatës, ka një
4 ndryshim të vogël në ekipin e Prokurorisë. Në emër të Filipo
5 de Minicis, jam unë Cezary Michalczuk. Pjesa tjetër është si
6 më parë. Silvia D'Ascoli, Zëvendësprokurore dhe Julie Mann,
7 Menaxhere e Lëndës.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
9 Faleminderit.

10 Vë re që edhe ekipi i Mbrojtjes së të akuzuarve, ekipi i
11 Mbrojtjes së të pandehurve, së të Viktimave - më falni - ka të
12 njëjtën përbërje.

13 Do të vijojmë tani me dëshminë e Dëshmitarit 1500, z.
14 Muhamet Ajeti.

15 Znj. Asistente e Sallës, ju lutem shoqëroni dëshmitarin
16 të hyjë në sallë.

17 [Dëshmitari hyn në sallën e gjyqit]

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
19 Mirëdita z. Ajeti. Mirë se keni ardhur në Dhomat e
20 Specializuara. Më dëgjoni mirë?

21 DËSHMITARI: Po.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
23 Shumë mirë. Së pari, si jeni?

24 DËSHMITARI: Mirë, faleminderit.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në

1 rregull. Do të fillojmë sot me dëshminë tuaj. Ju kanë thirrur
2 të dëshmoni përpara Dhomave të Specializuara në çështjen
3 gjyqësore Prokurori i Specializuar kundër Salih Mustafës për
4 ta ndihmuar Trupin Gjykses në marrjen e një vendimi. Pasi të
5 keni bërë deklaratën solemne për të thënë të vërtetën do t'ju
6 bëjë pyetje Avokati i Mbrojtjes, Përfaqësuesi i Prokurorisë
7 dhe Mbrojtësja e Viktimave dhe në fund fare mund t'ju bëjnë
8 pyetje dhe anëtarët e Trupit Gjykses, ne Gjykatësit. Dëshiroj
9 t'ju jap disa udhëzimeve sesi tu përgjigjeni pyetjeve që do
10 t'jua bëjnë.

11 Z. Ajeti, jua them mirë mbiemrin, Ajeti?

12 DËSHMITARI: Po.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

14 Shumë mirë, në rregull.

15 Dëgjojeni me kujdes secilën pyetje. Nëse nuk e kuptoni
16 lirisht mund të kërkoni që pyetjen t'jua përsërisin. Duam të
17 na thoni të vërtetën. Të na tregoni çfarë keni parë, çfarë
18 keni përjetuar, çfarë keni ndier, çfarë keni dëgjuar vetë.
19 Nëse e keni marrë vesh në ndonjë mënyrë tjetër, na e thoni dhe
20 këtë që e keni marrë vesh kështu. Mund të mos ju kujtohen të
21 gjitha hollësitë. S'ka asgjë të keqe nëse thoni nuk e di apo
22 nuk më kujtohet.

23 Ju lutem përgjigjuni pyetjeve. Nëse ka nevojë për sqarim
24 pastaj, do t'jua kërkojmë sqarimet. Kur të jeni duke u larguar
25 nga pyetja në përgjigjen tuaj do t'ju ndalojmë, do t'ju themi

1 që mos vazhdoni më.

2 Ju rikujtoj që mund të mos pranoni t'u përgjigjeni
3 pyetjeve për gjëra, të cilat mund t'ju fajësojnë.

4 I kuptuat të gjitha këto?

5 DËSHMITARI: Po.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

7 Dëshiroj t'ju jap tani disa këshilla praktike për dëshminë
8 tuaj, z. Ajeti.

9 Gjithçka që thuhet këtu përkthehet dhe regjistrohet.
10 Prandaj dhe është shumë e rëndësishme që të flisni sa më afër
11 mikrofonit.

12 Mbase znj. Asistente e Sallës t'ia afrojmë diçka më shumë
13 mikrofonat dëshmitarit.

14 Pastaj përkthyeset mund të na thonë nëse ka probleme.
15 Pra, është e rëndësishme të flisni sa më afër mikrofonit, të
16 flisni qartë dhe të flisni ngadalë për t'u dhënë mundësi
17 përkthyesve të përkthejnë gjithçka që thuhet.

18 Të filloni të flisni vetëm pasi të ketë mbaruar personi
19 që jua bën pyetjen. Kjo është shumë e rëndësishme. Ju lutem
20 numëroni me vete deri në pesë pasi të ketë mbaruar pyetja
21 pastaj filloni të flisni, sepse kjo u jep mundësi përkthyesve
22 që ta përfundojnë përkthimin dhe na jep mundësi që të shmangim
23 rastet kur mbivendosen folësit.

24 Nëse unë do ta ngre dorën mos flisni më. Do t'jua bëj
25 shenjë me dorë se preferoj që të mos flas që të mos ketë

1 mbivendosje. Unë do të ngre dorën. Ju mund të mbaroni fjalinë
2 dhe pastaj do të vazhdojmë.

3 Ndonjëherë mund t'ju kërkojmë t'i hiqni dëgjueset ose
4 mund të kërkojmë që t'ju shoqërojnë të dilni nga salla nëse do
5 të diskutojmë një pyetje përpara se t'jua bëjmë pyetjen.

6 Po të keni pyetje, po të keni nevojë për pushim apo
7 dëshironi t'i thoni diçka Trupit Gjykues, mjafton të ngrini
8 dorën dhe unë do t'jua jap fjalën.

9 I kuptuat të gjitha këto?

10 DËSHMITARI: Po, e nderuara Gjykatëse.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

12 Shumë mirë. A flisni anglisht z. Ajeti?

13 DËSHMITARI: Jo.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
15 rregull. Faleminderit.

16 Si me çdo dëshmitar, do t'ju kërkoj tani të lexoni
17 deklaratën solemne për të thënë të vërtetën. Ju rikujtoj se
18 përbën vepër penale në juridiksionin e Dhomave të
19 Specializuara dhënia e dëshmisë së rrejshme.

20 E kuptoni këtë?

21 DËSHMITARI: Po.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
23 rregull.

24 Znj. Asistente e Sallës, ju lutem ndihmoheni dëshmitarin
25 me deklaratën solemne. Ah ia paskeni dhënë. Në rregull.

1

2 Z. Ajeti, ju lutem lexoni tekstin që jua kanë dhënë.

3 DËSHMITARI: I ndërgjegjshëm për rëndësinë e dëshmisë sime
4 dhe përgjegjësinë time ligjore deklaroj solemnisht se do të
5 them të vërtetën, krejt të vërtetën dhe vetëm të vërtetën dhe
6 nuk do të mbaj të fsheftë asgjë për të cilën kam dijeni.

7 DËSHMITARI: MUHAMET AJETI

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

9 Shumë faleminderit z. Ajeti. Tani jeni në betim për të treguar
10 të vërtetën.

11 Tani do fillojmë me z. Ajeti, pra me dëshminë e z. Ajeti
12 duke filluar me marrjen në pyetje të Avokatit të Mbrojtjes. Z.
13 Avokat, keni planifikuar dy orë për këtë dëshmitar dhe si
14 zakonisht ju lutem na informoni në qoftë se ka ndonjë ndryshim
15 në afatin e planifikuar për marrjen në pyetje.

16 Fjala për ju.

17 Z. VON BONE: [Përkthim] Shumë faleminderit, e nderuar
18 Gjykatëse. Nuk besoj se do ta përdor të gjithë kohën e
19 kërkuar.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Kemi
21 një seancë shtesë të planifikuar dhe një pushim më të
22 shkurtër. Kjo thjesht sa për koment të përgjithshëm. Pra do
23 përdorim kohën që na nevojitet. Por le të jemi të gjithë të
24 përqendruar lidhur me atë çfarë do të bëjmë sot në mënyrë që
25 të mbarojmë si gjithmonë kuptohet.

1 Z. VON BONE: [Përkthim] Shumë faleminderit, e nderuar
2 Gjykatëse.

3 Pyetje nga z. Von Bone:

4 Py. Mirëdita z. Dëshmitar.

5 Pë. Mirëdita.

6 Py. Do kaloj disa tema bashkë me ju dhe kaq është seanca.

7 Z. Dëshmitar, a ju kujtohet në vitin 1999 që forcat e
8 NATO-s' filluan bombardimet në Kosovë.

9 Pë. Po, më kujtohen, i nderuar Avokat.

10 Py. A e dini sesa ka qenë data atë ditë?

11 Pë. Po. 24 mars 1999.

12 Py. Shumë faleminderit. Në atë kohë cili ishte fshati apo
13 qyteti ku jetonit ju?

14 Pë. Në atë ditë kur ka bombardu NATO, kam qëndru në Prishtinë
15 në shpinë time.

16 Py. Në rregull. A ju kujtohet në qoftë se në momentin kur
17 filluan sulmet ajrore të NATO-s, a kishte ndonjë ndryshim të
18 caktuar që e përjetuat në Kosovë, në Prishtinë?

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

20 Ndryshim të çfarë natyre?

21 Z. VON BONE: [Përkthim]:

22 Py. Ndryshim të situatës.

23 Pë. Në momentin kur ka bombardu NATO sigurisht a konë një
24 ndryshim. A konë ma së pari gëzim.

25 Py. Unë pyeta në qoftë se ka pasur ndonjë ndryshim të

1 situatës. A mund të na e përshkruash pak të lutem?

2 Pë. Atë natë nuk ka pasë ndonjë ndryshim të madh përveç që u
3 shfaq një gëzim në të gjithë familjen time, që u vërejt. Të
4 nesërit kanë fillu ndryshime të tjera.

5 Py. A mund të na shpjegosh të lutem se çfarë ndryshimi ndodhi
6 faktikisht?

7 Pë. Ndryshimi, që ai ndryshim u vërejt se fillun forcat serbe
8 të lëvizshin ma shumë. Fillun edhe popullata tani të
9 shqetësohet. Fillimisht ishte gëzim, tani filloi hidhnim se ia
10 nisën forcat serbe me lëvizë, ia nisi popullata me i lëshu
11 shpiat nga pak, ato ditët e para.

12 Py. A kishte shumë njerëz që largoheshin nga shtëpitë e tyre,
13 që i lëshojshin shpiat?

14 Pë. Po ashtu ditët e para nuk u mujt me vërejt shumë po veç
15 kanë fillu të largohen disa kush ka pasë në fshatra afër
16 Prishtinës. Tani dikur ma vonë veç ka fillu edhe kështu dëbimi
17 i dhunshëm nga shtëpitë.

18 Py. Kur u dëbojshin ku shkonin njerëzit, në çka drejtimi
19 shkonin?

20 Pë. Kryesisht qytetarët e Prishtinës janë shku në drejtim të
21 Gollakut.

22 Py. E kuptoj. A e dini arsyen pse shkonin ata në Gollak?

23 Pë. Arsyeja ka qenë frika, frika se fillun forcat serbe me
24 hi, me dëbu, me i rrah -- kanë ndodhur ksi raste.

25 Py. Pse shkonin në Gollak dhe nuk shkonin në një tjetër

1 rajon, në një tjetër zonë?

2 Pë. A konë, i nderuar Avokat, a konë e pamundshme me shku në
3 zona të tjera. Prishtina lidhur me Gollakun dhe aty e kanë
4 pat më afër, me u konë ma larg nuk ka mujt me depërtu krejt
5 Prishtina me shku në Drenicë apo dikund tjetër. Gollaku u konë
6 ma afër Prishtinës edhe aty janë drejtu. Arsyeja pse dihet pak
7 ma - u konë zonë ma e lirë.

8 Py. Çarë do të thuash kur thua zona ka qenë pak më e lirë?

9 Pë. Mendoj që në atë kohë nuk ka pasë luftime ose domethënë
10 forcat serbe në Gollak. Edhe kanë ikë në Gollak kanë shku.
11 Edhe kanë pasë shpiat e veta, në q'atë kuptimin.

12 Py. E kuptoj. Po ti vetë a u largove nga Prishtina?

13 Pë. Po.

14 Py. Ku shkove?

15 Pë. Domethënë ditën kur e kam lëshu Prishtinën, kam shku në
16 fshatin Zllash.

17 Py. E kuptoj. A keni qenë pjesëtar i UÇK-së ju vetë?

18 Pë. Po.

19 Py. Që prej çfarë kohe? Kur jeni kyçur në UÇK?

20 Pë. Unë jam kyçur në UÇK diku në fund të qershorit ose në
21 fillim të korrikut të vitit 1998 në Shalë të Bajgorës, në
22 Zonën Operative të Llapit.

23 Py. Në rregull. Shala e Bajgorës, a mund të na e thoni, nga
24 Prishtina ça drejtimi duhet të shkosh për të shku aty? Është
25 në veri, në jug, në perëndim, në lindje, në çfarë drejtimi?

1 Pë. Në Shalë të Bajgorës mund me shku nga Mitrovica, por
2 mundesh me shku edhe nga Podujeva. Nëse më pyt mund ka je
3 shku, unë kam shku krejt diku jo rrugëve të asfaltume po kam
4 shku në tjetërkund.

5 Py. Si keni shku?

6 Pë. Unë kam shku me autobus prej Prishtine deri në fshatin
7 Majac. Edhe prej fshatit Majac aty kam zbrit se s'ka pasë më
8 autobus dhe kam shku në kambë deri në Shalë të Bajgorës,
9 pikërisht në fshatin Bajgorë që quhet.

10 Py. E kuptoj. Aty u kyçët në UÇK?

11 Pë. Po.

12 Py. A kishte -- jeni kyçur në ndonjë brigadë, në ndonjë
13 njësit të caktuar? Kishte ndonjë gjë aty?

14 Pë. Kur kam shku në Shalë të Bajgorës aty ka qenë një
15 shkollë. Në fillim ka qëndru Zona Operative e Llapit. Aty z.
16 Avokat ta kam spjegu dhe domethënë dy ditë kur kam shku herën
17 e parë më kanë kthy për shkak se kanë thonë që është numri i
18 mbushur edhe je i ri. Edhe më kanë kthy. Tani të nesërit kam
19 shku prapë në të njëjtin vend edhe kom insistu me nejt edhe më
20 kanë pranë.

21 Py. E kuptoj. Sa vjeç ishe në atë kohë?

22 Pë. 17 vjet dhe nja dy-tre muj q'ashtu.

23 Py. E kuptoj. Na thatë se u larguat nga Prishtina dhe shkuat
24 në Zllash. Afërsisht kur ka ndodhur kjo? Sa kohë pas
25 bombardimeve të NATO-s?

- 1 Pë. Nëse s'gaboj data 30 ose 31 mars 1999 e kom lëshu
2 Prishtinën. Besoj këto janë dy data të mundshme. Unë nuk muj
3 me thonë se cila është njëqind për qind.
- 4 Py. Në rregull. Si shkuat në Zllash?
- 5 Pë. Po në anë të transporti. Kena me shku në këmbë domethënë.
- 6 Py. Po, po për këtë e kam fjalën.
- 7 Pë. Në këmbë.
- 8 Py. Sa kohë t'u desh për të shkuar në Zllash?
- 9 Pë. Mendoj që nja 5 orë dikund, 4-5 orë kemi bo në kambë.
10 Ndoshta dhe 6, s'po më kujtohet saktë.
- 11 Py. Në rregull. Në atë kohë a mund të përdornit rrugën
12 normale ju për të shkuar në Zllash?
- 13 Pë. Jo. Në rrugë malore kemi shku.
- 14 Py. Në rregull. E kuptoj. Pse shkuat në Zllash?
- 15 Pë. Se atje ishin domethënë kryesisht një pjesë e madhe e
16 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe atje kena pasë me shku në
17 Zllash.
- 18 Py. E kuptoj. Çfarë pjese e UÇK-së ishte atje?
- 19 Pë. Pjesë domethënë e Zonës Operative të Llapit.
- 20 Py. E kuptoj. Atje shkuat si ushtar, si person i zhvendosur,
21 apo si? Të dërguan në Zllash apo shkove vetë me dëshirën
22 tënde në Zllash?
- 23 Pë. Kemi shku me disa ushtarë të tjerë, me të cilët jemi taku
24 në Prishtinë edhe e kemi lëshu Prishtinën dhe kemi shku në
25 Zllash. Jena konë një numër -- s'e di saktë ndoshta 10-15

1 vetë, nuk më kujtohet në detaje sa ushtarë janë konë, po me
2 gjithë disa ushtarë të UÇK-së kemi shku në Zllash.

3 Py. Kur thua "Zllash", çfarë do të thuash konkretisht me
4 këtë? Ku shkove ti konkretisht?

5 Pë. Në fshatin Zllash, janë do shpia aty të Zllashit.

6 Py. A e njihnit ndonjë person atje? Pse shkut pikërisht tek
7 ai vend?

8 Pë. Po aty shkum se edhe kom qenë një kohë ma herët në
9 dhjetor të 98-s dhe shumica e ushtarëve dijshin ku kena me
10 shku në një shtëpi ku kam njoftë aty disa ushtarë. Edhe me
11 këta që kam shku edhe kur kam shku aty i kam njoftë.

12 Py. E kuptoj. A mund të na e përshkruani atë vend ju lutem? A
13 na e përshkruani dot këtë vendin që thoni që kishte disa
14 shtëpia aty?

15 Pë. Vendi ku kemi shku është dikun mbi shkollë të Zllashit,
16 ndoshta nja 1 kilometër ose 700-800 metra, në njërin prej
17 ktyne shpijave.

18 Py. Në rregull.

19 Pra, ju shkuat atje, qëndruat aty apo - çfarë bëtë?

20 Pë. Po ditën - kena shku në mëngjes, dikund para se me u
21 zditë edhe aty kam qëndru 4-5 orë, kam flejt pak. Edhe të
22 nesërit kur jam çu, kam shku e kam kërku familjen e cila ishte
23 vendos në fshatin Keçekollë te dajës së babës tem. Domethënë
24 baba jem ka shku te dajat e vet. I kam taku aty edhe kam
25 qëndru për nja dy ditë ose tri në Keçekollë te dajat e babës.

1 Py. Në rregull. Po këta ushtarët e tjerë që erdhën me
2 shtypin, shkun me ty në Zllash, edhe ata qëndruan aty në
3 Zllash?

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
5 Avokat, është hera e tretë që përfshive dhe përgjigjen në
6 pyetje. Domethënë herën e parë thatë që pse shkuan në Zllash.
7 Do të ishte një pyetje më e mirë dhe sërish domethënë ju lutem
8 formulojeni ndryshe këtë fjalinë. Çfarë bënë ushtarët e tjerë?

9 Z. VON BONE: [Përkthim]:

10 Py. Këta ushtarët e tjerë me të cilët ti shkove në Zllash, ku
11 shkun këta?

12 Pë. Ata i kam lënë në Zllash edhe kur jam kthyer një pjesë e
13 kam taku prapë, një pjesë e atyne ushtarëve.

14 Py. E kuptoj. Kur mbërritët në Zllash, si ishte situata aty?
15 A mund të na e përshkruani ju lutem se cila ishte situata aty,
16 në kuptimin në qoftë se kishte shumë njerëz apo jo?

17 Pë. Po, i nderuar Avokat, kur kemi mbërri në Zllash, në atë
18 shpi, më kujtohet që a konë oborri plot njerëz, u marrshin me
19 popullatën me vendosjen e tyre, q'ashtu a konë, të hallakat me
20 katrahurë si me thonë. A konë plot njerëz. Saktë nuk e di po
21 ndoshta 50-60 njerëz. A konë gra, fëmijë, ushtarë ka pasë kur
22 kemi mbërri domethënë në datën 30 ose 31 mars. Në atë shtëpi u
23 konë oborri plot njerëz tu i vendosë nëpër dhoma, nëpër -- që
24 kishin mbërri para nesh.

25 Py. Ku flinin këta njerëz?

1 Pë. Po aty kanë fjetë.

2 Py. E kuptoj. The që shkove atje te një shtëpi, kishte më
3 shumë sesa një shtëpi aty? A mund të na e shpjegosh pak atë
4 vend?

5 Pë. Ndoshta janë konë dy shtëpia, ndoshta janë konë dy.
6 Domethënë aty ka pasë si me thonë njana me tjetrën si përballë
7 kështu, brenda një oborri janë konë dy shtëpia të vjetra.

8 Py. Po tjetër çfarë kishte aty në qoftë se ju kujtohet?

9 Pë. Çka po mendon tjetër?

10 Py. Sa i takon ndërtesave, njerëzve, ndoshta ushtarëve.

11 Pë. Ato shtëpijat kanë qenë dy shpia, kanë qenë plot me
12 njerëz, diçka tjetër s'po di kështu. Si me thonë konkretisht
13 nëse pyet diçka.

14 Py. Kishte më shumë sesa dy shtëpi aty sa i takon
15 strukturave, godinave që ekzistojnë?

16 Pë. Unë mendoj dhe sa e di kanë qenë dy shpija të banueshme
17 që kanë mujt me fjetur njerëzit.

18 Py. Në rregull.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

20 Avokat, një gjë nuk e kam të qartë.

21 Z. Dëshmitar, këto shtëpitë ku qëndronin njerëzit, ishin
22 ngjitur me njëra-tjetrën apo ishin ballë për ballë me njëra
23 tjetrën sepse dhatë dy përgjigje. Një herë the që ishin
24 ngjitur me njëra-tjetrën ose ndoshta ishin përballë njëra
25 tjetrës. Dhe nuk e di se çfarë do të thuash ekzaktësisht.

1 DËSHMITARI: Jo. E nderuara Gjykatëse unë thashë kanë qenë
2 ballë për ballë me një oborr. E kam të kuartë?

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Për
4 mua nuk është e qartë, domethënë përballë njëra-tjetrës,
5 domethënë një shtëpi ishte këtu, pastaj ishte kopshti, pastaj
6 ishte shtëpia tjetër apo ishin përbri njëra-tjetrës? Nuk e
7 kam ende të qartë.

8 DËSHMITARI: Sikur kjo me këtë, kështu domethënë si
9 përballë.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
11 lutem na e shpjego me fjalë. Domethënë ishin përballë me njëra
12 tjetrën, ç'a do të thotë që dera e njëres shtëpi ishte përballë
13 me derën e shtëpisë tjetër, kjo është?

14 DËSHMITARI: Po, e nderuara Gjykatëse, kanë qenë në një
15 oborr ballë për ballë me njëra-tjetrën, shtëpitë përballë. Me
16 sa më kujtohet mu kështu ka qenë.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
18 Faleminderit.

19 Z. Avokat, ju lutem vazhdoni.

20 Z. VON BONE: [Përkthim]

21 Py. Thatë që shkuat në Keçekollë. Për sa kohë qëndruat atje?
22 E para njëherë -- pyetja e parë është pse shkuat atje?

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
24 Dëshmitar, ju lutem hiqini pak dëgjueset. Vendosini përpara.
25 Po, faleminderit.

1 Z. Prokuror, e keni ju fjalën.

2 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Pyetja u bë dhe mori përgjigje.

3 Në veçanti kur flitet për numrin e ditëve që dëshmitari
4 qëndroi atje. Unë në qoftë se është e nevojshme mund të jap
5 edhe referencë për këtë, është në faqen 49, rreshtat nga 18
6 deri në 22.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po
8 ishte për dy-tre ditë dhe shkoi për të vizituar familjen në
9 Keçekollë.

10 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Po, këtë tha.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
12 Avokat, në qoftë se doni të bëni një pyetje pasuese se doni të
13 sqaroni diçka ju lutemi referojuni kësaj gjëje dhe pastaj
14 vazhdoni me pyetjen pasuese.

15 Faleminderit.

16 Z. VON BONE: [Përkthim]

17 Py. Z. Dëshmitar, më falni.

18 Z. Dëshmitar, thatë se shkuat te familja juaj dhe u
19 kthyet prapë në Zllash. A mund të na thoni ju lutem në qoftë
20 se qëndruat në Zllash apo jo? Pasi u kthyet nga Keçekolla kur
21 kishit vizituar familjen?

22 Pë. I nderuar Avokat, aty kam qëndru tek dajat nja dy ditë
23 ose tri dhe mandej jam kthy në Zllash. Dhe kohën tjetër derisa
24 është nisë ofensiva në fshatin Viti, kam qëndru herë pas here.
25 Ka ndodh kam ndejt ditën në Zllash kam shku me bujt prapë te

1 dajat se nuk a kanë larg. Edhe për shkak se shpijat e
2 mbingarkume popullatë edhe thua jse ma shumë kam qëndru te
3 dajat. Po ditën kam ardhë shumicën e kohës në Zllash deri në
4 fillimin e ofensivës në fshatin Viti e Marecit.

5 Py. A ju kujtohet se kur filloi ofensiva në Viti të Marecit?

6 Pë. Me sa e di unë, diku më 16 prill ka fillu ofensiva. Unë
7 prej 16-it kam qëndru në Viti deri në përfundimin e asaj
8 beteje si ta qujmë. Besoj se më të 16-in jam shku aty.

9 Py. Ju kuptoj.

10 Z. VON BONE: [Përkthim] Znj. Sekretare, ju lutem dëshiroj
11 t'i tregoj një fotografi dëshmitarit.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
13 Dëshmitar, ju lutem t'i hiqni dëgjueset.

14 Z. Avokat, përse është fotografia? Çfarë ka në
15 fotografi?

16 Z. VON BONE: [Përkthim] Është një fotografi e kompleksit.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
18 rregull. Një farë përcaktimi që ta di se çfarë do të shfaqë
19 fotografia që unë të jap dhe lejen.

20 Mund ta shfaqni.

21 Z. VON BONE: [Përkthim] Me numër DSM00069 -- DSM000629 -
22 më falni.

23 Py. Z. Dëshmitar, e shihni fotografinë përpara në ekran?

24 Pë. Po.

25 Py. Mbase mund ta zmadhojmë paksa?

- 1 Pë. Mirë është, mund të shihet.
- 2 Py. E njihni këtë vend?
- 3 Pë. Po.
- 4 Py. Mund të na thoni ç'është ky vend?
- 5 Pë. Ky është ai vendi, në të cilin kemi shku prej Prishtinës
- 6 në Zllash. Këtu janë ato shpijat, të cilat ju thashë ma herët.
- 7 Py. Kur keni shku në Zllash, kur mbërritët në Zllash, mund të
- 8 shkonit lirisht në këto shpija apo duhet të identifikoheshit,
- 9 të tregonit që ishit ushtarë, diçka?
- 10 Pë. Jo, s'ka pasë nevojë me u identifiku. Jena shku vetë
- 11 domethënë se e kena ditë që ka ushtarë këtu edhe kemi shku.
- 12 Py. Veç ushtarëve, a kishte dhe njerëz të tjerë aty?
- 13 Pë. Po, i nderuar Avokat.
- 14 Py. Ç'lloj njerëzish?
- 15 Pë. Qysh u thashë edhe ma herët, ka pasë civilë goxha shumë,
- 16 që në atë periudhën mbasi jemi ardhë prej Prishtinës.
- 17 Py. Ju ishit ushtar. Ushtarët që ishin aty, nga ishin ata e
- 18 dini ju vetë?
- 19 Pë. Shumica kanë qenë të Komunës së Prishtinës, ushtarët.
- 20 Py. Kuptoj. Këtë e kuptoj, por e kam fjalën nëse e dini nëse
- 21 bënin pjesë në ndonjë brigadë të caktuar apo në njësi të
- 22 tjera? Apo në ndonjë zonë? Apo bënin pjesë në ndonjë zonë, e
- 23 dini këtë?
- 24 Pë. Kryesisht janë konë ushtarë të cilët janë konë të
- 25 Zllashit domethënë. Tash ma vonë domethënë ndoshta kanë kalu

1 në brigada të tjera, po ka pasë domethënë edhe të brigadave të
2 tjera.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
4 Avokat, për mua pyetja nuk ka marrë përgjigje. Dua të jetë më
5 konkrete.

6 Z. Dëshmitar, përse e keni fjalën kur thoni "ushtarë të
7 Zllashit"? Këta ushtarë bënë pjesë në ndonjë brigadë apo në
8 ndonjë njësi?

9 DËSHMITARI: E nderuar Gjykatëse, të gjithë ushtarët s'kam
10 mujt me i njoftë se jam konë, domethënë nuk jam konë tu qëndru
11 gatë. Po një pjesë të tyre i njoh, të cillët edhe i kam taku
12 në dhjetor të '98-s. Një pjesë të tyre tani janë konë të
13 brigadës po për '98-n nuk e di në çfarë brigade janë konë, se
14 janë konë --

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Cila
16 brigadë? Më falni. Cilës - pra nuk e dinit në vitin '98, po në
17 mars dhe prill të vitit '99?

18 DËSHMITARI: Një pjesë e tyre kanë qenë të brigadës,
19 domethënë një pjesë por krejt nuk i mbaj mend.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Kur
21 thoni "brigadë", "të brigadës" pra, për çfarë e keni fjalën?
22 Sepse ne deri tani kemi dëgjuar brigada me numra të ndryshme,
23 pra disa brigada. Për cilën brigadë e keni fjalën tani?
24 Konkretisht për cilën brigadë?

25 DËSHMITARI: Për Brigadën 153. Ka mujt me konë edhe ndonjë

1 ushtar i Brigadës 153 në atë farë shpije.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Kishte ushtarë të tjerë nga brigada të tjera, me sa keni
4 dijeni, me sa dini?

5 DËSHMITARI: Ushtarë ka pasë të guerilës së Prishtinës
6 edhe të brigadës, të brigadës 153.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

8 Dëshmitar, herën tjetër nëse ju japin, nëse ju bëjnë një
9 pyetje duhet të jepni përgjigje në atë pyetje konkretisht. Se
10 jeni këtu që t'i jepni Trupit Gjykues informacionin që keni.
11 Nuk do të doja të humbim kohë, të çonim kohën dëm me
12 përgjigje gjysmake në mënyrë që të merrnim informacionin e
13 plotë. Ju lutem, këtë informacion e dinit, mund ta thoshit që
14 në fillim.

15 Z. Avokat, keni fjalën.

16 Z. VON BONE: [Përkthim]:

17 Py. Z. Dëshmitar, dua që t'ju pyes, t'ju rifreskoj kujtesën.

18 Dua që ta kujtoni në qoftë se ju kujtohet - pra keni shkuar
19 aty, dua të flas enkas, pra, vetëm për këtë grup të veçantë,
20 ndërtesën që është këtu. Ka pasur ndonjë gardh rrethues rreth
21 këtyre ndërtesave?

22 Pë. Jo. Unë s'kam pa që ka pasë.

23 Py. Po portë nëpër të cilën duhet të hynin njerëzit, portë me
24 një tra?

25 Pë. Po shumica a kanë këtu e hapur domethënë ka ke dashë ke

Dëshmitari: Muhamet Ajeti (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Von Bone

Faqe 63

1 mujt me hi. A konë dhe gjysa ndoshta muj me thonë që u konë pa
2 gardh kështu e ke muj me hi ka të dush, për të cilën në dy-tre
3 pjesë ke mujt me hi në këtë shpi.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

5 Hiqini dëgjueset, z. Dëshmitar.

6 Z. Avokat, e kemi fotografinë këtu përpara nesh. Dhe nëse
7 e kuptoj mirë, e ka edhe dëshmitari këtë fotografi. Preferoj
8 që t'i bëni pyetje pa e parë dëshmitari fotografinë se nëse ai
9 e shikon në ekran nuk e di tani a thotë me ç'i kujtohet apo
10 flet për atë çka shikon në fotografi?

11 Z. VON BONE: [Përkthim] E kuptoj, por -

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk
13 ka por këtu. Ju i bëtë pyetje për gardh rrethues dhe portë dhe
14 unë e shoh që dëshmitari vështron fotografinë dhe pastaj jep
15 përgjigje.

16 Nuk ka problem i kërkojmë Sekretares ta heqë fotografinë.
17 E nxjerrim prapë fotografinë pastaj në ekran. Nuk dua që të
18 ndikohet dëshmitari me informacion, të cilin ai nuk e jep
19 direkt nga vetja se është në interesin e të gjithëve që të
20 kuptojmë se çfarë di dhe çfarë përshkruan ai nga kujtesa.

21 Z. VON BONE: [Përkthim] Në rregull, e nderuar Gjykatëse.
22 Le ta heqim fotografinë nga ekрани.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
24 Prokuror, shoh që jeni ngritur në këmbë.

25 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Po, të nderuar Gjykatës, mbase

1 e kam gabim por kur po diskutonit ju dhe dëshmitari, m'u
2 kujtua interpretimi dhe m'u kujtua ajo që tha z. Ajeti pra, që
3 kishte pjesërisht një gardh apo nuk kishte pjesërisht gardh.
4 Nuk e di nëse mund ta kontrollojmë. Pra pjesërisht nuk kishte
5 gardh që do të thotë që pjesërisht kishte.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po e
7 shoh tani. Edhe kolegu më thotë 57, rreshti 134 [sipas
8 përkthimit]: "Më shumë se gjysma ishte pa gardh." Kështu tha
9 përkthyesja dhe ma merr mendja që përkthyesja po përkthente
10 atë që tha dëshmitari.

11 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Për këtë e kisha fjalën.
12 Kërkoj ndjesë për ndërhyrjen.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
14 rregull. Thjesht për ta ditur për procesverbalin.

15 Z. Avokat, do t'jua jap fjalën. Pastaj do t'i kërkoj
16 Dëshmitarit të vendosi dëgjueset.

17 Mund t'i vendosni dëgjueset.

18 Faleminderit, z. Dëshmitar.

19 Z. VON BONE: [Përkthim] Më lejoni të konsultohem një
20 çast, e nderuar Gjykatëse.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
22 Patjetër.

23 [Përfaqësuesit e Mbrojtjes këshillohen]

24 Z. VON BONE: Po, të nderuar Gjykatës.

25 Dëshiroj që t'i rifreskoj kujtesën dëshmitarit. Dhe për

1 këtë kërkoj që të vendoset në ekran, dokumenti me numër
2 DSM00626.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.
4 Sekretare mund të veproni.

5 Z. VON BONE: [Përkthim] Në faqen 12, fundi i faqes.
6 Faqen 12 ju lutem. A është faqja 12 kjo?

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
8 Besoj se e keni fjalën për fundin e faqes.

9 Z. VON BONE: [Përkthim] Po, po.
10 Py. Z. Dëshmitar, ju kujtohet kur kemi bërë bashkë
11 intervistën -

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Më
13 falni që ju ndërpres z. Avokat, po kam marrë kërkesë nga
14 stenografja ose të flisni me zë më të lartë ose do të flisni
15 më afër mikrofonit.

16 Z. VON BONE: [Përkthim] Patjetër.

17 Py. Kur kemi biseduar bashkë më keni thënë këtë, që do t'ju
18 citoj. Pyetja që ju bëra është kjo:

19 "A ju kujtohet nëse ka pasur gardh rreth këtij vendit?"

20 Dhe pastaj ju tregova fotografinë.

21 Dhe përgjigjja juaj ishte kjo:

22 "Çfarë të them, ishte më i hapur se i mbyllur. Njerëzit

23 mund të vinin e të shkonin dhe kishte copëza të mbetura të një

24 rrethoje. Por nuk ka qenë zonë e mbyllur. Mund të hyje me

25 makinë e të shkoje deri në majë e të dilje."

1 A ju kujtohet që i keni thënë kështu Avokatit të

2 Mbrojtjes?

3 Pë. Po.

4 Py. Është e saktë kjo?

5 Pë. Po.

6 Py. Pra kur sapo thatë që gjysma ishte me "rrethojë", "me

7 gardh rrethues", çfarë donit të thoni tamam, tamam?

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ai

9 tha që, "më shumë se gjysma ishte pa gardh rrethues."

10 Z. VON BONE: [Përkthim] Po. "Më shumë se gjysma ishte pa

11 gardh rrethues."

12 Py. Këtë sapo e thatë pak më herët. Dhe unë sapo ju lexova se

13 çfarë keni thënë atëherë kur më keni dhënë deklaratën. Dhe

14 pyetja ime është kjo: Kur thoni, "më shumë se gjysma ishte me

15 gardh" -

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

17 Ishte pa gardh rrethues.

18 Z. VON BONE: [Përkthim] Po, pa gardh rrethues.

19 Py. Çfarë donit të thoshit?

20 Pë. Pyetja ishte - a është, a ke mujt me hy e me dalë. Unë

21 kom thonë që u konë gjysa e hapësirës pa gardh, a po din - u

22 konë komplet e thurun ashtu - ke mujt me hi, me dalë. Dhe

23 atëherë të kom thonë ndoshta 50 për qind u konë e hapur se

24 s'ka pasë shumë - u konë ajo, domethënë janë konë të rrëxume

25 domethënë gardhi,

1 Py. Gardhi rrethues që ishte aty, ishte thjesht një mbetje
2 gardhi siç e thoni dhe ju - copëza të mbetura të një rrethoje?

3 Pë. Besoj që ka qenë se tarava i thomi ne drunit - ashtu
4 diçka u konë një pjesë me dërrasa, një pjesë e rrëxume, kështu
5 domethënë u konë hapësirë e çelme.

6 Py. Pra kështu ju kujtohet? Kështu e mbani mend që ishte kur
7 keni shku aty në Zllash në fund të marsit apo në fillim të
8 prillit?

9 Pë. Kështu e mbaj mend. Kështu e mbaj mend edhe ne dhjetor të
10 '98-s, nuk ka pasë ndonjë ndryshim të madh aty domethënë.

11 Py. Mirë. Aq sa ju kujtohet, mbani mend ka pasur ndonjë portë
12 me një pengesë, me një tra, një portë përmes të cilës duhej të
13 hyje në atë vend?

14 Pë. Portë nuk ka pasë. Me sa më kujtohet mu nuk ka pasë
15 portë. A konë e hapur ajo.

16 Z. VON BONE: [Përkthim] Dëshiroj t'i tregoj një fotografi
17 me nja dy objekte, e nderuar Gjykatëse që është në materialin
18 DSM00631. Janë objektet që kemi parë.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.
20 Sekretare, ju lutem veproni.

21 Z. VON BONE: [Përkthim]:

22 Py. Z. Dëshmitar, në këtë fotografi shohim, në të majtë shoh
23 ca dërrasa në këmbë ashtu --

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

25 Pyetje të hapura ju lutem.

1 Z. VON BONE: [Përkthim]:

2 Py. Çfarë do ta quanit ju këtë - këto dërrasat këtu?

3 Pë. Këto po shihen që është një lloj gardhi domethënë si
4 gardh ka mujt si e thurme një pjesë ku ka pasë gardh, janë
5 dërrasa të vjetra, shihen.

6 Py. Po ndërtesat që janë në këtë fotografi, i njihni?

7 Pë. Po.

8 Py. Si u kujtohen, nga ju kujtohen këto ndërtesa? Jo, si ju
9 kujtohen këto ndërtesa - ka ndonjë ndërtesë në veçanti që ju
10 kujtohet?

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
12 Avokat, unë nuk jua kuptoj mirë pyetjen. Ju lutem një pyetje
13 më specifike. A ju kujtohet kjo ndërtesa ose a ka ndonjë
14 ndërtesë që ju kujtohet?

15 Z. VON BONE: [Përkthim] Ka ndonjë ndërtesë në veçanti që
16 ju kujtohet nga këto ndërtesat që janë këtu? Unë kështu e
17 thashë pyetjen.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk
19 është specifike ashtu siç e bëtë ju pyetjen.

20 Z. VON BONE: [Përkthim]:

21 Py. Këto tre ndërtesa a ju kujtohet që të kenë qenë në atë
22 vend në të cilin sapo e pamë fotografinë tjetër?

23 Pë. Po, këto më kujtohen krejt kjo shpia.

24 Py. Nëse e di përse përdorshin këto ndërtesa?

25 Pë. Këto, njana prej tyre B-ja, C-ja në prill janë përdorë

1 për me flejt ushtarë derisa kanë ardhë të plagosurit.

2 Py. Po ju vetë keni fjetur aty?

3 Pë. Aty s'më kujtohet që kam fjetë.

4 Py. Po na e dini që aty flinin ushtarë?

5 Pë. Po sigurisht kanë flejt ushtarë. Ndoshta dhe popullatë
6 q'atë periudhën para ofensivës. Po në dhjetor këto nuk janë
7 konë të banueshme. Janë konë pa gëlqere. Dhe kur kam ardhë në
8 prill i kom pa që i kanë gëlqeros, i kanë aftësu me nejt.
9 Besoj që u konë ushtarë ose civilë se nuk më kujtohet saktë në
10 cilën dhomë kanë flejt ushtarët, në cilën civilët. Po e
11 rëndësishme është që kjo më kujtohet që a konë spital si me
12 thonë u shndërru në spital. Të plagosunit, të gjithë kanë
13 ardhë këtu.

14 Py. A ju kujtohet se kur është transformuar në atë farë
15 spitali?

16 Pë. Nuk më kujtohet kur u transferu në spital po e di që
17 dikund në 20 prill kur kemi ardhë me të plagosur, i kemi
18 vendosë këtu. Këtu janë konë doktoresha Teuta edhe disa të
19 tjerë që janë konë. Ishin konë tu i marrë se kishin mbërrit
20 dhe disa të plagos para meje domethënë. Edhe kur kam ardhë e
21 kam pa se - ai spital ky nuk mundesh me i thonë po u shndërru
22 si spital se kjo është shtëpi e vjetër, çfarë kushtesh janë
23 këto - domethënë janë operu këtu njerëzit, ju kanë ndihmu sa
24 kanë mujt.

25 Py. Po juve vetë a ju kanë dhënë ndihmë mjekësore aty?

1 Pë. Po, e kam pasë edhe një kontroll se kam pasë një lëndim
2 në ofensivë më kujtohet, po jo diçka kështu vetëm në shpinë e
3 kam pasë.

4 Py. A njihni ndokënd tjetër, të cilit i është dhënë ndihmë
5 mjekësore aty?

6 Pë. Po, personalisht prej fshatit Viti të Marecit unë kam
7 dërgu këta dy të plagosur. Njani është Avni Azeri dhe Sylë
8 Vitia, të cilët janë konë të plagosur goxha rëndë. Edhe këta i
9 kam pru unë. Këta më kujtohet ma së shumti domethënë. Ka pasë
10 edhe të tjerë. Tani ma vonë që ka ardhë Sokoli i plagos. Edhe
11 disa të tjerë që krej s'po muj t'i kujtoj. Po dy i kam mbajt
12 unë domethënë personalisht dhe nja dy shokë, Avni Azerin dhe
13 Sylë Vitinë. Të dy të plagosur.

14 Py. Sa kohë përpara 20 prillit u shndërrua kjo ndërtesë në
15 atë farë spitali?

16 Pë. Të tregova më herët, Avokat, nuk e di. Po besoj që është
17 shndërru shumë kjo, veç në momentin që ka kërcit lufta. Dhe me
18 të plagosurit e të parë e kanë pa të arsyeshme me ndoshta me i
19 pru këtu edhe - po nuk e di kur ka fillu ajo. Q'ato dy-tri
20 ditët e luftës sigurisht është shndërru në spital. Me thonë
21 është shndërru q'ashtu jam shëru - të plagosurve iu ka dhonë
22 ndihma e parë.

23 Py. Veç kësaj ndërtese ka edhe dy ndërtesa të tjera në këtë
24 fotografi. A e dini se çfarë ishin këto dy ndërtesa?

25 Pë. Që kjo e para në të majtë, më kujtohet atë ditë kur kena

1 mbërri prej Prishtine, të nesërit kur jam çu e kam pa ishin
2 konë -- kjo është për këto ushqimin, bagëti edhe më kujtohet
3 që e bojshin me llastik për me flejt popullata. Mujshin me
4 aftësu për me banu në të. Që kjo më kujtohet si rast.

5 Py. Ndërtesa në mes a e di për ça përdorej?

6 Pë. Po, nuk e di për ça përdorej kjo. Mujt të jetë ndonjë
7 stallë për lopë diçka nuk e di konkretisht. Shihet si shpi e
8 vjetër.

9 Py. Këtë ndërtesën në mes, a ke vënë re ndonjëherë nëse ajo
10 ndërtesë ruhej me roja të armatosura apo roja, thjesht roja?

11 Pë. Jo, unë s'kam pa roja këtu.

12 Py. Po ndërtesa në të djathtë në periudhën kur ke qenë atje
13 në prill të '99-s, a keni parë roje aty?

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

15 Avokat, tani po flasim për ndërtesën që ka tre shigjeta, A, B,
16 C?

17 Z. VON BONE: [Përkthim] Po.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
19 lutem jini konkret dhe specifik për shkak të procesverbalit.

20 Z. VON BONE: [Përkthim] Do ta përsëris edhe njëherë
21 pyetjen që ju bëra.

22 Py. Ndërtesa, të cilën mund ta shihni në fotografi përpara që
23 ka këto shigjetat A, B, C - a keni parë ndonjëherë persona
24 duke bërë roje aty, pra roje duke ruajtur objektin në
25 periudhën e prillit të vitit 1999 kur keni qenë atje?

1 Pë. Unë s'kam parë roje këtu.

2 Py. A keni dëgjuar ju ndonjëherë nga njerëz që kanë qenë aty
3 në atë vend nëse janë-- kanë qenë persona të ndaluar aty, janë
4 mbajtur persona të ndaluar në ndonjë prej këtyre objekteve apo
5 në ndonjë vend tjetër në këtë vend?

6 Pë. Unë nuk kam dëgju kurrë.

7 Py. A keni parë ju ndonjëherë nëse ka pasur njerëz të ndaluar
8 aty?

9 Pë. Unë nuk kam pa njerëz të ndalum këtu.

10 Py. A e njihni një person me emrin Rrahman Dini?

11 Pë. Po.

12 Py. Kush ishte ky?

13 Pë. Rrahman Dini ka qenë një prej eprorëve të UÇK-së,
14 domethënë ushtar i UÇK-së, një ish i burgosun. E njoh edhe
15 para se me u bo ushtar, e njoh Rrahman Dinin. E kam njoftë e
16 kom pasë kojshi afër. Me moshë ka qenë shumë ma i vjetër, po e
17 njoh Rrahman Dinin.

18 Py. A e keni parë Rrahman Dinin në këtë vend në periudhën e
19 prillit të vitit 1999?

20 Pë. Po.

21 Py. Sa shpesh, sa herë e keni parë?

22 Pë. Po, në periudhën e prillit edhe unë s'kam qëndru gjatë në
23 këtë shtëpi po shumë herë e kam taku. Domethënë sa herë jam
24 shku ndoshta gjithë e kam pa. Ose saktë dhe sa herë s'po di se
25 s'po di dhe vetë sa kam qëndru -- jam konë dhjetë ditë a sapo.

1 E kam pa.

2 E kom pa edhe në dhjetor të 1998-s. Aty na ka ra me
3 ndejt kështu ma gatë se u konë situata e qetë.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
5 [Mikrofoni çaktivizuar].

6 Ju lutem a mund t'i hiqni dëgjueset, z. Dëshmitar?
7 Faleminderit.

8 Avokat, dëshmitar sapo tha:

9 "Në prill unë nuk kam qëndruar për shumë kohë në atë
10 shtëpi, por jam takuar me të disa herë."

11 Për mua nuk është e qartë se çfarë do të thotë dëshmitari
12 kur thotë në "atë shtëpi." Ai ka qëndruar në të njëjtën shtëpi
13 me z. Rrahimi [sipas përkthimit] apo ka qenë në një ndër
14 shtëpitë që ka fjetur atje kur ka qenë në Zllash?

15 Z. VON BONE: [Përkthim] Do ta pyes.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,
17 ju lutem ta sqarojmë se çfarë po na thotë.

18 Z. VON BONE: [Përkthim]:

19 Py. Z. Dëshmitar -

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
21 Faleminderit, z. Dëshmitar.

22 Faleminderit që i vendosët edhe njëherë dëgjueset.

23 Z. VON BONE:

24 Py. Z. Dëshmitar, Rrahman Dini ka qëndruar në ndonjë shtëpi
25 konkrete, të veçantë aty që ka fjetur aty? Këtë doje të

1 thoje?

2 Pë. Për çfarë periudhe po fol?

3 Py. Për prillin e 1999-s.

4 Pë. Në prill nuk më kujtohet saktë ku ka flejt se e kom pa
5 veç ditën më shumë.

6 Po për dhjetor nëse më pyt e di që ka flejt në këto
7 shtëpijat të tjera se aty kemi flejt edhe na, për në dhjetor
8 të 98-s.

9 Për në prill nuk më kujtohet se u konë si me thonë
10 katrahurë popullatë, civilë, aty domethënë ushtarë. Nuk e di
11 saktë në cilën dhomë ka flejt. Veç e kam taku në oborr ose
12 jashtë.

13 Py. E kuptoj. Z. Dëshmitar, Çfarë pozite kishte z. Rrahman
14 Dini? E kuptoj që ishte ushtar. Po çfarë pozite kishte ai, a
15 e dini këtë gjë?

16 Pë. Nuk e di saktë çka pozite. Veç e di që a konë njeri i
17 rëndësishëm, po pozitën të sigurt nuk e di se çfarë e ka pasë.
18 Po u konë njeri i rëndësishëm, domethënë vërejtës. Komandant,
19 po tash s'po e di çfarë komandanti domethënë. Domethënë çfarë
20 pozite kështu saktësisht nuk e di.

21 Py. Në rregull. A e dini se në cilën brigadë ose në cilin
22 njësit bënte pjesë ai?

23 Pë. Varet në çfarë periudhe. Me sa e di --

24 Py. Në prill të 1999-s.

25 Pë. Përfundimin besoj që e ka pasë me brigadën. Besoj nuk jam

1 i sigurt.

2 Py. Në rregull.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
4 cilën brigadë? Çfarë numri kishte brigada?

5 DËSHMITARI: Besoj, e nderuar Gjykatëse, në Brigadën 153.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
7 Faleminderit.

8 Z. VON BONE: [Përkthim]:

9 Py. A e dini me siguri këtë gjë që ai ishte anëtar i kësaj
10 brigade apo mendoni se mund të ketë qenë anëtari i asaj
11 brigade?

12 Pë. Po mendoj që ka qenë në 153. Dhe tash nëse më vetë për
13 dhjetor, tash s'di në cilën brigadë muj me thonë se Brigada
14 153 nuk ka ekzistuar në dhjetor. Edhe Rahman Dini a konë
15 ushtar. Tash nuk e di të sigurt në cilën brigadë.

16 Py. E kuptoj. A e njihni një person që quhet Agron Xhemajli?

17 Pë. Kush është ky person?

18 Pë. Agron Xhemajli ka qenë një pjesëtar i Ushtrisë Çlirimtare
19 të Kosovës. Atje e kam taku në dhjetor Agronin. Prej atyjit e
20 njoh.

21 Py. A e keni parë ndonjëherë Agron Xhemajlin në vendin, në
22 Zllash që na e përshkruat pak më parë në prill të 1999-s?

23 Pë. Po, i nderuar Avokat e kom taku Agron Xhemajlin këtu në
24 dhjetor të '98-s. Por në prill s'po më kujtohet që e kam taku.
25 E kam taku dikund po saktë nuk muj me ditë se u konë - ka pasë

1 lëvizje të mëdhaja në atë kohë. Nuk e di këtu e kam taku a jo.
2 Py. Në rregull. E kuptoj që ju thatë që nuk e keni takuar
3 atë.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Tha,
5 "Nuk më kujtohet" që e keni takuar. Këtë tha.

6 Z. VON BONE: [Përkthim] Po, e kuptoj.

7 Dua që të rifreskoj kujtesën e zotërisë, të nderuar
8 Gjykatës.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
10 lutem vazhdo.

11 Z. VON BONE: [Përkthim] Dua që të kërkoj shfaqjen në
12 ekran të dokumentit DSM00623. Do ju kërkoja gjysmën e dytë të
13 faqes.

14 Py. Z. Dëshmitar, kur biseduat me ne, unë ju bëra këtë
15 pyetje:

16 "Në atë kohë, në prill 1999, a kishit ndonjë kontakt me
17 Agron Xhemajlin?"

18 Dhe përgjigjja që dhe ti është që:

19 "Besoj se e kam takuar por në këtë kohë unë nuk flas me
20 të. Në qoftë se e kujtoj mirë në atë kohë UÇK-ja ishte
21 zgjeruar goxha dhe Agroni ishte shumë në lëvizje."

22 A ju kujtohet të ma keni thënë këtë gjë?

23 Pë. Po, kështu e kam thonë. Nuk më kujtohet saktë ku e kam
24 mujt me e taku, po besoj që e kom taku q'atë prillin, por në
25 cillin vend saktë nuk më kujtohet.

1 Py. Në rregull.

2 Z. VON BONE: [Përkthim] Dua që të kalojmë në seancë
3 private, të nderuar Gjykatës.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po.

5 Znj. Sekretare, ju lutem mund të na kaloni në seancë
6 private.

7 [Seancë private]

8 [Seancë private teksti i fshirë]

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20 [Seancë e hapur]

21 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
22 jemi në seancë publike.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

24 Faleminderit.

25 Z. Avokat, vazhdoni.

1 Z. VON BONE: [Përkthim]:

2 Py. Z. Dëshmitar, a e njihni Salih Mustafën?

3 Pë. Po.

4 Py. Si e njihni? Nga e njihni?

5 Pë. Salih Mustafën e njoh prej dikund të tetorit, gjysës së
6 tetorit të '98-s. Është gjë normale atë ku e kam njoft si
7 Cali, jo Salih Mustafa.

8 Py. Në rregull. A e keni parë atë në prill të vitit 1999 në
9 vendin në Zllash për të cilin po flisni dhe më përpara?

10 Pë. Jo, në Zllash nuk e kam pa.

11 Py. Në rregull. A e ke takuar ti atë në ndonjëherë tjetër, në
12 ndonjë kohë tjetër gjatë luftës? Dhe nëse po, a mund të na e
13 thoni se kur e ke takuar?

14 Pë. Domethënë e kam taku Salih Mustafën në tetor dikund të
15 '98-s në Prishtinë. E kam taku q'atë ditë kur kena dashë me ik
16 prej Prishtine, me e lëshu Prishtinën jo me ik. Edhe me të
17 plagosurit e kam taku në fshatin Koliq në periudhë të luftës,
18 kur jemi konë tuaj i dërgu të plagosurit e aty e kam taku në
19 Koliq.

20 Py. Në cilën periudhë kohe ka qenë kjo? A mund të jesh pak më
21 konkret?

22 Pë. Kjo ka qenë në Koliq kur e kam taku - mendoj që a konë 21
23 ose 22 prill.

24 Py. Çfarë bënte atje ai? E mban mend e di?

25 Pë. Kur kemi mbërrit në Koliq me të plagosurit ky ka ardhë

1 domethënë aty. E kam taku me një pjesë të plagosurve se janë
2 konë si me thonë të ndarë me shku grupe-grupe. Dhe atë e kam
3 taku në Koliq kur jemi tubu të gjithë të plagosurit.

4 Py. Çfarë gjërash bënte ai atje? Çfarë bënte ai atje?

5 Pë. Ajo koha ça bënte ish me kjahtë hallin qysh me i dërgu të
6 plagosurit në Majac të Llapit, që ajo është hall. Edhe e di që
7 domethënë ka kërku sa më shpejt me i nisë të plagosurit edhe
8 dikush që e din rrugën. Edhe jam konë njoni prej tyne se kam
9 lëvizë e kom qëndru në Majac. Edhe unë jam konë domethënë me
10 disa ushtarë, i kemi marrë të plagosurit edhe i kemi nisë për
11 Majac. Edhe deri ne Majac domethënë i kena përcjellë të gjithë
12 të plagosurit.

13 Py. A ishte e vështirë rruga për të shkuar deri në Majac?

14 Pë. Po zonë lufte a konë, a konë kado e vështirë. Kena bo
15 gati dy ditë me shku. Kështu si rrugë nuk u konë shumë e
16 gjatë, po na ka zënë mëngjesi në një fshat Vranidoll nëse
17 s'gaboje dhe nuk kemi mujt me kalu rrugën se u konë
18 magjistranja Prishtinë-Podujevë, në të cilën kanë qarkullu
19 forcat serbe. Dhe aty kemi qëndru tanë ditën me të plagostë.
20 Edhe në mbramje kur u bo terr janë dalë ajo pjesa tjetër na
21 kanë pritë natën rrugës. Domethënë një pjesë e ushtarëve të
22 Majacit. Edhe na kanë marrë e kemi shku në Majac.

23 Py. A ke dëgjuar ndonjëherë për BIA-n?

24 Pë. Po.

25 Py. Çfarë ishte kjo?

1 Pë. BIA ka qenë guerilja e qytetit. Një guerilë e cila ka
2 vepru në kryeqytet.

3 Py. A e dini nëse - apo a e dini se çfarë lloji veprimtarish
4 kryenin ata në qytet?

5 Pë. Ma shumë janë marrë me furnizimin - me shumë gjana,
6 barna, veshmbathje, të cilat i kanë çu në pjesë të Llapit dhe
7 Gollakut.

8 Py. Në rregull. A njihni ndonjë person tjetër nga BIA?

9 Pë. Po, njoh. Sigurisht që njoh.

10 Py. Kë njihni?

11 Pë. Prej ushtarëve?

12 Py. Po.

13 Pë. Po, njoh shumë. Tash s'po di a me i përmend a jo.

14 Ushtarë, shokët e mi -

15 Py. Mirë, ta formuloj ndryshe. E kuptoj. Të jem më i qartë.
16 Në kohën kur keni qenë atje, në prill të vitit 1999, në atë
17 kohë a njihje persona të tjerë që i përkisnin BIA-s? Persona
18 nga BIA.

19 Pë. Po.

20 Py. Kë njihnit?

21 Pë. Mos është - me thonë emrat atëherë po i them. Domethënë
22 gjeni pjesë - të cilët janë shku në Viti se krejt nuk muj me
23 njoftë se unë kohën ma të madhe e kam kalu në Llap edhe në
24 Shalë. Unë një pjesë që edhe kam vepru me ta është Avni Azeri,
25 Mustafë Ajeti, Shahin Bislimi disa kështu domethënë, tash

1 krejt nuk muj me i njoft se kam vepru ma shumë anej në Llap po
2 e di se guerilës së Prishtinës jena konë.

3 Py. E kuptoj.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

5 Avokat, dua të bëj unë një pyetje.

6 A ke qenë pjesëtar i BIA-s ti?

7 DËSHMITARI: Një periudhë po. Varet çfarë periudhe të
8 intereson, znj. Gjykatëse.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo,
10 nuk varet. Domethënë ke qenë pjesëtar i BIA-s.

11 Pastaj pyetja tjetër është, gjatë cilës periudhe ke qenë
12 anëtar ose pjesëtar i BIA-s?

13 DËSHMITARI: Mendoj që prej tetorit kam qenë pjesëtar i
14 guerilës BIA kur jam taku në Prishtinë me Salih Mustafën edhe
15 me disa shokë të tjerë. Po prapë edhe mbas kësaj kohe kam
16 vepru në Majac. Aty e konsideroj veten si ushtar i Salih
17 Mustafës, prej tetorit të '98-s.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
19 rregull. Jo. Në rregull.

20 Deri kur? Domethënë dua të kem pak a shumë një datë.

21 Deri kur? Pra nga tetori i 1998-s dhe deri kur?

22 DËSHMITARI: E nderuar Gjykatëse, në kohën kur kemi qëndru
23 në Shalë të Bajgorës, pas ofensivës e cila a konë në fshatin
24 Kacandoll kemi ardhë në fshatin Lupq i Epërm, kemi qëndru një
25 kohë. Edhe aty tani na kanë thonë si me shku në Prishtinë edhe

1 aty e kemi taku Salih Mustafën edhe --

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo,
3 jo.

4 Unë po të pyes për një datë. Deri kur? Nuk po të pyes për
5 vende të ndryshme, qytete të ndryshme kur keni qenë. Thjesht
6 po të pyes deri në çfarë date, deri kur?

7 DËSHMITARI: Deri në çlirimin e Kosovës kam qenë pjesëtar
8 i guerilës së Prishtinës.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
10 rregull. Ju lutem a mund të më jepni datën?

11 Nuk jam këtu për të vënë fjalë në gojën tënde. Kur ka
12 qenë kjo? Data?

13 DËSHMITARI: Çlirimi i Kosovës ka ndodhë më 12 qershor
14 edhe mendoj që aty e kam përfundu gjithçka domethënë sa i
15 përket luftës.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
17 Faleminderit.

18 Z. Avokat, e keni ju fjalën.

19 Z. VON BONE: [Përkthim] Do e bëjmë pushimin në orën 1.00
20 e nderuar Gjykatëse?

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po.

22 Z. VON BONE: [Përkthim] Atëherë mendoj që është momenti
23 përshtatshëm për ta ndërprerë marrjen në pyetje këtu.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

25 Shumë mirë.

1 Kam edhe një pyetje tjetër për ju z. Dëshmitar.

2 A keni pasë ndonjë nofkë gjatë luftës?

3 DËSHMITARI: Po.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Si
5 ishte? Si quheshit?

6 DËSHMITARI: Shyt Mareci.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
8 rregull. Faleminderit.

9 Tani do t'i kërkoj Sekretares që të të nxjerrë nga salla
10 e gjyqit. Do të keni mundësinë që të bëni pushimin e drekës.
11 Pushimi është një orë dhe shpresoj që të shihemi sërish së
12 bashku në orën 2.00.

13 DËSHMITARI: Faleminderit.

14 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

15 Z. VON BONE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, atëherë
16 pastaj dreke - do bëjmë një orë pushim për drekë? Nuk mendoj
17 se do të kem dhe shumë pyetje të mbetura pas pushimit të
18 drekës. Vetëm pak pyetje thjesht sa për të informuar palën
19 tjetër, palët e tjera për këtë. Mund të jetë 5 minuta,
20 maksimumi 10 minuta, jo më shumë.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
22 Atëherë shumë shkurt.

23 Z. VON BONE: [Përkthim] Prandaj domethënë dua që të
24 informoj kolegët.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në

1 rregull atëherë.

2 Do bëjmë pushimin për një orë.

3 Dhe këtu ndërpritet seanca.

4 --- Pauza e drekës fillon në orën 13.01

5 --- Seanca rifillon në orën 14.00

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
7 se u kthyet. Për procesverbal jemi në të njëjtën përbërje siç
8 ishim edhe paradite.

9 Përpara se sa të vazhdojmë me dëshminë e dëshmitarit
10 dëshiroj që të bëjmë një diskutim të natyrës tentative dhe do
11 të doja ta bëja tani se nuk preferoj që ta bëjmë në fund të
12 ditës sepse nuk e dimë se sa presion do të ketë për
13 përfundimin e dëshmisë. Do ta shohim.

14 Unë do të kërkoj parashtrime nga palët dhe nga Avokatja e
15 Viktimave, besoj që ja vlen që të shpenzojmë pesë ose dhjetë
16 minuta për çështjet e mëposhtme.

17 Dëshirojmë që të bëjmë një diskutim që ka të bëjë me
18 arsye planifikimi deri sa i takon momenti të deklaratave
19 përmbyllëse të kësaj çështjeje. Sigurisht është thjesht një
20 diskutim dhe thjesht për të parë ku jemi dhe ku mund të
21 arrijmë pas tre muajsh.

22 Siç është situata tani kanë mbetur edhe hapat e mëposhtëm
23 të cilët janë të parashikueshëm. Pra është dëshmia e dy
24 dëshmitarëve të fundit të Mbrojtjes pas ditës së sotme në
25 qoftë se do ta përfundojmë dëshminë tonë. Kjo do të bëhet me

1 datë 13 dhe 14 maj. 11, 12, 13 dhe 14 maj. Pastaj kemi pyetjen
2 dhe deklaratat e të akuzuarit si dhe pyetjet që do ti bëhen të
3 akuzuarit nga Trupi Gjykses në pajtim me rregullën 142, me
4 datë 19 maj. Dhe pastaj kemi një tjetër seancë me datë 20 maj
5 në mëngjes. Presim që të na dërgohet raporti i ekspertit me
6 email. Afati për këtë është data 13 maj. Dhe ekziston
7 gjithashtu mundësia për të dhënë parashtrime për raportin që
8 do të paraqitet nga eksperti. Dhe sigurisht në qoftë se është
9 e nevojshme do të planifikojmë edhe një dëshmi në sallën e
10 gjyqit.

11 Pastaj do të bëjmë mbylljen e çështjes së Mbrojtjes në
12 pajtim me rregullën përkatëse të Rregullores së Provave dhe
13 Procedurës së DHSK-së që është rregulla 131. Pastaj kemi dhe
14 provat e mundshme të cilat do të thërriten nga Trupi Gjykses
15 në pajtim me nenin 132 të Rregullës së Procedurës dhe Provave.
16 Kemi gjithashtu dhe provat e mundshme të palëve sipas rregull
17 127 paragrafi 1. Do të kemi edhe provat e mundshme në pyetjet
18 plotësuese dhe pastaj në përputhje me nenin 127(2)(e) dhe
19 rregullin 33 kemi përmbjlljen e procedurës provuese në pajtim
20 me rregullën 134 sipas Rregullores së Procedurës dhe Provave.

21 Dhe përveç kësaj Trupi Gjykses aktualisht po shqyrton
22 mundësinë që përpara se sa të përfundojë me seancën gjyqësore
23 të provave të përcaktojë një afat për nxjerrjen e të dhënave
24 dhe provave të cilat kanë të bëjnë me dënimin. Sigurisht vetëm
25 në qoftë se do të jepet një vendim dënimi, por do të duam që

1 ta bëjmë këtë gjë në këtë moment kohe dhe parashtrimet të
2 bëhen në pjesën e dosjeve përfundimtare të çështjes ose në
3 deklaratat përmyllëse në përputhje me rregullat përkatëse të
4 Rregullores së Provave dhe Procedurës.

5 Aktualisht - pra të gjitha këto janë të natyrës
6 tentative. Trupi Gjykses gjykon që procedurat e zhdëtimeve në
7 rast të shpalljes fajton në një disa prej pikave të aktakuzës,
8 të mund të vazhdohet me këto proceset e zhdëmtimit. Ndërkohë
9 që Trupi Gjykses do të vazhdojë me hapa të tjerë të cilët kanë
10 të bëjnë me caktimin e ekspertëve financiarë. Do të përcaktojë
11 gjithashtu edhe afatet për marrjen e këtyre raporteve ose
12 parashtrimeve të këtyre raporteve pasi këto janë hapa të cilat
13 kërkojnë kohë dhe kërkojnë energji.

14 Dhe duke pasur parasysh të gjitha këto që përmenda më
15 sipër, Trupi Gjykses dëshiron që të kërkojë palët që të bëjnë
16 parashtrimet e tyre dhe gjithashtu edhe Avokates së Viktimave
17 në qoftë se ato do të jenë të gatshëm që të shkurtojnë afatet
18 për dosjet përfundimtare të çështjes dhe deklaratat
19 përmyllëse por gjithashtu dhe dosjet përkatëse sipas
20 rregullës 134 të Rregullores së Procedurës dhe Provave me
21 synim për ta mbajtur seancën për deklaratën përmyllëse të
22 kësaj çështje me datë 14 ose 15 qershor ose në qoftë se këto
23 dosje do të jenë të disponueshme përpara se sa të bëhet
24 pushimi i verës. Dua ta theksoj edhe një herë, Trupi Gjykses
25 nuk ka si synim që të shkurtojë këto afate kohore kaq shumë të

1 rëndësishme ashtu siç parashikohen në rregulloren e provave
2 dhe procedurave dhe *proprio motu* ose me iniciativën e vet me
3 përjashtim të rasteve kur të gjitha palët dhe Avokatja e
4 Viktimave bien dakord për këtë.

5 Dhe për këtë arsye Trupi Gjykues urdhëron palët dhe
6 avokaten e viktimave që të parashtojnë parashtrimet e tyre në
7 qoftë se është e nevojshme dhe pasi të bëjnë konsultimet me
8 palët deri të hënë me datën 9 maj 2022.

9 Me këtë informacion që ju dhashë, më pas ne do të
10 vazhdojmë se si do të procedojmë.

11 Kaq kisha për të thënë për tani. Lidhur me atë çfarë ka
12 Trupi Gjykues parasysh për periudhën përpara. Shumë prej
13 temave të përmendura në fakt janë në kuadrin dhe kornizën e
14 Rregullores dhe Procedurës por është mirë domethënë që të
15 gjitha këto rregulla të ndryshme të sillen me njëra-tjetrën,
16 të shikohen në kontekst të përgjithshëm në mënyrë që të marrim
17 hapat e nevojshme planifikuese. Jo çdo gjë është e
18 parashikueshme, por është thjesht çështje planifikimi dhe
19 thjesht po mendojmë ku qëndrojmë dhe në çfarë pozite jemi në
20 raport me pushimin e verës.

21 Është e rëndësishme që ne të vazhdojmë punën me sa më
22 shumë efikasitet që të jetë e mundur. Ky është një aspekt
23 shumë i rëndësishëm i procesit të drejtë ligjore dhe për
24 Trupin Gjykues ky element është absolutisht shumë i
25 rëndësishëm. Duhet që të vijojmë në mënyrë efikase dhe sa më

1 shpejt të jetë e mundur.

2 Kaq kish për të thënë për tani.

3 Dhe mendoj që ka ardhur koha tani që të vazhdojmë me ato
4 çfarë kemi nisur sot paradite.

5 Znj. Sekretare mund të shoqëroni dëshmitarin në sallën e
6 gjyqit.

7 [Dëshmitari vijon dëshminë]

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] z.

9 Dëshmitar. Mirë se u ktheve. Më dëgjon mirë?

10 DËSHMITARI: Po ju dëgjoj, e nderuar Gjykatëse, mirë se ju
11 gjeta.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
13 mirë. Tani do të vazhdojmë me dëshminë tuaj. Tani më lejoni
14 t'i jap fjalën Avokatit të Mbrojtjes në mënyrë që të vazhdojmë
15 me pjesën e fundit të pyetjeve të tij sot.

16 Z. Avokat e keni ju fjalën.

17 Z. VON BONE: [Përkthim] Shumë faleminderit, e nderuar
18 Gjykatëse.

19 Py. Mirëdita. Z. Dëshmitar, kur u largove nga Prishtina për
20 të shkuar në Zllash dhe në një pikë të caktuar mbërritët në
21 Zllash. Dua të them u larguat nga Prishtina pas 24 marsit, pra
22 nga bombardimet e NATO-s, për këtë periudhë po flas, a kishit
23 ndonjë telefon satelitor ose ndonjë mjet tjetër komunikimi,
24 ndonjë gjë tjetër?

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

1 "Ndonjë gjë tjetër" çfarë është?

2 Z. VON BONE: [Përkthim] Ndonjë gjë që mund të merrnit në
3 telefon, mund të komunikoniit.

4 DËSHMITARI: Jo s'kena pasë telefona.

5 Z. VON BONE: [Përkthim]:

6 Py. Në rregull. Ndërkohë që keni qëndruar në Zllash keni qenë
7 në Zllash në prill a mund të përdornit ndonjë telefon
8 satelitor, telefon të rregullt ose komunikim nëpërmjet
9 radiolidhjes?

10 Pë. Unë s'kam komunu me telefon as me radiolidhje s'kam
11 pasë.

12 Py. Ndërkohë që keni qenë në Zllash në prill 1999, a keni
13 marrë ndonjë urdhër nga Salih Mustafa?

14 Pë. Jo.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
16 Dëshmitar ju lutem hiqini dëgjueset.

17 Shumë faleminderit.

18 Z. Prokuror e keni ju fjalën.

19 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Sa për të qenë të sigurt për
20 procesverbal, u bë një pyetje përpara pushimit në qoftë se
21 dëshmitari është takuar me Salih Mustafën. Tani e kemi të
22 qartë që nuk është bërë ndonjë komunikim në distancë nëpërmjet
23 telefonave dhe me fjalë të tjera në qoftë se ka marrë urdhër
24 nga Salih Mustafa, si i ka marrë urdhrat për atë kohë që nuk e
25 ka parë Salih Mustafën gjatë prillit?

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

2 Avokat a keni ndonjë përgjigje.

3 Z. VON BONE: [Përkthim] Jam dakord, nuk ka pasur urdhër
4 në asnjë trajtë. Atëherë kjo është përgjigja.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
6 atëherë e lemë këtu.

7 Z. VON BONE: [Përkthim] Në rregull. Nuk kemi pyetje të
8 tjera.

9 Py. Shumë faleminderit z. Dëshmitar.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] z.

11 Avokat përmendeni edhe një herë se nuk mendoj se e dëgjoji këtë
12 pjesën e fundit dëshmitari se nuk i kishte kufjet.

13 Z. VON BONE: [Përkthim]:

14 Py. Shumë faleminderit z. Dëshmitar. Nuk kemi më pyetje.

15 Faleminderit për kohën.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

17 Faleminderit.

18 Z. Dëshmitar, faleminderit. Tani do të vazhdojmë me
19 marrjen tuaj në pyetje nga ZPS-ja edhe Prokuroria përfaqësohet
20 nga pjesa që është në pjesën nga njerëzit që janë të ulur në
21 pjesën e kundërt me Mbrojtjen.

22 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar

23 Gjykatës.

24 Pyetje të palës tjetër nga z. Michalczuk:

25 Py. Z. Ajeti, mirëdita.

1 Pë. Përshëndetje.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
3 kërkoj ndjesë që ju ndërpres por, e kuptoj që më duhet që të
4 jap edhe një urdhër gojarisht lidhur me dokumente që do të
5 përdorni. Ju kërkoj ndjesë përgjigje këtë. Së pari do të jap
6 urdhrin gojarisht dhe pastaj vazhdoni me pyetjet tuaja.

7 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Patjetër znj. Gjykatëse.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] ZPS-
9 ja ka kërkuar leje nga Trupi Gjykes përmes parashtrimit me
10 datë 21 prill në orën 9.07 të mëngjesit që ka të bëjë me
11 Dëshmitarin e Mbrojtjes 1500.

12 Materiali ka - Trupi Gjykes thotë që dokumentet për të
13 cilat kërkon që të nxirren janë dokumente të cilat nuk janë të
14 shumta disa janë materiale që janë gjetur në burime të hapur
15 dhe janë identifikuar nga Prokuroria ndërkohë që po përgatitej
16 për kundërpyetjet për dëshmitarin. Trupi Gjykes vëren se
17 palët kanë pasur kohë të mjaftueshme për të parë këto
18 dokumente dhe më tej Trupi Gjykes nuk e kundërshton
19 përdorimin e këtyre dokumenteve nga ZPS-ja kështu që si pasojë
20 Trupi Gjykes gjen dhe konstaton se ZPS-ja ka pasur shkaqe të
21 arsyeshme, të bazueshme në pajtim me nenin e rregulloren dhe
22 paragrafin 31 të Vendimit për Zhvillimin e Proceseve
23 Gjyqësore.

24 Ky është fundi i urdhrin tim gojarisht.

25 Z. Prokuror tani mund të vazhdoni me kundërpyetjet për

1 dëshmitarin.

2 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]:

3 Py. Edhe një herë mirëdita Z. Ajeti.

4 Pë. Mirëdita.

5 Py. Unë jam Prokuror që do t'ju marr në pyetje juve tani. Do
6 ju kërkoja që të më dëgjoni me vëmendje. Ju lutem, jepini
7 përgjigje pyetjeve të mia në mënyrë të shkurtër, precise pa e
8 shtjelluar shumë përgjigje. Në qoftë se do të më duhet më
9 shumë informacion prej jush do t'ju kërkoj unë që ta
10 shtjelloni informacionin. Në qoftë se nuk jua kërkoj këtë gjë
11 ju lutem thjesht përgjigjuni pyetjes që do t'ju drejtoj.

12 Z. Ajeti a keni një llogari, një adresë në Facebook?

13 Pë. Po, z Prokuror.

14 Py. Z. Ajeti, cilën parti politike mbështesni ju?

15 Pë. Unë jam anëtar i degës së Prishtinës të Aleancës.

16 Py. A mund të na e shtjelloni pak më tepër se si është forma
17 ose emri i plotë i partisë Aleanca, a ka ndonjë emër më të
18 zgjatur apo kaq e ka?

19 Pë. Aleanca për Ardhshmerinë e Kosovës, shkurtimi është AAK.

20 Py. Z. Ajeti, sot përpara pushimit na thatë që keni qenë
21 ushtar i BIA-S nga tetori 1998 deri në çlirimin e Kosovës deri
22 në qershor 1999; e saktë?

23 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Referenca për transkriptin e
24 ditës së sotme është në faqen 75, rreshtat nga 20 deri në 24
25 dhe gjithashtu faqja 76 rreshti nga 16 deri në 18.

1 Py. Na thatë gjithashtu se që prej tetorit 1998 ju e keni
2 konsideruar veten si ushtar të Salih Mustafës. Është e saktë
3 kjo?

4 Pë. Po.

5 Py. Për referencë kjo është në faqen 75 rreshtat nga 20 deri
6 në 24. A e kuptoj drejt që Salih Mustafa në atë kohë ishte
7 komandanti yt?

8 Pë. Po. Salih Mustafa ka qenë komandant i gueriljes.

9 Py. Z. Ajeti, a mund t'i thoni Trupit Gjykues se çfarë roli
10 ose pozite specifike konkrete keni pasur në njësitin BIA?

11 Pë. Unë kam qenë ushtar.

12 Py. A keni pasur ndonjë detyrë tjetër përveç se keni qenë
13 ushtar i thjeshtë.

14 Pë. Jo vetëm atë detyrë kisha, vetëm ushtar.

15 Py. Çfarë marrëdhënie, Z. Ajeti, keni pasur ju me Salih
16 Mustafa pas lufte?

17 Pë. Pas lufte shok e kam jena taku, sidomos kohën e fundit,
18 domethënë 2018-2020 më ka ra ma shumë me nejt.

19 Py. Çfarë marrëdhënie keni ju aktualisht me Salih Mustafën.
20 Jeni akoma shokë?

21 Pë. Akoma e konsideroj shok.

22 Py. Sot përpara pushimit, ne po diskutonim për njësitin BIA.
23 Ju na thatë se në prill të vitit 1999 ju i njihnit shumë
24 pjesëtarë të BIA-s dhe mendoj se na dhatë disa prej emrave të
25 ushtarëve të BIA-s. Kështu?

1 Pë. Jo shumë, jo krejt, disa, disa.

2 Py. Po, emrat e disave. Ne i diskutuam prej tyre sot dhe kjo
3 në transkript jepet në faqen 75 në rreshtat nga 1 deri në 10.

4 E lexova transkript gjatë pushimit dhe nuk arrita që --
5 juve thatë që nuk i përmendi dot emrat e të gjithë emrat e
6 personave. Nuk e di për Trupin Gjykues dhe për neve a mund të
7 na i përsërisni këto emrat tani.

8 Pra këta pjesëtarë të BIA-s që i njohur të prill të vitit
9 1999?

10 Pë. Ushtarët që i përmenda edhe ma herët mes është Avni
11 Haziri, Shaip Bislimi, Mustafë Ajeti. I doni dhe të tjerë. Isa
12 Kastratin.

13 Py. Po pjesëtarë të tjerë të atij njësiti që ishin në pozitë
14 më të lartë. Ju përmendët Salih Mustafën më përpara si
15 drejtuesin e atij njësiti? A njihni ndonjë pjesëtar tjetër që
16 kishin pozitë më të lartë në prill 1999?

17 Pë. Besoj se Isa Kastrati ka qenë njëri prej komandantave.

18 Py. Çfarë pozite kishte konkretisht ai brenda BIA-s. Pra
19 Salih Mustafa ishte komandanti, po Isa Kastrati ishte
20 komandanti i një nënnjësiti apo çfarë a mund të na e
21 përcaktosh këtë për Trupi Gjykues?

22 Pë. Unë sa e di z. Prokuror ka qenë zëvendëskomandanti i
23 gueriles, ça kam njohuri ma shumë, besoj që a kanë.

24 Py. Z. Ajeti, a e njihni një person me emrin Brahim Mehmetaj?

25 Pë. Po.

- 1 Py. A e njihni çfarë nofke ka pasë ai?
- 2 Pë. Po. Bimi shkurt e kanë thirrë.
- 3 Py. A ka qenë pjesëtar i njësimit BIA ai gjatë luftës?
- 4 Pë. Po.
- 5 Py. Çfarë pozite kishte ai brenda njësimit BIA?
- 6 Pë. Unë për Brahim Mehmetin më shumë e njoh mas lufte. Në
- 7 luftë shumë muj me thanë veç një herë e kam taku edhe atë në
- 8 fshatin Sharbanë. Nuk e kam ditë çfarë pozite ka pas. Ma vonë
- 9 e kam kuptu. Por për në luftë s'e ka dit. Domethënë s'më ka
- 10 ra, vetëm një herë e kam taku Brahim Mehmetin.
- 11 Py. Në rregull e di ti çfarë pozite ka pasur ai në prill të
- 12 vitit 1999 në njësitin BIA?
- 13 Pë. Tash e di. A kam ditë në atë kohë, nuk e kam ditë.
- 14 Py. Nga sa na thatë deri tani unë e kuptova që ju nuk e keni
- 15 takuar Brahim Mehmetaj gjatë luftës?
- 16 Pë. Jo e kam takuar një herë. Më kujtohet një herë më
- 17 kujtohet si ngjarjes fshati Sharbanë kam ni që ka ra një pritë
- 18 dikun, a kanë rrezik e ato thojshin që Bimi ka ra në pritë
- 19 kështu. Edhe aty e kam taku mbasi është kthy.
- 20 Py. Kur ka qenë kjo, kur e ke takuar Bimin?
- 21 Pë. Në rast se nuk gaboj muaji maj ka qenë i 1999. Nuk e di
- 22 fillimi apo gjysa, po në maj besoj që a kanë.
- 23 Py. Kur e mësuat se Bimi ishte pjesë e njësimit BIA?
- 24 Pë. Po aty e kam kuptu domethënë në fshatin Sharbanë.
- 25 Py. Në maj 1999? Kështu?

1 Pë. Po z. Prokuror.

2 Py. A e kuptuat se çfarë pozite kishte ai brenda njësimit BIA
3 në atë kohë?

4 Pë. Jo konkretisht çfarë pozite jo, veç, po u vërejke që
5 është në një pozitë të naltë.

6 Py. Z. Ajeti, ne ju pyetëm për pjesëtarët e BIA-s përmendët
7 disa emra. Z. Haziri, z. Ajeti, z. Kastrati. Pse nuk e
8 përmendët Brahim Mehmetajn si një prej pjesëtarëve të BIA në
9 qoftë se siç po pretendoni tani ai kishte një pozitë më të
10 lartë?

11 Pë. I nderuar Prokuror, mua më pyete në atë kohë - për kohën
12 për të cilën nuk më ke pyet, tash muj me t'i numëru 100
13 pjesëtarë të gueriles. Ndoshta 100 jo, po muj ma shumë këta i
14 kam njoft me emra që më ka ra me luftu me ta në pjesë madhe
15 janë këta 4. E tash, unë e di Brahimin se përmenda s'muj me i
16 përmend edhe të tjerë. Ka qenë Brahi Gashi. Ka pasur shumë
17 ushtarë që tash e din. Por në atë kohë nuk i kam njoft të
18 gjithë. Kam njoft një pjesë.

19 Py. Z. Ajeti, çfarë marrëdhënie keni aktualisht në qoftë se
20 keni ndonjë marrëdhënie me Brahim Mehmetin, i njohur ndryshe
21 si Bimi?

22 Pë. Tash me Brahim Mehmetin na lidh politika jemi aktivista
23 në degën e Aleancën veç kjo na lidh, diçka jo më tepër. E kam
24 shok, punojna bashkë nëpër zgjedhje.

25 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës dëshiroj

1 t'i tregoj dëshmitarit një dokument me lejen tuaj. Është një
2 dokument i cili demonstroi çështjen e marrëdhënies së
3 dëshmitarit me z. Brahim Mehmetaj.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
5 lutem vazhdoni.

6 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Z. Sekretare duam që të nxirrni
7 një dokument SPO00325825-SPOE0032826 dhe përkthimi në anglisht
8 është i njëjti me këtë shtojcën "English Translation". Ju
9 lutem vendosini të dyja versionet atë në shqip dhe në
10 anglisht.

11 Jo këtë dokument, jo.

12 Të nderuar Gjykatës, vetëm një sekondë në qoftë se më
13 lejoni për të dhënë numrin e saktë.

14 Në fund është shifra 925, 825. Jo nuk është kjo
15 fotografia. Ndoshta dokumenti që përfundon me 26. Ndoshta mund
16 të jetë ky dokumenti. Po ky është.

17 Py. Z. Ajeti, kush është në këtë fotografi?

18 Pë. Është Brahim Mehmetaja, Bimi.

19 Py. Po personi tjetër?

20 Pë. Unë jam, Muhamet Ajeti.

21 Py. Z. Ajeti, ju e keni botuar këtë fotografi në llogarinë
22 tuaj në Facebook me 12 shkurt 2021. Le të shohim pak
23 përshkrimin e kësaj fotografie. Unë përpara kam përkthimin në
24 anglisht dhe mund ta lexoj shumë shpejt.

25 Pra shënimi që keni bërë juve është ky:

1 "Shoku im në luftë dhe paqe, të priftë e mbara në këto
2 zgjedhje".

3 Dhe nuk do të vazhdoj me pjesën tjetër. Nga komenti që
4 keni bërë ju në këtë fotografi duket se Brahim Mehmetaj dukej
5 se ishte mik dhe shok i juaj jo vetëm në luftë por dhe në
6 paqe.

7 Pë. Unë sigurisht shok edhe kam mas lufte, por dhe e
8 konsideroj edhe në luftë, pavarësisht që një herë e kam taku.
9 Për mu, çdo ushtar nëse një herë jemi takuar është shok. Po
10 domethënë, po shoqinë shumë e kemi vazhdu mas lufte.

11 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës dëshiroj
12 t'i tregoj Dëshmitarit një dokument tjetër që demonstroi të
13 njëjtën çështje, çfarë do të thotë marrëdhënien ndërmjet
14 Brahim Mehmetaj dhe Dëshmitarit.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
16 lutem vazhdoni.

17 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Ky është dokumenti SPO00325827
18 deri 00325827. Përkthimi në anglisht është me të njëjtën
19 shifër por ka ET në fund.

20 Py. Z. Ajeti, kjo është fotografia që ke vendosur në
21 llogarinë tënde në Facebook më 22 janar 2021, kështu është?

22 Pë. Po.

23 PËRKTHYESJA: Më fal 27 janar.

24 Py. Këtu lexoj që:

25 "Si gjithmonë ecim në të njëjtën rrugë që na çon në

1 sukses."

2 Pra nga kjo kuptojmë që ti ke nj miqësi të vjetër me z.
3 Ibrahim Mehmetaj.

4 Pë. Ky është bërë një postim në kohë të fushatës dhe normal
5 shok e kam. Rrugëtim politik. Në luftë shumë pak jena njoft,
6 po mas lufte e njoh mirë dhe shok e kam. Drejt sukseseve jena
7 mundu me ec ashtu jena me ec.

8 Py. Ashtu është por jeni miq, jeni aleatë politikë. Bëni
9 pjesë në të njëjtën parti politike AAK-në dhe kur unë të pyes
10 të na thuash emrat e disa anëtareve të BIA-s, ti na thua disa,
11 por ama emrin e Ibrahim Mehmetaj nuk na e the dhe arsyeja për
12 këtë cila do ishte?

13 Pë. I nderuar Prokuror, kur më pyet për disa ushtarë, unë
14 foli për atë kohë kënd i kam njoft. A në atë kohë nuk e kam
15 njoft Ibrahim Mehmetaj e them me përgjegjësi të plotë nuk e kam
16 njoft atëherë në periudhën e prillit. Për atë nuk e kam
17 përmend. Jo për diçka tjetër.

18 Py. Z. Ajeti, po Bahri Gashin e njeh?

19 Pë. Po i nderuar Prokuror.

20 Py. Nga e njeh?

21 Pë. Ajet Bahri Gashin e njoh, ky ka qenë pjesëtar i gueriles.

22 Py. E ke njohur gjatë luftës?

23 Pë. Po e kam njoftur.

24 Py. Gjatë luftës e ke njohur si pjesëtar të njësitit BIA?

25 Pë. Po.

1 Py. Çfarë posti kishte çfarë pozite kishte ai në BIA atëherë?

2 Pë. Fillimisht kur e kam njoft se Bahriu kish ardh - kish
3 ardh ma vonë në Kosovë, më ka ra shumë -- para ofesive nuk e
4 di a e kam pa njëherë, por mas ofensivës, masi i kena tërheq
5 të plagosurit e kam taku ma shpesh dhe e kam kuptu që është
6 komandat i gueriles.

7 Py. Si e kishte pseudonimin gjatë luftës?

8 Pë. Bahri Gashi, e qujshim Bafta.

9 Py. Në qoftë se siç thua tani ka qenë zëvendëskomandant i
10 BIA-s, pyetja që kam për ty është kjo lidhur me Ibrahim
11 Mehmetaj: Përse nuk e përmende Bahri Gashin kur të pyetem për
12 anëtarët e BIA-s dhe për të po na tregon vetëm kur unë ta them
13 këtë emër?

14 Pë. I nderuar Prokuror, kur të më pyes do të përgjigja. Në
15 kohën kur më pyete përmende disa ushtarë në periudhën e
16 prillit nuk i kam njoft krejt. Dhe i përmenda disa. Nuk më
17 thatë me i përmend krejt. Edhe tash po i përmend. Domethënë
18 kurdo që të më pyetësh.

19 Py. Z. Ajeti sa për të qenë të qartë ti ke qenë në njësinë
20 BIA që nga tetori 1998 deri në çlirimin e Kosovës pra, në
21 qershor 1999. Kështu ka qenë?

22 Pë. Ashtu e konsideroj veten, prej tetorit deri në përfundim,
23 pjesëtar i gueriles.

24 Py. Ti e përmende që Salih Mustafa ka qenë komandanti jot
25 atëherë; kështu?

1 Pë. Komandant i gueriles.

2 Py. Për një periudhë kohe, Bahri Gashi ka qenë
3 zëvendëskomandant por ti nuk e përmende. Gjithashtu e dimë se
4 për një periudhë kohe edhe Brahim Mehmetaj, ndryshe Bimi, ka
5 qenë zëvendëskomandant i Salih Mustafës po as atë nuk e
6 përmende.

7 Pë. I nderuar Prokuror --

8 Py. Pyetja që ka unë përse nuk i përmende kur unë të pyeta
9 fillimisht për anëtarët e BIA-s që ke njohur në 1999?

10 Pë. I nderuar Prokuror, unë vetë me i thanë do emra të cilët
11 i njoh. Unë i thashë disa shokë që i kam pasë më afërt. Edhe
12 thashë, disa po i përmendi prej njësitit dhe jo krejt. Edhe ju
13 nuk më detyruat me i përmend krejt, se edhe unë nuk i di krejt
14 por --

15 Py. E kujtoj po a do të pajtoheshe me mua se anëtarët e lartë
16 të BIA-s ishin ata që duhen përmendur kur të pyesin kë mban
17 mend kur përmend Salih Mustafën. Ti përmende disa njerëz që
18 nuk kanë qenë zëvendëskomandantë. Vetëm Isa Kastrati ishte
19 përjashtim. Nuk i përmendim pra këto që thamë. Po e lëmë me
20 kaq. Po e lëmë me kaq.

21 Çfarë marrëdhënieje ke tani me z. Bahri Gashi në qoftë se
22 ke ndonjë marrëdhënie?

23 Pë. Edhe me Bahri Gashin kohën e fundi na lidh politika është
24 anëtar i kryesisë së degës të Aleancës. Ka qenë kandidat në
25 këto zgjedhjet e mramta. Është zgjedhë i Asamblesë. Veprojna

1 në një degë.

2 Py. Kam një pyetje. Gjatë 1999 nuk ka rëndësi prill apo maj,
3 a e ke parë ndonjëherë Bahri Gashin apo Brahim Mehmetajn në
4 këtë kompleksin e shtëpisë së Krasniqit, për të cilën
5 diskutuam sot me Avokatin e Mbrojtjes?

6 Pë. Brahimin Mehmetin nuk e kam pa. Brahim Mehmetin është
7 hera e parë që e kam taku në fshatin Sharbanë. Bahri Gashin e
8 ka pa, domethënë, është mendoj që është dita kur i kemi
9 tërheqë të plagosurit kur jemi ba gati me i tërheq, 20 prilli
10 ose 21 prilli. Aty e kam taku Bahri Gashin.

11 Py. Faleminderit.

12 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Me lejen tuaj, të nderuar Trupi
13 Gjykses, dëshiroj të paraqesim në ekran një dokument që është
14 deklarata e Selatin Krasniqit e datës -- DSM 00001-DSM00017,
15 faqja 30 [sipas përkthimit].

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

17 Vazhdo. Mund të na shpjegosh se përse do ta paraqesësh këtë
18 dokument?

19 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Dua që të pyes dëshmitarin nëse
20 pajtohet me mua me ato që thotë Seladin që përmend praninë e
21 këtyre dy burrave në kompleks shtëpish. Dua të di se ç'mendon
22 dëshmitari për këtë gjë.

23 Py. Z. Ajeti, dëgjo se ç'ka thënë Selatin Krasniqi, miku yt,
24 ç'i ka thënë Mbrojtjes 23 shkurt 2021.

25 "Pyetje. Po anëtarët e tjerë të njësisë BIA ishin aty?"

1 Dhe përgjigja ishte:

2 "Unë e takova Bimin dhe Bahriun. Shpendi ishte në fillim
3 me BIA-n dhe pastaj shkoi në Brigadën 153. Kishte edhe ushtarë
4 të rinj dhe ata rrinin aty për një kohë të shkurtër dhe
5 largoheshin për të shkuar në ofensivë. Aty ndenji edhe Isa
6 Kastrati. Por nuk e di edhe sot nëse ka qenë në BIA. Njerëz si
7 Bimi dhe Bahriu rrinin aty për një periudhë të shkurtër kohe.
8 Kështu ndodhi edhe me Calin."

9 Pastaj në të njëjtën faqe vazhdon të flasë konkretisht
10 për Bimin. Duke thënë sa vijon:

11 "Nuk kam dëgjua për të dhe nuk e kam parë. Dhe askush nuk
12 mund të thotë se Bimi qëndroi në atë vend gjithashtu për një
13 kohë të shkurtë dhe e kam fjalën kur them për atë vend, për
14 shtëpinë. Edhe Bimi rrinte aty për një kohë të shkurtër.
15 rrinte një natë apo dy netë dhe pastaj largohet."

16 Selatin Krasniqi gjithashtu konfirmoi se Bimi dhe Brahim
17 Gashi ishin anëtarë të BIA-s. Dhe këtë e thotë në faqen e
18 transkriptit sot, në rreshtat 8 deri në 10.

19 Nga këto del se nga ato që ka thënë z. Selatin Krasniqi,
20 të dy personat edhe Brahim Mehmetaj i quajtur Bimi edhe Bahri
21 Gashi kanë qenë në atë vend, në atë kompleks shtëpish në
22 Zllash.

23 Ti, je takuar aty me Brahim Mehmetajn? Ai ishte siç dhe
24 the vetë zëvendëskomandant.

25 Pë. I nderuar Prokuror, këtu po folim për muajin shkurt. Sa

1 të kuptova unë prej 24 dhjetor deri dikun, deri në bombardimin
2 e NATO-s kam qenë në fshatin Majac me Avni Azirin, me
3 Muststafë Ajetin, me Shaip Bislmin. Domethënë me 24 dhjetor
4 1998 deri 4-5 ditë, një javë para bombardimit të NATO-s kemi
5 ardhë në Prishtinë. Domethënë që ajo periudhë është që kemi
6 qëndur në fshatin Majac. Domethënë për këtë periudhë nuk muj
7 me fol, nuk e di.

8 Py. Kjo pjesë nuk përmend vetëm shkurtin. Kur u diskutua me
9 Mbrojtjen i përmend periudhën që na intereson ne, mars-prill
10 maj.

11 Krasniqi thotë që Bimi ose Brahim Mehmetaj dhe Bahri
12 Gashi ishin aty. Gjithashtu me ty ranë dakord se të dy ishin
13 zëvendëskomandantë.

14 Pra si është e mundur që ke kohë që je anëtar i BIA-s nuk
15 e paske ditur praninë e Brahim Mehmetajt dhe të Bahri Gashit
16 në Zllash?

17 Pë. I nderuar Prokuror, unë nuk e kam e kam taku Brahim
18 Mehmetajn në Zllash kurrë. Jam, domethënë, kështu i sigurt,
19 takimin e parë e kam pa në Sharbanë kur është sulmu, ka ra në
20 një pritë dikun edhe është hera e parë. Nuk e kam taku.

21 Py. Do të të pyes shumë shkurt për anëtarë të tjerë të
22 njësisë BIA. A e njeh ti një person me pseudonimin Tabuti?

23 Pë. Po.

24 Py. E di si e ka emrin dhe mbiemrin e plotë?

25 Pë. Po, i nderuar Prokuror.

- 1 Py. Si e quajnë, pra si e ka emrin dhe mbiemrin?
- 2 Pë. Po emrin dhe mbiemrin e ka Nazif Musliu.
- 3 Py. Ka qenë ai anëtar i BIA-s?
- 4 Pë. Po.
- 5 Py. Çfarë posti ka pasur, në qoftë se ka pasur ndonjë post
6 apo pozitë, në këtë njësi në prill 1999?
- 7 Pë. Nuk e di çka posti ka pasë, ushtar ka qenë, unë Nazifin
8 ose Tabutin e njoh prej fëmijërisë sepse shtëpia ime me të
9 është shumë afër. Jemi një lagje edhe e di që ka qenë ushtar,
10 pozitën nuk e di.
- 11 Py. Ti ke qenë në Zllash siç i the Mbrojtjes në prill 1999, a
12 e ke parë në atë kohë ti?
- 13 Pë. Nuk e kam pa. Nuk më kujtohet që e kam pa.
- 14 Py. Nuk e ke parë apo s'të kujtohet ta kesh parë?
- 15 Pë. Nuk e kam po. Po, domethënë normal mu kish kujtu po s'e
16 kam pa se e njoh prej fëminije.
- 17 Py. Z. Ajeti, kam edhe një emër tjetër për të cilin do të të
18 pyes. Afrim. A ka pasur ndonjë person të quajtur Afrim apo me
19 pseudonimin Afrim në njësinë BIA?
- 20 Pë. Nuk e di, nuk më kujtohet.
- 21 Py. A ka pasur ndonjë Afrim, një person me emrin Afrim në
22 njësinë BIA?
- 23 Pë. Thashë nuk më kujtohet që ka pasë Afrim, ndoshta ka pasë
24 por s'e di, ndonjë ushtar Afrim.
- 25 Py. E di ti cili ka qenë pseudonimi i Vdekja, në qoftë se e

1 shqiptoj siç duhet, në kuadrin e njësisë BIA? Ka pasur ndonjë

2 Vdekja?

3 Pë. Unë nuk e kam njoft.

4 Py. Personi që quhet Ilmi Vela, a ka qenë ky person anëtar i
5 njësisë BIA?

6 Pë. Unë nuk e njoh. Nuk njoh person me Ilmi Vela.

7 Py. A e njeh ti një person me pseudonimin Daradan që paska
8 qenë anëtar i BIA-s?

9 Pë. Një Dardan e njoh.

10 Py. Ka qenë ai anëtar i BIA-s, ky Dardani që njeh ti?

11 Pë. Besoj që a kanë i BIA-s edhe ky, e kam taku në dhjetor.

12 Py. Në dhjetor të 1998 apo 1999?

13 Pë. 1998, dhjetor.

14 Py. Si e ka emrin dhe mbiemrin ky Dardani?

15 Pë. Nëse është fjala për këtë Dardan nëse s'gabo, Kujtim e
16 ka, po mbiemrin s'ja di.

17 Py. Po ai çfarë posti kishte në njësinë BIA? Ky Kujtimi
18 është? Kështu e kishte? A mund ta thuash edhe një herë emrin?

19 Pë. Nuk e di për postin, qai emër mundet me kanë nëse është
20 ky Dardan.

21 Py. Ti na the që e takove në 1998. Po në prill 1999, e ke
22 takuar? Kjo është koha që na intereson më shumë.

23 Pë. Jo.

24 Py. A mban kontakte me këta personat që të thashë, Tabutin,
25 Nazif Musliun, Dardanin, që e ka emrin Kujtim? Mban lidhje me

1 ta ti ende?

2 Pë. Jo. Domethënë asnjëri s'kam lidhje domethënë të frikëta
3 kështu që me Nazifin ndoshta i ka dy-tri vjet që s'jam pa. Se
4 unë jetoj në një lagje tash tjetër, jo ku kam jetu përpara,
5 por nuk më kujtohet se kur e kam pa. S'e di. Nuk kam ndonjë
6 kontakt kështu të vazhdueshëm me të.

7 Py. Po me Dardanin?

8 Pë. Jo.

9 Py. Pra nuk ke kontakte aktualisht?

10 Pë. Jo.

11 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, dua t'i
12 tregoj Dëshmitar një fotografi nga koha e luftës, ku
13 përshkruhet, ku tregohet që është ai dhe disa të tjerë.

14 Të lutem Sekretare, mund të tregoni në ekran një dokument
15 SPOE00325840 deri në 0032540 [sipas përkthimit].

16 Zmadhojeni pak ju lutem. Edhe më shumë nëse ka mundësi.
17 Kaq është mirë.

18 Py. Z. Ajeti, kjo është fotografi që ti vetë e ke postuar në
19 Facebook, në 25 maj 2014. Të kujtohet që e ke vënë këtë
20 fotografi?

21 Pë. Nëse s'gaboje veç jam bo tag. Nëse s'gaboje. S'më kujtohet
22 që e kam shpërnda, veç më kanë bo kështu tag. Po më kujtohet
23 kjo fotografi. Po a e kam shpërnda unë, a tjetërkush nuk e di.

24 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Ta zvogëlojmë pak, ju lutem,
25 për të parë në anën e djathtë të fotografisë.

1 Py. Po ta shohësh aty Z. Ajeti është fotografi që e ke
2 vendosur ti. Dhe lart aty djathtas përmenden disa njerëz. Të
3 kujtohet tani që e ke vendosur këtë fotografi?

4 Pë. Nuk kesh i sigurt a e kam shpërda unë a jo, prandaj
5 thashë më ka bo tag.

6 Py. Pra e ke vendosur ti.

7 Pë. Po. Po.

8 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Ju lutem ta zmadhojmë edhe një
9 herë. Mjafton, kaq mjafton.

10 Py. Z. Ajeti, këtu përmend disa emra ti, për shembull emrin e
11 Muhamet Ajetit, emrin tënd. A mund ti thuash Gjykatës se kush
12 është në këtë fotografi?

13 Pë. Po, këtu në fotografi është komandant Remi, është Avni
14 Haziri, është Mustafë Ajeti, Shaip Bislimi s'di a e përmenda,
15 edhe është Dardani. Kujtimi domethënë.

16 Py. Po, por dua të them ku je ti vetë? Mund t'i thuash
17 Gjykatës se ku je ti në këtë fotografi, je i pari nga e
18 djathta nga e majta. Na e shpjego pak me radhë se cilët janë
19 ata në fotografi, duke filluar nga vetja, nga e djathta në të
20 majtë. Pra personi i parë që rri afër kompjuterit kush është
21 ai?

22 Pë. Unë jam.

23 Py. Po personi i dytë që është ngjitur me ty si e quajnë?

24 Pë. Shaip Bislimi.

25 Py. I treti?

1 Pë. Është komandant Remi, Rustem Mustafa.

2 Py. I katërti që është ngjitur?

3 Pë. I katërti është Avni Haziri.

4 Py. Dhe i fundit?

5 Pë. Mustafë Ajeti.

6 Py. Po aty në mes fare është një person që i dallohet mirë
7 emblema e UÇK-së, po ky kush është?

8 Pë. Ky është Dardani, Kujtimi domethënë, ky në mes.

9 Py. Faleminderit shumë për përgjigjen. Por kur të pyeta pak
10 më përpara si e ka emrin dhe mbiemrin Dardani, ti the "Kujtim
11 por mbiemrin nuk ja mbaj mend".

12 Por në këtë fotografi që e ke vënë vetë ti, thotë me
13 saktësi, Kujtim Çeliku, Qerimi, më falni. Përse nuk ja the
14 këtë më përpara Gjykatës? Besoj që ti e ke ditur kur e ke
15 vendosur këtë fotografi?

16 Pë. Nuk mu kujtu z. Prokuror mbiemri se është kohë e gjatë
17 nuk mu kujtu, përndryshe --

18 Py. Z. Ajeti, ti na përmende këtë personin Mustafë Mustafë
19 Ajeti, ke të bësh me këtë? E ke të afërm që keni të njëjtin
20 mbiemër?

21 Pë. Jo ky është prejardhjen e ka nga Gjilani, nuk jena kështu
22 të gjakut diçka, vetëm mbiemrat i kemi të njëjtë. Ka rastit
23 kështu. Por e kam shok prej fillimit të luftës.

24 Py. E kuptoj. Nga këto personat këtu, pra gjashtë personat në
25 fotografi, cili prej tyre ka qenë në BIA?

1 Pë. Krejt kemi qenë në BIA, përveç komandant Remit, po edhe
2 ai muj me thanë që është BIA se ka qenë komandant i krejtve.

3 Py. A mund t'i thuash Gjykatës se kur është bërë kjo
4 fotografi?

5 Pë. Unë sa e di është bë në dhjetor 1998 se vetëm atëherë ka
6 ardhë një aparat dhe më s'kemi bo.

7 Py. Po në ç'vend e keni bërë këtë foto?

8 Pë. Në Zllash.

9 Py. Në cilën ndërtesë, në cilën vend konkretisht, të mbahet
10 mend?

11 Pë. Në atë vendin ku bisedum ma herët, pra te shtëpia, njërën
12 prej tyre.

13 Py. Në atë që është më e lartë, që duket më shumë në
14 fotografi apo në atë që është më poshtë? Në cilën prej tyre?
15 Mund t'a shpjegosh më saktë?

16 Pë. Këtë s'po e kam përpara po në atë shtëpinë në anë të
17 djathtë kur e këqyrim kështu.

18 Py. Z. Ajeti, sot dhe kjo është në faqen 77 të transkriptit,
19 rreshti 5, Gjykatësja të pyeti për pseudonimin tënd dhe ti the
20 që quhej Shyt Mareci. Kështu ka qenë?

21 Pë. Po.

22 Py. Në luftë ke pasë ndonjë pseudonim tjetër?

23 Pë. Jo.

24 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Në këtë rast, të nderuar
25 Gjykatës dëshiroj t'i tregoj dëshmitarit një pjesë të dëshmisë

1 së tij që ja ka dhënë Mbrojtjes kur diskuton për pseudonimin.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Vazhdoni.

4 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Sekretare të lutem, bëhet fjalë
5 për deklaratën 00615 deri në 00632 në faqen 11.

6 Fillon me fjalët "E di nëse njerëzit". Është në fillim të
7 faqes.

8 Py. Z. Ajeti, ja se ç'ke diskutuar me Avokatin e Mbrojtjes sa
9 i takon pseudonimit apo pseudonimeve.

10 Pyetja që të është bërë, të thonë:

11 "A e di ti nëse njerëzit mund të të kenë thërritur Shyt
12 apo Shyti?"

13 Dhe ti i je përgjigjur:

14 "Mbase më kanë thirrur ashtu, por në Prishtinë ata më
15 thërrisnin me emrin tim të zakonshëm. Ndërsa në Zllash ata më
16 thërrisnin, Shyt Mareci. Mund të ketë ndodhur që dikush të më
17 jetë drejtuar si Shyt, por nuk e mbaj mend."

18 I ke thënë këto fjalë Mbrojtjes?

19 Pë. Po.

20 Py. Pra, shkurtimisht mund të themi se ka mund që dikush të
21 ketë njohur me atë pseudonimin Shyti e të të kenë thirrur
22 ashtu.

23 Z. VON BONE: [Përkthim] Të jetë drejtuar --

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

25 Dëshmitar, hiqi pak ato kufjet të lutem.

1 Vazhdoni.

2 Z. VON BONE: [Përkthim] Jo Shyti por Shyt.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po
4 shoh edhe Shyti aty.

5 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Në pyetje janë të dyja. Po në
6 përgjigje nuk janë të dyja.

7 Z. VON BONE: [Përkthim] "Disa më thërrisnin Shyt".

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

9 Pyetja është nëse:

10 "Njerëzit të kanë thirrur ndonjë herë Shyt apo Shuti?"

11 "Ndonjë herë më kanë thirrur ashtu, mbase."

12 Dhe pastaj mbaron që:

13 "Mund që dikush mund të më ketë thirrur si Shyt por nuk e
14 mbaj mend."

15 Kemi pastaj pyetjen tjetër:

16 "A e dini nëse dikush tjetër në kompleksin në Zllash
17 quhej Shyt apo Shyti?"

18 Dhe përgjigja është:

19 "Ka qenë një person tjetër që ka luftar edhe ai quhej
20 Shyt."

21 Pra e dëgjoj që Avokati thotë Shyt, jo Shyti, por
22 ndërkohë përgjigja e parë nuk është se është mohim i ndonjërit
23 prej dy emrave. Megjithatë do ta lemë me kaq.

24 z. Prokuror fjala për ju.

25 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Mund ta lë këtë çështje aty ku

1 është.

2 Py. Megjithatë dua t'ju pyes Z. Ajeti. Po ju lutem.

3 Ju kërkoj ndjesë se jam shumë shpejt sot.

4 Z. Ajeti, si ju ka thërritur Salih Mustafa juve gjatë
5 luftës?

6 Pë. Salih Mustafa Shyt Mareci, Shyt, qysh i ka ardh ma lehtë.
7 Fjala Shyt Mareci është e një luftëtarit të kohërave të
8 hershme i Marecit. A kanë Shyt Mareci dhe në atë kuptim e kam
9 pasë nofkën, Shyt Mareci në i ka ardh ma lehtë shyt. Kështu a
10 kanë.

11 Py. Z. Ajeti sot ju përmendët Agron Xhemajlin për referencë
12 kjo është në faqen 68 dhe gjithashtu faqen 69, rreshti nga 1
13 deri në 4. A e mbani mend që ta keni përmendur emrin e Agron
14 Xhemajlit më herët sot?

15 Pë. Unë e di që ma kanë pyet më herët, po, e kam përmend.

16 Py. Si ju thërriste juve Agron Xhemajli gjatë luftës?

17 Pë. Me Agronin pak kena pasë kontakte që ajo periudha në
18 prill, -- në atë në dhjetor. S'më kujtohet qysh më ka thirre.
19 Njëri prej këtyre Shyt Mareci, qysh, por ka qenë një periudhë
20 pesë-gjashtë ditë edhe qaty e kam njoft Agron Xhemajlin.

21 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, në qoftë
22 se do më lejoni, dua t'i lexoj Dëshmitarit një pjesë shumë të
23 shkurtët të intervistës -- të transkriptit të intervistës me
24 Agron Xhemajlin, ku ai diskuton ekzaktësisht këtë çështje, pra
25 çështjen e pseudonimeve.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
2 rregull vazhdoni.

3 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Znj. Sekretare dua që të
4 shfaqni një pjesë të transkriptit të intervistës së ZPS-së me
5 Agron Xhemajlin me datë 2 korrik 2020, me numër identifikimi
6 ERN 076501-TR-ET Pjesa 2, faqja nga 28, rreshtat nga 10 deri
7 13 dhe pastaj faqja 29, rreshtat 11-12. Së pari ju lutem na
8 shfaqni faqen 28, rreshti nga 10 deri 13.

9 Py. Z. Ajeti, ky është një shkëmbim i shkurtër i Prokurorit
10 me z. Agron Xhemajlin.

11 "Py. Kush është Shyti atëherë?"

12 "Pë. Një burrë i ri, një prej ushtarëve."

13 "Py. Ushtar i BIA-s?"

14 "Pë. Ai ka qenë me të dy me brigadën dhe me BIA-s.

15 "he pastaj në faqen tjetër që është faqja 29 rreshtat 11
16 dhe 12 kemi si më poshtë:

17 "Py. Si e kishte emrin e plotë Shyti?"

18 Pë. Emrin e ka Muhamet, mbiemrin nuk ja kujtoj.

19 Pra mua më duket sikur Agron Xhemajli, e dinte që Shyti
20 ishte pseudonimi i një personi me emrin Muhamet. Për ju e ka
21 fjalën ai Z. Ajeti?

22 Pë. Sigurisht po.

23 Py. Dëshiroj që ta ndryshoj paksa temën dhe dua të diskutojmë
24 tani marrëdhëniet dhe kontaktet që keni pasur ju me Salih
25 Mustafën pas luftës, por përpara sesa ai të arrestohej.

1 A keni qenë në kontakt me Salih Mustafën përpara sesa të
2 arrestohet?

3 Pë. Më falni. Me Salih Mustafën është hera e mramtë kur jam
4 taku masi që u arrestu është -- e pata ba unë një vizë, vizë
5 pune për Slloveni, edhe ndoshta një ditë a dy pa u nis unë për
6 Slloveni me 1 gusht jam nis 2020, edhe aty kam mujt me e taku
7 28 korrik, 29 2022. Është hera e mrame kur e kam taku edhe kam
8 shku në Gjermani prej Sllovenisë.

9 Py. Përpara kësaj periudhe, pra përpara 28 korrikut ose 29
10 korrikut 2020, a keni qenë në kontakt me Salih Mustafën, keni
11 komuniku me Salih Mustafën?

12 Pë. Po.

13 Py. Po flasim takime personale, po flasim kontakt përmes
14 telefonit apo në mënyra të tjera si jeni takuar?

15 Pë. Krejt mënyrat, përmes telefonit, jena taku, kena nejt
16 varësisht.

17 Py. Duke folur për kontaktet telefonike, sa shpesh keni folur
18 në telefon me të?

19 Pë. Sa shpejt s'më kujtohet veç sa herë kena dasht kena
20 dashtë me folë me njëri-tjetrin, saktë nuk muj me e ditë sa
21 shpesh.

22 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës dëshiroj
23 t'i tregoj Dëshmitarit një dokument i cili tregon ose flet për
24 këtë çështje për kontaktin ndërmjet dëshmitarit dhe Salih
25 Mustafës në periudhën përpara se sa të arrestohej Salih

1 Mustafa.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Vazhdoni ju lutem.

4 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Znj. Sekretare po flas për

5 dokumentin me numër identifikimi SPOE00325853 deri në

6 00325864. Dhe për momentin dua që dëshmitar të shikojë vetëm

7 pjesën e parë të këtij dokument dhe vetëm pjesën e sipërme.

8 Nëse mund ta zmadhoni vetëm pjesën e sipërme, kutinë e parë do

9 e vlerësoja.

10 Py. Z. Ajeti, ju lutem shihni kutinë e parë që është në të

11 majtë të numrit 1, ku lexon "parties/palët" dhe mund të

12 shikoni numrin e telefonit aty. Nuk do ta lexoj sepse jemi në

13 seancë të hapur. Por a mund t'i thoni Trupit Gjykses se numrin

14 e kujt personi shikoni te kjo kutia këtu?

15 Pë. Numrin jem dhe numri i Salih Mustafës.

16 Py. Siç mund ta shohim në këtë kuti, afër emrit tuaj është

17 një emër. A mund të na lexoni emrin, jo numrin e telefonit po

18 thjesht emrin që është poshtë numrit?

19 Pë. Numri i parë është fjala, po?

20 Py. Po, por mos i lexo Trupit Gjykses numrin, por vetëm

21 emrin. Pra çfarë emri i është bashkëlidhur këtij numri?

22 Pë. Aty shkrun "Shyti AAK". [e pakuptueshme] numrit.

23 Py. Kjo është mënyra që të ka regjistruar ty Salih Mustafa.

24 Pra, në këtë -- me këtë emërtim e ka regjistruar numrin tuaj

25 në telefon. A e konfirmoni që edhe Salih Mustafa ju njeh juve

1 si personin me pseudonimin Shyti?

2 Pë. Po.

3 Py. Z. Ajeti, nëse do të thoja që nga qershori i vitit 2019
4 deri në shtator 2020 ju keni shkëmbyer mbi 100 thirrje
5 telefonike me Salih Mustafën, a do të ishte ky një numër,
6 numri i duhur i thirrjeve telefonike që keni bërë me Salih
7 Mustafën?

8 Pë. Ka mujt me kanë. Shpesh kena fol, po mes numrit që kam
9 mujt me dhanë ka mujt me thanë edhe 200 herë, po kjo sigurisht
10 është e saktë.

11 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës sa për ta
12 pasur në procesverbal dua që të kalojmë deri në fund të
13 dokumentin pra takojmë gradualisht deri në fund këtë dokument.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
15 lutem vazhdoni znj. Sekretare.

16 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]:

17 Py. Hidhini një sy z. Ajeti. Këto janë thirrjet e zhvilluara
18 mes jush dhe Salih Mustafës dhe numri i përgjithshëm i
19 thirrjeve të shkëmbyera ndërmjet jush dhe Salih Mustafës ishin
20 130 thirrje telefonike. A jeni dakord me mua, a pajtoheni me
21 mua që keni qenë në këtë - pra keni pasur kaq shumë thirrje
22 telefonike me z. Mustafa?

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] z.
24 Prokuror, për momentin mendoj që ndaluar në dokumentin 1, te
25 dokumenti 6.

1 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës ja dhashë
2 referencën më përpara. Folën për dokumentin e ZPS-së me numër
3 identifikimi SPOE00325853 deri në 00325864.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E di.

5 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Pra ka më shumë faqe sa i takon
6 kontakteve të z. Ajeti me z. Mustafa.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ishte
8 më shumë për Sekretaren. Ose mund të shkojnë në faqen e fundit
9 menjëherë.

10 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Po. Faqja e fundit është 864.

11 Po, po.

12 Py. Telefonata që është -- thirrja telefonike që është bërë
13 ndërmjet jush dhe z. Mustafa përpara arrestimit është thirrja
14 telefonike 113, e bërë në qershor të vitit 2019.

15 Kjo është e para ju kërkoj ndjesë, domethënë në fillimin
16 fare të faqes janë telefonat më të vona ose të bëra më vonë
17 ndërkohë që në fund fare janë telefonatat më të hershme.
18 Kështu është në rend të kundërt.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

20 Faleminderit.

21 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]:

22 Py. A jeni dakord, a pajtoheni me mua se keni pasur kontakte
23 të vazhdueshme me z. Mustafa gjatë asaj kohe?

24 Pë. Po, po.

25 Py. Z. Ajeti a keni shkëmbyer me Salih Mustafën edhe mesazhe,

1 duke përdorur aplikacione të ndryshme për mesazhe, përpara se
2 ai të arrestohej?

3 Pë. Po. Në WhatsApp apo Viber. Njëra prej tyre kena mujt me
4 shkru. Tash s'po e di cilën. Ndoshta edhe në të dyja po nuk
5 jam --.

6 Py. Kanë qenë kontakte, shkëmbime të shpeshta përmes këtyre
7 aplikacioneve apo platformave për komunikimin?

8 Pë. Nuk e di saktë. Nuk më kujtohet se a ba kohë.

9 Py. Pyetja ime është kjo: Këto kontakte kanë qenë të
10 përjavshme, të përmuajshme, të përditshme?

11 Pë. Ndoshta çdo javë, ndoshta edhe dy-tri herë në javë,
12 varësisht, a po din. Kohën e fundit jena taku qysh thashë më
13 herët, në 2018-2020 më ka ra ma shumë me u taku.

14 Py. Z. Ajeti, në këto komunikime përmes mesazheve, si ju
15 thërriste juve z. Mustafa?

16 Pë. Kur kena shkru është fjala?

17 Py. Po, kur shkëmbenit këto mesazhe, përmes Viber-it apo
18 WhatsApp-it siç e thashë si ju drejtohej ai?

19 Pë. Nuk më kujtohet qysh më ka shkru [e pakuptueshme] po se
20 di saktë, tash u bo moti që kena shkru, a kupton. Tash edhe
21 s'e di çka kena shkru çka kena komuniku. Po kena komuniku edhe
22 me Viber ose me WhatsApp.

23 Py. A ka ndodhur që ai t'ju ketë thirrur "djali im"?

24 Pë. Po, qysh jo.

25 Py. A ka ndodhur që ju t'i jeni drejtuar atij me "Komandant"

1 në këto komunikime?

2 Pë. Ndoshta komandant nuk besoj, s'i kam thanë, veç ma shumë
3 "babush" jena shpreh kështu, se ajo është një shprehje kështu.
4 Po komandant s'besoj, s'më kujtohet.

5 Py. Çfarë "babushi"? çfarë do të thotë kjo fjalë?

6 Pë. Një farë respekti domethënë fjala "babush" është fjala
7 "babë". Po babush është si shprehje. Ky e ka pasë ma shumë a
8 mu "djale" më ka thirr qysh mas.

9 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, për ta
10 demonstruar, për ta dëshmuar këtë çështje dua që ta ulin pak
11 më poshtë këtë dokument.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
13 lutem vazhdoni, z. Prokuror.

14 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Dua që t'i tregojmë dëshmitarit
15 dokumentin me numër identifikimi SPOE00325865 deri
16 SPOE00325876. Ndërkohë përkthimet në anglisht janë thujse me
17 të njëjtat numrat, por dokumenti i parë është SPOE003256 dhe
18 dokumenti tjetër është 00325876 me shtojcën ET në fund.

19 Py. Ky dokument, nuk është se do të jem shumë i hollësishëm
20 lidhur me çfarë reflekton ky dokument, por është një dokument
21 i cili tregon komunikimet e shkëmbyera ndërmjet z. Ajeti dhe
22 z. Mustafa.

23 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Në qoftë se -- do t'i kërkoja
24 znj. Sekretare që të shkonte te faqja e fundit e këtij
25 dokumenti.

1 Mund ta bëjmë këtë gjë për të dyja versionet, versionin
2 në gjuhën shqipe dhe versionin në gjuhën angleze.

3 Py. Një mesazh është dërguar nga Cali me 1 gusht, ku Salih
4 Mustafa ju thotë si më poshtë:

5 "A mbërrite o djali jem, a u rehatove?"

6 Ndjesë?

7 Pë. Po, po domethënë kjo sigurisht është kur kam udhëtu për
8 Slloveni. "A mbërrite o djali jem, a u rehatove", kështu e
9 paska shkru. Kështu është.

10 Pë. Dhe pastaj të thërriti "djali jem" ë?

11 Pë. Ashtu e ka shkru.

12 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] A mundemi po tani duke përdorur
13 versionin në shqip të këtij dokument të shkojmë te faqja numër
14 3SPOE00335867.

15 Py. Me 22 qershor 2019 në përgjigje të mesazhit të z. Mustafa,
16 ju keni dërguar mesazhin si më poshtë që është në serbisht ose
17 në shqip. Dhe në këtë mesazh thoni:

18 "Zasto komandante"

19 Ça do me thënë kjo "Zasto komandante"?

20 Pë. Nuk po më kujtohet ky mesazh. S'po më kujtohet çka kam
21 desht me thanë se di. Nuk më kujtohet domethënë, shihet numri
22 po se di çka kam desht me thanë. Nëse ka qenë një mesazh ma
23 herët ku me e ditë ç'ka o lidh. Po "komandant" i paskam thënë.

24 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës dua që t'i
25 tregoj Dëshmitarit një tjetër dokument. Dhe po shtjellojmë

1 sërish këtu çështjen e BIA-s çështjen që e shtjelluam dhe më
2 parë. Me lejen tuaj dua që t'çi tregojmë disa dokumente
3 Dëshmitarit.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
5 lutem vazhdoni.

6 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Znj. Sekretare është në faqen
7 SPOE00022578. Mund ta lëvizni pak më sipër.

8 Py. Z. Ajeti, po flas për këtë logon që mund ta shikoni në
9 fund të ekranit. A e njihni a e keni parë më përpara këtë logo
10 z. Ajeti?

11 Pë. Po e kam pa.

12 Py. Çarë është kjo logoja?

13 Pë. Po logo është guerilja BIA, po përmi janë tre heronjtë
14 Iliri, Bahriu, Agroni. Këtu është data e themelit të guerilit
15 e cila po shkun 19, 20 maj 1998, Prishtinë.

16 Py. Pra kjo është data kur është krijuar njësitit BIA? Këtë po
17 thua?

18 Pë. Ashtu po shkrun.

19 Py. A e ke - ja ke dërguar ti ndonjë herë këtë emblemë këtë
20 logo Salih Mustafës?

21 Pë. Ndoshta edhe ja kam dërgu. S'jam i sigurt. Nuk e --

22 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Dëshiroj t'i tregojmë
23 dëshmitarit një dokument që provon këtë gjë. Nëse më lejoni
24 mund të jap numrin e ERN.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju

1 lutem vazhdoni.

2 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Është dokumenti SPOE00325846
3 deri në 00325846.

4 Py. Z. Ajeti, ky dokument tregon që me datë 17 qershor 2019
5 me kërkesë të Salih Mustafës, që është dërguar atë datë, atë
6 ditë, ju i keni dërguar këtë logo. A mund ta shikoni këtë në
7 ekran? A e konfirmoni dot në këtë kutinë me ngjyrën blu
8 domethënë më përpara keni Calin që ju kërkon diçka dhe pastaj
9 në kutinë blu i keni dërguar emblemën bashkëlidhur. 17 qershor
10 2019. E shikoni këtë?

11 Pë. Po. Ma paska kërku domethënë me e çu këtë logo dhe ja kam
12 dërgu.

13 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, dëshiroj
14 që t'i tregoj dëshmitarit disa fotografi gjatë kohës së luftës
15 në qoftë se më jepni leje dhe do të kem ca pyetje lidhur me
16 to.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
18 lutem vazhdoni z. Prokuror.

19 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Znj. Sekretare dokumenti i parë
20 është me numrin e identifikimit SPOE00325825 deri në
21 SPOE00325825. Dhe përkthimi në anglisht është me të njëjtën
22 numër por me ET në fund. Faleminderit.

23 Py. Z. Ajeti, kjo është një fotografi që ti ke vënë në
24 adresën tënde të Facebook-ut me datë 11 qershor 2021. A është
25 e saktë kjo? A mund t'i thoni Trupit Gjykes se kush është në

1 këtë fotografi kush ka dalë këtu?

2 Pë. Në këtë foto jam unë dhe është Salih Mustafa, Cali.

3 Py. Ku është bërë kjo fotografi?

4 Pë. Kjo foto është bërë në Zllash.

5 Py. A të kujtohet se në cilën ndërtesë është bërë?

6 Pë. Në atë ndërtesën andej, domethënë në anën e djathë, është
7 bërë në dhjetor 1998.

8 Py. Mesazhi që keni botuar përbri kësaj fotografie dhe do të
9 lexoj një pjesë prej këtij mesazhi, sipas këtij mesazhi ju
10 thoni:

11 "Ndihem krenar që si 18-vjeçar në luftë kisha një
12 komandant si ti..."

13 A mund të na thoni se pse keni botuar këtë fotografi me
14 këtë koment? Sërish flasim për vitin 2021. Në këtë kohë Salih
15 Mustafa ishte i ndaluar, ishte i arrestuar në Dhomat e
16 Specializuara të Kosovës. Kështu që a mund t'i thoni Trupit
17 Gjykues pse e keni bërë botimnin -- pse e keni vënë një
18 fotografi të tillë me këtë citim?

19 Pë. Unë e kam postu në Facebook-un tem arsyeja pse besoj që
20 ka qenë ndonjë datë ose diçka ose formimi i ushtrisë ose 28-29
21 nëntor, diçka e tillë ka mund me kanë. Edhe normal e kam shkru
22 "ndihem krenar".

23 Py. A ishte kjo edhe një mënyrë për të treguar mbështetje për
24 Salih Mustafën?

25 Pë. Po tash varet si e merr, normal që e kam postu. Ndihem

1 krenar që e kam pasë komandat, vazhdoj të ndihem edhe --
2 Py. Pyetja ime ishte kjo a e keni vënë këtë fotografi për
3 Salih Mustafa i cili në atë kohë ishte edhe i ndaluar?
4 Pë. I nderuar Prokuror unë nuk muj me e mbështet me këtë
5 foto, unë -- mbështetje morale a kanë, por sa i përket
6 procesit me një foto nuk mundesh me e mbështet. A moralisht e
7 kam mbështet dhe vazhdoj me e mbështet.

8 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës dua të
9 vazhdoj me disa fotografi të tjera. Jo shumë por edhe ca disa
10 fotografi të tjera.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] z.
12 Prokuror, po shikoj orën, thuajse ka ardhur koha për pushimin.
13 Sigurisht që mund të vazhdojmë me këtë pjesë të fotografive
14 dhe pastaj në një moment të natyrshëm mund të bëjmë një
15 pushim.

16 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Po. Të nderuar Gjykatës a mund
17 të tregojmë edhe dy fotografi të tjera me disa pyetje pasuese
18 dhe pastaj shkojshkojmë për pushim. Këtë do të sugjeroja
19 unë.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
21 Thjesht po kërkoj një moment të natyrshëm për të bërë
22 pushimin. Ju lutem mund të vazhdoni më tej.

23 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës a mund të
24 vazhdoj me shfaqjen e disa fotografive të tjera për
25 Dëshmitarin.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po
2 mund të vazhdoni.

3 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Dokumenti znj. Sekretare është
4 SPOE0022559 deri në 0022559. Është një fotografi që është
5 pranuar si provë në këtë çështje.

6 Py. Z. Ajeti, ju lutem hidhini një sy kësaj fotografie dhe
7 tregojini Trupit Gjykes në qoftë se i njihni personat që kanë
8 dalë në këtë fotografi?

9 Pë. Po, z. Prokuror i njoh.

10 Py. A mund të fillojmë me personat të cilët janë në këmbë?
11 Kush është personi që është në këmbë në të majtë të kësaj
12 fotografi?

13 Pë. Në të majtë të fotos ka jam shikoj unë -- unë jam njëri
14 prej tyre në këmbë edhe është Agron Xhemajli.

15 Py. Personi që ka vënë këtë kapelën e zezë me emblemën e UÇK-
16 së, personi që është në këmbë si e ka emrin?

17 Pë. Agron Xhemajli.

18 Pë. Po personi që është ngjitur me të, jeni ju z. Ajeti apo
19 jo?

20 Pë. Po.

21 Py. Personi me këtë beretën e zezë që është kërrusur që është
22 në gjunj kush është ky?

23 Pë. Ai në anën e poshtme te unë është Salih Mustafa.

24 Py. Po personi që është ulur ngjitur me të?

25 Pë. Ai është Fatmir Sopi.

1 Py. A mund t'i thoni Trupit Gjykues se kur është bërë kjo
2 fotografi dhe ku është bërë ajo?

3 Pë. Kjo është bërë në Zllash në atë shtëpinë që ju thashë më
4 herët. Këto foto krejt janë kanë [e pakuptueshme] të luftës
5 janë të 1998 në tetor. Po në Zllash është bërë kjo foto.

6 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Ndoshta fotografinë e fundit të
7 nderuar Gjykatës përpara se të bëjmë pushimin.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
9 lutem vazhdoni.

10 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Dokumenti me numër SPOE0022587
11 deri në 00222587. Është një tjetër fotografi e cila është
12 pranuar si provë në këtë çështje.

13 Py. Z. Ajeti, kush ka dalë në këtë fotografi?

14 Pë. Unë dhe Salih Mustafa.

15 Py. Ku dhe kur është bërë kjo fotografi?

16 Pë. Në Zllash, veç qenka jashtë nuk qenka brenda në shtëpi
17 dikun. Shihet borë që a kanë, domethënë jashtë ambientit të
18 shtëpisë qeka. Dikun saktë nuk muj me e ditë kurrë, veç e di
19 që dikun afër me dalë jashtë. Në fakt se paskam pa mas lufte,
20 domethënë kjo është, unë jam këtu dhe është Salih Mustafa. Unë
21 s'e paskam pa ma herët këtë foton ose e kam harru.

22 Py. Është bërë brenda kompleksit të cilin e diskutuat sot
23 paradite me Avokatin e Mbrojtjes apo diku tjetër?

24 Pë. Nuk më kujtohet z. Prokuror. Saktë nuk e di. Unë jam
25 këtu, është Salih, po ambientin s'po e di saktë. Është bo 23

1 vjet.

2 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, është
3 momenti i përshtatshëm për të bërë pushimin.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
5 mirë faleminderit z. Prokuror. Znj. Sekretare ju lutem a mund
6 ta shoqëroni dëshmitarin jashtë sallës së gjyqit.

7 Z. Dëshmitar do të bëjmë pushim deri në orën katër. Do të
8 vazhdojmë më tej me dëshminë tuaj. Faleminderit.

9 DËSHMITARI: Ju lutem.

10 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
12 Mustafa e dini që nuk ju lejohet që të flisni dhe e dini këtë
13 gjë.

14 Shumë mirë atëherë. Do të vazhdojmë me seancën në orën 4.
15 Tani do të bëjmë pushim. Këtu ndërpritet seanca.

16 --- Pauza fillon në orën 15.33

17 --- Seanca rifillon në orën 16.00

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Le të
19 fillojmë me praninë. Shikoj që ka një ndryshim në përbërjeje.

20 Z. Prokuror e keni fjalën juve.

21 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Thuajse jemi në të njëjtën
22 përbërje, por Filippo De Minicis ka zëvendësuar kolegen time të
23 mëparshme Silvia D'Ascoli.

24 ZNJ. PUES: [Përkthim] Bashkëavokatja ime është larguar
25 dhe jam vetëm unë, Ani Pues e pranishme.

1 Z. VON BONE: [Përkthim] Nuk ka ndryshime në ekipin tonë.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.

3 Stenografe në qoftë se pra është e rëndësishme që të shkruani

4 përbërjen e ekipeve se është shumë e rëndësishme për

5 procesverbal. E shkruat se kush ishte i pranishëm apo? E

6 kuptojmë. Pra është e rëndësishme që të specifikohet siç duhet

7 përbërja e ekipeve.

8 Shumë mirë, atëherë do të vazhdojmë tani me dëshminë e

9 dëshmitarit 1500.

10 Z. Prokuror a ka mundësi të na jepni një vlerësim të

11 përafërt se sa kohë do t'ju duhet për të përfunduar me marrjen

12 në pyetje?

13 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Në qoftë se gjërat shkojnë

14 shumë mirë, mendoj edhe një orë.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk e

16 kuptova mirë.

17 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Brenda një ore.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] I

19 takon që nga ora 5. Ndoshta do të duhet që të duhet të

20 kërkojmë një zgjidhje tjetër.

21 Shumë mirë. Znj. Sekretare ju lutem shoqërojeni

22 dëshmitarin në sallë.

23 [Dëshmitari vijon dëshminë]

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë

25 se u kthyer z. Dëshmitar.

1 DËSHMITARI: Faleminderit.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do të
3 vazhdojmë tani me dëshminë tuaj. Do t'ja jap fjalën përsëri
4 Prokurorit.

5 Z. Prokuror e keni ju fjalën.

6 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Mirëdita z. Ajeti.

7 DËSHMITARI: Mirëdiata.

8 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]:

9 Py. Përpara pushimit ju tregova një fotografi ku kishin dalë
10 katër persona njëri prej tyre ishit ju, ishte Fatmir Sopi
11 Salih Mustafa dhe Agron Xhemajli.

12 A ju kujtohet kjo foto?

13 Pë. Po, z. Prokuror.

14 Py. A ju kujtohet se pse ishte i pranishëm Agron Xhemajli në
15 Zllash kur është bërë ajo fotografi?

16 Pë. Në kohën kur është bë ajo fotografi, dhjetor a kanë,
17 njëra prej shpijave që kjo ku kanë nejt ushtarët e Fatmir
18 Sopit edhe një ka qenë - unë sa e di - domethënë të vetmet
19 këto shpia që janë konë në atë kohë dhe aty ka qëndru Agron
20 XHemajli, sa kam ndejt unë.

21 Py. A ka qëndruar në të njëjtën shtëpi si Salih Mustafa në
22 atë kohë ai?

23 Pë. Edhe një herë nuk e kuptova pyetjen.

24 Py. Agron Xhemajli ka qëndruar në të njëjtën shtëpi ku ka
25 qëndruar dhe Salih Mustafa në atë kohë në 1998, 1999?

1 Pë. Po. Domethënë qaty në ato tri dhoma ose ktra aty kemi
2 qëndru të gjithë. S'ka pasë shumë ushtarë po këta që kemi qenë
3 në 1998.

4 Py. Kujt njësitit të UÇK-së i përkiste Agron Xhemajli.

5 Pë. Në atë periudhën e dhjetorit nuk e di çfarë njësitit a
6 kanë, a kanë ushtar, e vetmja a kanë BIA në atë kohë e ma vonë
7 e di që a kanë në brigadën 153. Po në 1999, në 1998, pasi jam
8 kanë direkt.

9 Py. A e dini në qoftë se Agron Xhemajli në ndonjë pikë ose në
10 1998 ose 1999 a ka bashkëpunuar me Salih Mustafën?

11 Pë. Nuk e di, domethënë e di që aty kemi qëndru bashkë. Besoj
12 që a kanë bashkëpunimi.

13 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës. Së pari do
14 të bëj pyetjen dhe pastaj do ju kërkoj leje që të shohim një
15 tjetër fotografi. Është një ndër fotografitë e fundit për sot.

16 Py. Z. Ajeti, të flasim për periudhën pas luftës. Madje edhe
17 për kohët e fundit. A të ka ndodhur ndonjë herë që të keni
18 kaluar kohë me Salih Mustafën me Bahri Gashin, -- ju kërkoj
19 ndjesë Brahim Mehmetjan. Pra Brahim Mehmetaj, ti vetë dhe
20 Salih Mustafa?

21 Pë. Po mendohem me ndjet -- Brahim Mehmetin, Baftën edhe me
22 Calin kemi ndejt mbas lufte.

23 Py. Po.

24 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës dua t'i
25 tregoj Dëshmitarit një fotografi shumë shkurtimisht. Është

1 dokumenti SPOE00325835-00325838.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Cila
3 është arsyeja?

4 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Dua të konfirmoj që Dëshmitari,
5 Salih Mustafa dhe anëtarë të tjerë të BIS-s rrinin me njëri-
6 tjetrin. Po flasim për kohët më të fundit.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
8 Vazhdoni ju lutem.

9 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] :
10 Py. Kjo është një fotografi që keni vendosur në adresën tuaj
11 të Facebook-ut e kujton që e ke fut këtë fotografi në adresën
12 tënde?

13 Pë. Po.

14 Py. E shoh që personat duke filluar nga e djathta është ju
15 Bimi dhe Salih Mustafa. Tre personat e parë janë këta, apo jo?

16 Pë. Po.

17 Py. Po personi që është ulur ngjitur me Salih Mustafën kush
18 është?

19 Pë. Ai është Bahri Gashi, Bafta.

20 Py. Po personi i fundit me këtë xhaketën jeshile?

21 Pë. Mustafë Ajeti.

22 Py. Kur është bërë kjo fotografi, të kujtohet?

23 Pë. Sa po e shoh unë këtë, vonë mars 2019. Me 3 mars.

24 Py. Pyetja ime ishte: ku, ku është bërë kjo fotografi?

25 Pë. Në njërin prej restorantave në Prishtinë.

1 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Faleminderit mund ta heqim këtë
2 fotografi.

3 Py. Z. Ajeti në dëshminë e dhënë sot e dhënë përpara pushimit
4 thatë se kur shkuat në Zllash në fund të marsit 1998, fjetët
5 aty për katër-pesë orë dhe pastaj shkuat në Keçekoll për të
6 vizuar familjen tuaj ku qëndruat dy ose tre ditë me familjen e
7 babait tënd.

8 A është e saktë kjo?

9 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Referencën do jua jap pas pak.
10 Pë. Po.

11 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Faqja 49 rreshtat nga 18 deri
12 22, të nderuar Gjykatës.

13 Py. Në faqen 53, në rreshtat 15 deri 21, thatë gjithashtu sot
14 se pas këtyre ditëve ti u ktheve në Zllash. Dhe deri sa ka
15 nisur ofensiva ke qëndruar atje gjatë ditës dhe gjatë natës
16 shkonit në Keçekoll për të fjetur atje. Dhe kjo ka ndodhur
17 deri në fillim të ofensivës në Viti të Marecit; kështu?

18 Pë. Po, z. Avokat.

19 Py. Z. Ajeti, a ka pasur ditë gjatë të cilave ti nuk ke qenë
20 në Zllash po ke qenë diku tjetër, gjatë kohës së ditës e kam
21 fjalën?

22 Pë. Po nëse ka ndodhur mos me kanë edhe në Zllash më kujtohet
23 që kam shku me Avni Hazirin e ka pasë familjen në një fshat,
24 Krilevë ose Glllogovicë, nuk po e di cilën. Një ditë kemi
25 lëviz, njëra prej ditëve domethënë, para ofensivës.

1 Py. Kjo ka ndodhur në prill 1999? Kështu?

2 Pë. Po. Po.

3 Py. A ka pasur raste të tilla të ngjashme gjatë të cilave ti
4 në prill 1999 je larguar nga Zllash dhe ke shkuar diku tjetër
5 gjatë ditës?

6 Pë. Këtë periudhë domethënë sa kam qëndru në prill nuk më
7 kujtohet dikun tjetër që kam lëviz.

8 Py. Dëshiroj të flas me ty shkurtimisht lidhur me
9 marrëdhënien që ke pasur me Selatin Krasniqin. A mund t'i
10 tregoni Trupit Gjykues se çfarë marrëdhënie keni aktualisht me
11 Selatin Krasniqin?

12 Pë. Aktualisht nuk kam ndonjë marrëdhënie. Rrallë, që nuk e
13 kam pa. Po e njoh që para luftës, kemi qenë në një lagje. Në
14 shkollë e di që ai a kanë ai më i vjetër se unë, po njihemi.

15 Py. Kur ka qenë hera e fundit kur e keni parë, e keni takuar
16 Selatin Krasniqin?

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Më
18 thuaj, më thuaj të lutem.

19 Pë. A muj me shku në seancë të mbyllur?

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po
21 dhe pastaj do më shpjegoj pse dëshiron të shkon në seancë
22 private.

23 Znj. Sekretare ju lutem të kalojmë në seancë private.

24 [Seancë private]

25 [Seancë private teksti i fshirë]

Dëshmitari: Muhamet Ajeti (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. Michalczuk

Faqe 137

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Muhamet Ajeti (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. Michalczuk

Faqe 138

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25 [Seancë e hapur]

1 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës
2 jemi në seancë publike.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
4 Faleminderit.

5 Z. Prokuror ju lutem vazhdoni.

6 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]:

7 Py. Z. Ajeti në një pikë të caktuar kohe ju i keni dhënë
8 deklaratë Mbrojtjes, është kështu:

9 Pë. Po. Z. Prokuror.

10 Py. Pasi e keni dhënë këtë deklaratë a keni folur ndonjë herë
11 me Selatin Krasnqin për deklaratën, për faktin që e keni dhënë
12 këtë deklaratë apo për faktin që ja keni dhënë Mbrojtjes këtë
13 deklaratë?

14 Pë. Jo.

15 Py. A e dini nëse Selatin Krasqni në një pikë të caktuar i ka
16 dhënë një deklaratë Mbrojtjes?

17 Pë. Jo. Atë e kam kuptu kur [REDAKTUAR]

18 [REDAKTUAR]

19 [REDAKTUAR]

20 [REDAKTUAR]

21 [REDAKTUAR]

22 [REDAKTUAR]

23 [REDAKTUAR]

24 [REDAKTUAR]

25 [REDAKTUAR]

1 Py. Pra, unë e kuptoj që ju e njihni njëri-tjetrin nga e
2 shkuara. [REDAKTUAR]

3 [REDAKTUAR]

4 [REDAKTUAR]

5 [REDAKTUAR]

6 [REDAKTUAR]

7 Py. Në një pikë e kuptoj që ju u [REDAKTUAR]

8 [REDAKTUAR]. A patët që të flisnit aty në [REDAKTUAR] pra?

9 Pë. Jo.

10 Py. Z. Ajeti, a i ke ndjekur proceset gjyqësore të kësaj
11 çështje, ato seancat të cilat janë transmetuar publikisht?

12 Pë. I kam përcjellë disa, jo krejt, veç goxha i kam
13 përcjellë, një pjesë.

14 Py. A mund të më thuash të lutem se cilët dëshmitarë keni
15 përcjellë?

16 Py. Besoj që ma shumë e kam përcjellë Nuredin Ibishin,
17 Komandant Lekën, Brahim Mehmetin e kam përcjellë. Jo krejt,
18 pjesërisht. S'po më kujtohet tjetër kënd e kam përcjellë
19 kështu. Po i kam përcjellë pjesërisht, domethënë seancat.

20 Py. A e keni përcjellë dëshminë e ditës së djeshme të dhënë
21 nga Selatin Krasniqi?

22 Pë. E kam pa diçka, domethënë, një pjesë e kam pa por jo
23 krejt, një pjesë.

24 Py. Z. Ajeti, sot na thatë që keni qenë në Zllash në prill
25 1999, kështu?

1 Pë. Po.

2 Py. Ju thatë gjithashtu se keni qëndruar brenda kompleksit të
3 familjes së Selatin Krasniqit në atë kohë, kështu?

4 Pë. Po.

5 Py. Megjithatë, në dëshminë e Selatin Krasniqit nga dje --

6 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Dhe flas këtu të nderuar

7 Gjykatës për faqen 117, rreshtat nga 3 deri në 5.

8 Py. -- ai ka thënë që nuk e mban mend që të të ketë parë. Ai
9 ka thënë si më poshtë.

10 "Nuk jam shumë i shqetësuar dhe nuk i kam parë ata deri
11 në ofensivë. Në fakt unë i kam parë atë - dhe e ka fjalën për
12 ty - në Prishtinë atë ditë kur Prishtina u sulmua nga forcat
13 serbe dhe më pas nuk e kam parë më deri në ofensivë deri në
14 kohën e ofensivës."

15 Ai ka thënë si më poshtë në faqen 119, resthat nga 1 deri
16 në 4

17 "Py. A e keni parë Z. Ajeti në kompleks përpara
18 ofensivës.

19 Z. Krasniqi tha:

20 "Nuk më kujtohet. Nuk më kujtohet. Mund të ketë qenë
21 atje, por nuk më kujtohet. Nuk më kujtohet nuk mund të them po
22 ose jo.

23 Z. Ajeti, ju e njihni Selatin Krasniqin për një periudhë
24 të gjatë kohe, jeni rritur me njëri-tjetrin, keni qenë
25 komshinj, fqinj për ca kohë dhe pretendoni që gjatë luftës

1 keni qëndruar në kompleksin e tij dhe që ka pasur një lidhje
2 të ngushtë. Megjithatë Selatin Krasniqi nuk e mban mend që
3 t'ju ketë parë juve në Zllash.

4 Çfarë do të thonit juve në këtë situatë?

5 Pë. I nderuar Prokuror aty a kanë -- ka pasë shumë njerëz dhe
6 ndoshta ka mujt me harru, unë e kam pa. Po Selatini ka mund
7 edhe mos me më kujtu. A kanë shumë e ngarkume shtëpia, nuk kam
8 koment për çfarë ka thënë Selatini. Veç ka mujt me e harru ose
9 ku me ditë.

10 Py. Ju po thoni që ju e patë Selatin Krasniqi po ndoshta ai
11 nuk ju ka pa juve?

12 Pë. Ai ndoshta ka harru me dëshmu ose e ka harru kujtesa se
13 është ba kohë e gjatë.

14 Py. Le të ndryshojmë pak temë. Sot kur i je përgjigjur
15 pyetjeve të bëra nga Mbrojtja folët për atë ambient dhe thatë
16 se kishte ambiente provizore mjekësore, a është e saktë kjo?

17 Pë. Po.

18 Py. Me 18 janar 2022, një prej komandantëve të brigadës nga
19 Brigada 153, Fatmir Sopi dha dëshmi në këtë Gjykatë lidhur me
20 këtë vend, me këtë kompleks në Zllash. Kjo reflektohet në
21 faqen 2116, rreshtat nga 14 deri në 22.

22 Kur ka folur për këtë kompleks ai nuk ka përmendur asnjë
23 objekt mjekësor. Ai ka përmendur një objekt mjekësor në
24 Zllash, po tha që ai gjendej diku tjetër. Këtë ka thënë ai
25 përpara kësaj Gjykate, para Trupit Gjykues.

1 "Py. A kishte ndonjë ambulancë në Zllash ose në afërsi të
2 Zllash për të transportuar njerëzit që kishin nevojë për
3 kujdes mjekësor?"

4 "Pë. Jo nuk kishim ambulancë në atë kuptim. Por kisha në
5 mendje një shtëpi që e quanim ambulancë në shqip. Edhe
6 ndërmjet njerëzve kur flasim, flasim për ambulanca kur flasim
7 për qendra ose klinika. Është një vend ku dikush mund të
8 shkojë dhe të marrë kujdes shëndetësor. Ishte një shtëpi në
9 pjesën lindore të shkollës e cila zotërohej nga Sahit Gashi."

10 Fatmir Sopi e ka dhënë këtë dëshmi mbi të njëjtën
11 çështje, të njëjtën ditë pra në vitin 2022 dhe tha se:

12 "Ambienti mjekësor ishte rreth 2 km larg kompleksit të z.
13 Krasniqi."

14 Ku ti pretendon se ke qëndruar. Dhe kjo është në faqen
15 2170, rreshtat nga 16 deri 19. Ky është këmbimi ndërmjet z.
16 Sopi dhe Prokurorit.

17 "Py. Kuptoj. Pyetja ime është kjo: sa larg ishte ky vend
18 ku mbanit personat e sëmurë dhe të plagosur nga vendi që
19 përdorej nga njësiti BIA?"

20 "Pë. Edhe në lidhje me të mund të jetë gati 2 km."

21 Pra Fatmir Sopi komandanti i Brigadës 153, tha që kishte
22 një ambient për trajtim mjekësor në Zllash, por jo në kompleks
23 se thoni ju se ishte ky vendi për trajtimin mjekësor.

24 A po thoni që z. Fatmir Sopi nuk ka thënë të vërtetën, po
25 sugjeroni këtë gjë?

1 Pë. Më fal. I nderuar Prokuror, a ka pasë ambulanta të tjera
2 ose vende -- unë një e di për shembull kur jena shku në Viti,
3 aty bash ku kena luftu a kanë një, i thojshin ambulantë. Këtu
4 e kanë trajtu popullatën. Por njerëz të luftës, të plagosun,
5 domethënë, është nuk di qysh me e shpjegu - me të vërtetë që
6 aty i kena trajtu, domethënë në Zllash, të plagosurit. Ka mujt
7 me pasë edhe poshtë te Saiti që unë nuk e di, po të gjithë të
8 plagosurit të cilët jena kanë në Viti të Marecit e kanë ardhë
9 prej anëve të tjera aty janë trajtu në atë vend.

10 Py. Fatmir Sopi që ishte një prej komandantëve të
11 Brigadës 153 dhe që ka jetuar në Zllash pjesën më të madhe të
12 jetës së vet, në qoftë se jo gjithë jetën tha "se në
13 kompleksin që kemi diskutuar sot nuk kishte një ambient për
14 trajtim mjekësor".

15 A jeni dakord me mua pajtoheni me mua se Fatmir Sopi
16 komandant i nivelit më të lartë do ta dinte më mirë se ku
17 gjendjet ambienti për trajtimin mjekësor apo ku nuk gjendej
18 ai?

19 Pë. Z. Prokuror ça ka thënë Fatmir Sopi unë nuk e di.
20 Nuk e kam dëgju. Po unë e di që me duart të mia i kam çu dy
21 njerëz në atë shtëpi dhe aty a kanë doktoresha Flora, kjo bre
22 Teuta Hadri, a kanë Ibadeti, edhe Qerim Hida ka ardh ma vonë.
23 Ai është vendi ku janë trajtu të plagosurit. Ma herët nëse ka
24 pasë ndonjë vend për me kontrollu, ambulantën nuk e di, po të
25 plagosurit aty janë trajtu. Po jua them me përgjegjësi të

1 plotë. Ai Fatmir Sopi ka mujt me u ngatërru unë nuk e di pse,
2 po unë i qëndroj kësaj që po them. Ka pasë aty të plagsur,
3 prej atyhit janë nisë për në Majac.

4 Py. Z. Ajeti, sot thatë dhe kjo reflektohet në faqen 73,
5 rreshti 3 se ju nuk e keni takuar Salih Mustafa në Zllash në
6 prill 1999. Është e saktë kjo?

7 Pë. Në Zllash nuk e kam taku në prill.

8 Py. Megjithatë, vetë Salih Mustafa kur i ka dhënë dëshminë
9 Prokurorisë ka thënë se ka thënë si më poshtë lidhur me
10 Zllashin.

11 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës është
12 deklarata e Salih Mustafës, transkripti i intervistës së ZPS-
13 së me Salih Mustafën me numër 069404-TR-ET Pjesa 7, rreshti
14 nga 16 deri në 21.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
16 lutem vazhdoni Prokuror.

17 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]:

18 "Deri para fillimit të bombardime çka do të thonë përpara
19 23, 24 prillit, në pjesën më të madhe të kohës kam qëndruar në
20 Sofali. Dhe pas kësaj periudhe, pas 24 prillit deri pas
21 përfundimit të ofensivës që ka qenë më 22 prill mund të kem
22 fjetur aty ndoshta dy herë, tre herë për disa net."

23 Këtu flet për Zllashin.

24 Salih Mustafa vazhdon të njëjtën deklaratë lidhur me
25 praninë e tij në Zllash dhe kjo është e njëjta pjesë e

1 transkriptit të intervistës së tij në faqen 12, në rreshtat
2 nga 2 deri në 9.

3 "Py. Ti vetë a ke qenë në Zllash përpara fillimit të
4 ofensivës serbe rreth datës 16 prill 1999?"

5 Salih Mustafa përgjigjet:

6 "Po."

7 "Py. Përpara fillimit të ofensivës sa kohë kishit që
8 ishit në Zllash?"

9 "Pë. Zakonisht qëndroja një ditë ose dy."

10 Ai vazhdon më tej lidhur me të njëjtën çështje dhe kjo
11 reflektohet në të njëjtën pjesë të transkriptit në faqen 22 në
12 rreshtat 17 deri 22.

13 "Pë. Po, po e drejtë. Ofensiva filloi me 16 dhe unë jam
14 larguar nga Zllashi ose me 12, ose me 13 ose me 14. Dhe unë
15 thashë që ishin disa ditë. Ka kaluar goxha kohë dhe nuk mund
16 të jem i saktë lidhur me këtë ditë."

17 "Py. Në rregull. Dhe kjo është përgjigja juaj?".

18 "Pë. Po, por siç e thashë unë jam kthyer mbrapsht aty me
19 20 prill."

20 Pra, vetë Salih Mustafa tha se ka qenë në Zllash në një
21 pikë të caktuar kohe për disa net për periudha të shkurtra
22 asokohe. Ai ishte komandanti yt, që prej vitit 1998 dhe ti po
23 thua që nuk e ke parë komandantin tënd që ka ardhur në Zllash
24 në prill të 1999?

25 Pë. I nderuar Prokuror unë të tregova ma herët këtë periudhën

1 kam qëndruar te dajët dy-tre ditë edhe kam lëviz. Edhe ka mujt
2 me kanë edhe njëra prej këtyre ditëve që kam shku atje në
3 Gllogovicë me Avni Azirin. Unë nuk më kujtohet që e kam pa.
4 Nuk di. Domethënë se kam parë, ka mujt -- Salih Mustafa ka
5 mujt me ardh aty, po unë nuk më kujtohet. Nuk po them që po
6 rren Salih, po ka mujt unë mos me kenë se nuk kena kanë veç
7 aty me nejt. Ose kena ndihmu ndonjë familje me e çu dikund.
8 Ose diçka, a po din, nuk kena kanë non-stop aty, domethënë
9 statikë.

10 Py. Ajo çfarë nuk arrij të kuptoj unë është kjo, që ai ishte
11 komandanti juaj gjatë gjithë kësaj periudhe gjatë luftës dhe
12 ti thua që -- ti ke qenë ushtari i tij dhe kur ai vinte aty,
13 ti nuk ishe i interesuar kur vinte, ku qëndronte, nuk ishte i
14 interesuar të takoheshe me komandantin tënd. Nuk e kuptoj këtë
15 gjë. A më ndihmon ta kuptoj pak?

16 Pë. Në këtë kohë nuk e kam taku. Takimin e kam pas në
17 Prishtinë një ditë përpara se me e leshu Prishtinën ose ditën
18 e mramtë edhe e kam taku në Koliq. Masi i kena tërheq të
19 plagosurit jam kanë me një pjesë të ushtarëve që janë hapë
20 korridoret [e pakuptueshme] i ka ra me çelë me përcjellë ato
21 [e pakuptueshme] edhe të plagosurit me ardh mas neve edhe në
22 koliq e kam taku Salih Mustafën.

23 Py. Do të kalojmë te kjo çështje për një çast se kam disa
24 pyetje lidhur me të. Megjithatë të flasim pak për faktin nëse e
25 keni parë apo e keni takuar Salih Mustafën në prill 1999 në

1 Zllash. Tani që po flasim për praninë e Salih Mustafës në
2 Zllash, edhe Selatin Krasniqi e ka konfirmuar, në deklaratën
3 që i ka dhënë këtij Trupit Gjykues se e ka parë Salih Mustafën
4 në Zllash. Kjo reflektohet në transkriptin e dëshmisë së ditës
5 së djeshme të Selatin Krasniqit faqe 75, rreshti nga 20 deri
6 në 25. Jepet gjithashtu dhe në faqen pasardhëse, 76. Rreshti
7 nga 1 deri në 10.

8 Ai thotë që e ka parë Salih Mustafën gjatë ofensivës në
9 Zllash. Ai thotë gjithashtu që Salih Mustafa ishte në Zllash
10 përpara ofensivës. Ai ka thënë se qëndroi për një natë dhe
11 Xheladini, Selatini e pa atë me 1 prill sërish në Zllash.

12 Pra duket sikur në këtë kohët pra 1 prill 1999 Salih
13 Mustafa ishte në Zllash dhe është parë nga dikush që ishte i
14 afërt me ju gjatë asaj kohe, Selatin Krasniqin dhe ti po na
15 thua që nuk e ke parë komandantin tënd atje?

16 Pë. Unë për qet kohë se kam pa. Unë edhe kur ka nis ofensiva
17 atë ditën që jena nis për Viti të Marecit e di që kur kam ardh
18 në mëngjes ishin ba gati me u nis në Viti. Domethënë që atë
19 natën kam qenë në Keçekoll kur kam ardh në mëngjes ishin
20 përgatit ushtarët dhe kam fillu me ta edhe në Viti të Marecit
21 kemi shku. Unë jam ardh me thënë të vërtetën nuk më kujtohet
22 që e kam pa Salih Mustafën shumë më mirë ta kisha pa, po s'em
23 kujtohet.

24 Py. Z. Ajeti, ti preke, fole për evakuimin e të plagosurve
25 nga Zllashi, kështu?

1 Pë. Po.

2 Py. Ti vetë ke marrë pjesë në largimin, pra në evakuimin e të
3 plagosurve në Zllashi në prill 1999?

4 Pë. Po.

5 Py. A mund të më thuash me saktësi kur ndodhi kjo heqja,
6 largimi apo evakuimi i të plagosurve nga Zllashi?

7 Pë. Me datën 20 prill prej Vitisë kemi ardh në Zllash edhe me
8 datën 21 prill kemi fillu evakuimin për në fshatin Majac.

9 Në mëngjes mu nuk më kujtohet që a kanë Salih Mustafa kur
10 jena nisë. A kanë Isa Kastrati, a kanë Rrahman Dini, a kanë me
11 21 tamam. Bahri Gashi që janë kanë tu u ba gati edh me u nis
12 për Llap për në fshatin Majac.

13 Py. Sa ta sqarojmë pak këtë çështje. Ti na the që në një
14 moment e pe Salih Mustafën gjatë këtij largimit të të
15 plagosurve. Ku e pe?

16 Pë. Në fshatin Koliq.

17 Py. Në fakt edhe sot kështu the në rreshtat 73, rreshtat 13
18 deri në 18 të transkriptit.

19 Kush e komandonte atë operacionin e evakuimit në Zllash
20 atë ditë?

21 Pë. Atë ditë domethënë në mëngjes e kam pa Isa Kastratin kur
22 ka bërë përgatitjen, Bahri Gashi janë kanë shumë të tjerë që nuk
23 më kujtohen edhe kemi fillu për në fshatin Majac.

24 Py. Por Salih Mustafën nuk e ke parë gjatë evakuimit në
25 Zllash, kështu?

1 Pë. Në mbrëmje në Koliq ose të nesërmen se s'po di [e
2 pakuptueshme] jena shku deri në Koliq, por në mbrëmje mendoj
3 që kena mbri në Koliq.

4 Py. Z. Ajeti, dua që të kthehemi pas në kohë, tek intervista
5 që i ke dhënë ZPS-së, më fal që i ka dhënë Salih Mustafa ZPS-
6 së ku vetë thotë që ai vetë ishte përgjegjës për largimin e
7 njerëzve nga Zllash.

8 Dëgjoje këtë që do të të them.

9 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Ju lutem, të nderuar Gjykatës,
10 të tregojmë në ekran një pjesë të shkurtër të deklaratës së
11 Salih Mustafa.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po
13 vazhdoni.

14 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Është mirë ta lexojmë të gjithë
15 bashkë. Është e njëjta pjesë Pjesa 7 e kësaj interviste,
16 rreshtat nga 8 ne 12.

17 Dëgjo Z. Ajeti se çfarë ka thënë vetë z. Salih Mustafa
18 lidhur me këtë evakuimit.

19 "Megjithatë pas ditës së tretë të ofensivës, ata u morën
20 me largimin e të plagosurve nga zona a luftës dhe të çuarin e
21 tyre në spitalin ushtarak apo atë - në pjesën e Llapit. Unë e
22 drejtoja - më morën në telefon nga një vend tjetër për ta
23 drejtuar operacionin sepse nuk isha aty."

24 Dhe vazhdon në të njëjtën deklaratën. Në faqen 22 dhe 23
25 është prapë Pjesa 7.

1 Dhe thotë kështu:

2 "Kur u ktheva në 20 prill, mblodhëm të plagosurit, mjekët
3 u dhanë ndihmën e parë dhe i mblodhëm ushtarët e rënë në
4 luftë. Më 21 në mëngjes i futëm në jeep-a në makina të
5 ndryshme dhe filluam një të ecim në kolonë dhe pastaj u
6 përpoqëm ti largonim ofensivës në zonën e llapit. Këtë e bëra
7 me ndihmën e njerëzve të mi, ushtarëve të gueriljes."

8 Z. Ajeti Salih Mustafa thotë që jo vetëm që ka marrë
9 pjesë në evakuim, por ishte kryesuesi i këtij operacioni. Dhe
10 ti po na thua se nuk ishte aty i pranishëm? Dhe kjo ka ndodhur
11 në momentin e largimit të të plagosurve nga Zllashi pas
12 ofensivës. Mos po thua që Salih Mustafa nuk i ka thënë të
13 vërtetën Prokurori lidhur me punën që ka bërë në atë kohë, me
14 evakuimin me përfshirjen e tij aty?

15 Pë. I nderuar Prokuror, Salih Mustafa thotë që s'kam qenë aty
16 po kam ardh. Ne gjatë përgatitjes së të plagosurve, ne veç një
17 pjesë e ushtarëve kemi fillu me bë, domethënë, sigurinë. Me
18 çel rrugën deri në asfalt atje poshtë ku prehet rruga për
19 Koliq dhe ndoshta - domethënë jo noshta po unë i besoj që ka
20 thënë që Salih ka ardh në atë kohë. Po na jena nis të parët.
21 E kur kena mbri në Koliq ka ardh dhe Salih Mustafa. A jam i
22 kjartë?

23 Py. Por Salih Mustafa nuk po thotë që kam qenë dikun tjetër,
24 ai thotë mblodhëm shokët tanë që kishin rënë në luftime dhe në
25 mëngjes u nisëm nga Zllashi. Nuk po flet për Koliqin nuk po

1 thotë që po priste aty derisa sa t'i sillnin të plagosurit. Po
2 thotë që vetë ka marrë pjesë në evakuimin e të plagosurve nga
3 Zllashi. Po e kryesonte operacionin. Mos po thua që nuk ka
4 qenë kështu, që nuk ka ndodhur kështu ashtu siç thotë ai.

5 Z. Ajeti na thuaj ishte apo s'ishte në Zllash Salih
6 Mustafa? Ai ishte komandant yt, ai thotë që ai ishte aty.
7 Pë. I nderuar Prokuror unë në mëngjes tregova. Unë i kam nis
8 një pjesë të ushtarëve me bo sigurinë e rrugës. Nuk po them që
9 po rren Salih Mustafa edhe a kanë pjesë e operacioneve edhe
10 unë e di që në Koliq kur ka ardh -- se ne jena kanë një pjesë
11 që kena dalë me siguru rrugën. Kur jena ardh në Koliq, muj me
12 thënë lirisht që barrën më të madhe e kam majt unë prej
13 Koliqit deri në fshatin Majac -- e kam ditë terrenin edhe i
14 kam njoft eprorët atje. Ma ka dhënë një radiolidhje në Koliq
15 Sejdi Veseli që me komuniku gjatë rrugës dhe aty në Koliq
16 unë jam taku, mbasi kanë ardh. Unë kam qenë në përcjelljes në
17 hapjen e rrugës, të plagosurit janë kanë përmas. Edhe në Koliq
18 thuajse pjesën e madhe unë e kam pasë miqësi për shkak që e
19 kam njoft terrenin, i kam njoft eprorët atje të Majacit dhe
20 janë dalë e më kanë pritë atje në fshatin Vranidoll, në vendin
21 tem.

22 Py. Po.

23 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, edhe
24 Fatmir Humolli kur dëshmoi përmendi përfshirjen e Salih
25 Mustafës në evakuim. Me lejen tuaj do të lexoj një pjesë të

1 shkurtër të dëshmisë së tij nga transkripti. Është transkripti
2 i 1 shkurtit 2020, faqja 2351 rreshtat 8 deri në 19.

3 Pyetje që i është bërë Fatmir Humollit:

4 "Mori pjesë Salih Mustafa në lëvizjen e të plagosurve nga
5 Zllashi? A e ke parë atë duke e bërë këtë punë, duke i
6 ndihmuar njerëzit të largohen duke marrë pjesë pra në këtë
7 proces?"

8 Përgjigje e Fatmir Humollit:

9 "Ai u përfshi personalisht, Salih Mustafa. Sepse e kishte
10 edhe një shok të tij që ishte i plagosur dhe e mbaj mend që
11 shkoi te i plagosuri."

12 "Py. Pra ti e pe që po kujdesej për të plagosurit duke
13 qenë me ta?"

14 "Pë. Po ishim bashkë ai më pa mua unë e pashë atë. Ne u
15 angazhuam në të njëjtin proces të transportit të të plagosurve
16 në prapavijat e vijave të armikut."

17 Edhe Fatmir Humolli një nga anëtarët e komandës së Zonës
18 Operative të llapit tha se Salih Mustafa ishte aty duke
19 ndihmuar të plagosurit në Zllash.

20 Dhe ti vazhdon ende të thuash se nuk ishte aty komandanti
21 aty, nuk ishte në Zllash këtë po thua?

22 Pë. Z. Prokuror unë e paskam harru se është ba kohë 23 vjet.

23 Edhe Fatmir Humollin që e pasna harru me e përmend. Fatmir
24 Humollin e njoh ma shumë se Calin se më ka ra me e njoft edhe
25 në Shalë të Bajgorës e kam pa edhe në Majac. Për shembull, e

1 paskam harru me e përmend. Po unë kur jena nis në mëngjes,
2 jena nis një pjesë me ba sigurimin e rrugës. Nuk po them s'a
3 kanë Salih Mustafa, po unë s'e kam pa se jam nisë me ba
4 sigurimin e rrugës.

5 Py. Pra, nuk ishte Salih Mustafa aty apo ti nuk e mban mend
6 që të ketë qenë aty duke u kujdesur për të plagosurit në
7 Zllash?

8 Pë. Unë -- Z. Prokuror, ajo ma së pari ajo ka qenë një javë
9 shumë e zorshme kur i kena dërgu të plagosurit. Të nesërmen,
10 unë s'po di a është Cali a jo, po unë nuk po e di që a kanë
11 atë natë. Po të nesërmit mu nuk më kujtohet që e kam pa. Më
12 shumë Isa Kastratin e kam pa tu u marr me Sokol Sopin edhe
13 neve na kanë thanë, domethënë, me u nis me ba sigurimin.
14 Domethënë, sa e di, Bahri Gashi edhe a kanë edhe Fatmir
15 Humolli tash më kujtohet edhe kena nis me çel rrugën nga
16 domethënë [e pakuptueshme] edhe me dalë në Koliq.

17 Py. Z. Ajeti, kur të pyeti Mbrojtja sot ti the që nuk ke parë
18 asnjë njeri të ndaluar në Zllash. Kështu ka qenë?

19 Pë. Po unë nuk kam pa njeri të ndalum në Zllash. As kam ni.

20 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës në kuadër
21 të atij kompleksit dhe duke pasë parasysh këto që thotë
22 dëshmitar që nuk ka parë ndonjë të ndaluar në Zllash, dëshiroj
23 t'i tregoj një fotografi që i është bashkëngjitur deklaratës
24 së marrë nga Mbrojtja dhe që u tregua edhe sot.

25 Deklarata e Muhamet Ajetit me DSM000615 deri në 00632

1 [sipas përkthimit], faqja 13. Është një fotografi e kompleksit
2 me disa shënime të bëra nga vetë dëshmitari. Është faqja 13.

3 Jo duhet të jetë një fotografi. Kjo është faqja ku
4 përmendet. Ju lutem shkoni në fund, aty në fund fare pothuaj
5 është një fotografi. Ja këtë desha. Po. Faleminderit shumë.
6 Py. Z. Ajeti, besoj që sot kur diskutove me Mbrojtjen këtë
7 fotografi i shpjegove Gjykatës se çdo të thoshte A-ja, B-ja C-
8 ja, D-ja. Këtu shikojmë edhe një rreth. E shikon këtë rrethin
9 e bërë me të zezë?

10 Pë. Po.

11 Py. Ti vetë e ke bërë këtë rreth kur i dhe deklaratën
12 Mbrojtjes?

13 Pë. S'po di a kanë Avokati po unë më duket e kam ba. Po, po
14 unë.

15 Py. A mund t'i thuash Gjykatës se çfarë tregon ai vendi aty?
16 Ai rrethi çfarë përfaqëson, çfarë tregon?

17 Pë. Avokati më ka pyet çfarë është kam thënë "nuk di, mund të
18 jetë një podrum, apo ça po di unë". Që kjo ka qenë pyetja.

19 Py. Ke qenë ti në atë vend që e ke rrethuar vetë gjatë
20 luftës?

21 Pë. Në oborr po, aty brenda s'më kujtohet që jam hy kurrë.

22 Py. Z. Ajeti shikoje edhe një herë fotografinë. A ka pasur
23 ndonjë ndërtesë që është përdorur nga njësitit gueril BIA? Nuk
24 besoj se është bërë kjo pyetje dhe ka marrë përgjigje sot.

25 Po e përsëris. A kishte ndonjë ndërtesë në Zllash në këtë

1 kompleks apo në një vend tjetër që është përdorur nga njësit

2 BIA gjatë luftës?

3 Pë. A me u përgjigj?

4 Në njërën prej këtyre shtëpive ka ndejt edhe guerilja

5 BIA, domethënë në anën e djathtë më shumë, sa unë kujtoj.

6 Py. Pra, po na thua që në këtë kompleks nuk kishte ndonjë

7 vend ndalimi me sa ti di, kështu?

8 Pë. Unë s'kam dëgju kurrë që ka pasë vendndalim në këtë farë

9 shtëpie.

10 Py. Por megjithatë, vetë Salih Mustafa në deklaratën që i ka

11 dhënë ZPS-së e ka pranuar se kishte të ndaluar pikërisht në

12 atë vend.

13 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Dhe me lejen tuaj, të nderuar

14 Gjykatës, dua të lexoj një pjesë të shkurtër të deklaratës së

15 Salih Mustafës dhe do të bëj një pyetje pas asaj.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju

17 lutem vazhdoni.

18 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Për procesverbal është

19 transkripti i intervistës së Prokurorisë me Salih Mustafën me

20 numër 069404-TR-ET, Pjesa 7, faqja 6 dhe 7.

21 Pyetje që i është bërë Salih Mustafës:

22 "Ju thatë që kjo shtëpi është përdorur edhe si një qendër

23 ndalimi."

24 "Pë. Nga ato që di unë, vetëm një dhomë kishte ushtarë që

25 shkelnin rregullat."

1 "Py. Mbaheshin poshtë në katin e parë?"

2 "Pë. Po në katin përdhes. Kishte tre dhoma ishte një
3 dhomë më e madhe që përdorej edhe si kuzhinë."

4 Kurse në faqen tjetër, në faqen 7, në rreshtat 21 deri në
5 25 - më falni vazhdojmë prapë te faqja 6, rreshtat 21-26.

6 "Py. Keni parë ju me sytë tuaj që të ndaloheshin ushtarë
7 në atë vend?"

8 "Pë. Po."

9 "Py. Në sa raste ju kujtohet keni parë ushtarë apo
10 persona në atë vend të ndaluar?

11 Në faqen tjetër, faqja 7, rreshti 1, 2 dhe 3.

12 "Pë. Do të thoja dy apo tre."

13 "Py. Dy apo tre raste?"

14 "Pë. Po, do të thoja po."

15 Z. Ajeti a pajtohesh me mua se Salih Mustafa, komandanti
16 BIA-s do ta kishte ditur më mirë se ti apo jo se kishte të
17 ndaluar aty?

18 Pë. I nderuar Prokuror, unë për periudhën të cilën kam
19 qëndruar aty, një javë ditë dhjetor 1998, nuk kam pa. Edhe në
20 këtë kohën që kam ardh mas marsit, unë nuk kam pa. Nëse ka
21 folur për ndonjë periudhë tjetër Salih Mustafa këtu unë nuk
22 kam pa njerëz të ndalum. Nuk e di për çfarë kohe keni pyetur
23 unë dhjetor mars kam qenë në Majac edhe kur jam kthy unë nuk
24 kam ni që këtu ka pasë diçka të ndalumë.

25 Sigurisht që Salih Mustafa e din ma mirë, po unë për atë

1 periudhën dhjetor që jam kanë edhe kur jam kthi me 31 mars ose
2 30 dhe deri në ofensivë të Vitisë unë nuk kam dëgju kurrë që
3 ka pasë të ndalum. Masanej për periudhë tjetër unë nuk e di.
4 Py. Z. Ajeti sot na the se nuk kishte roje në atë kompleks
5 kështu e the sot apo jo:

6 Pë. Unë s'kam pa roje që ka pasë në këtë vend.

7 Py. Kur Salih Mustafa ka folur me Prokurorinë, kur po flitej
8 për atë dhomën ku mbaheshin të ndaluarit ai e pranoi vetë se
9 ushtarët e UÇK-së e ruanin këtë vend.

10 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Dhe me lejen tuaj do të tregoj
11 një pjesë të deklaratës.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
13 Vazhdo.

14 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Prapë është Pjesa 7 rreshtat 23
15 deri 24.

16 Pyetja e Prokurorisë ishte:

17 "Kush e ruante dhomën ku mbaheshin të ndaluarit?"

18 Salih Mustafa është përgjigjur:

19 "Ushtarët e UÇK-së."

20 Pra, po na thua që Salih Mustafa, komandanti nuk po
21 tregon të vërtetën kur flet për roje?

22 Pë. Z. Prokuror për këtë kohën që jam kanë unë, unë nuk kam
23 pa. Aty janë shumë muaj që s'kam qenë unë. Që këtë periudhën
24 dhjetor që kam qëndru nja një javë edhe me kohën kur jam kthi
25 prej Prishtinës deri në fund të ofensivës, unë nuk kam pa dhe

1 nuk ka ni.

2 Py. Z. Ajeti, nuk është vetëm Salih Mustafa që flet për
3 rojet. Edhe një komandant tjetër i UÇK-së, Fatmir Sopi foli
4 për praninë e rojeve në kompleksin e Zllashit.

5 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Dhe me lejen tuaj, të nderuar
6 Gjykatës, dëshiroj të citoj dhe disa rreshta të shkurtër nga
7 deklarata e Fatmir Sopit lidhur me praninë e rojeve në Zllash.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
9 Vazhdoni.

10 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Është dëshmia e Fatmir Sopit që
11 e dha këtu, e datës 8 janar 2022, faqja 2049, rreshtat nga 9
12 në 17.

13 Pyetje ndaj Fatmir Sopit:

14 "E mban mend nëse kjo shtëpi, ky kompleks ruhej nga
15 rojet?"

16 Përgjigje:

17 "Në çdo vend ku ishte stacionuar UÇK-ja për sigurinë e
18 vet sigurisht, kishte roje."

19 Pyetje:

20 "Pra, kush ishin rojet, i takonit ndonjë njësie, njësisë
21 BIA apo ndonjë tjetre?"

22 Përgjigje:

23 "Dua të them çdo njësi e vendosur diku kishte ushtarët e
24 vet që bënë roje si zakonisht. Caktonin dikë që të bënte
25 roje."

1 Z. Ajeti, ky kompleksi për të cilin po flasim, ky
2 kompleksi ishte plot me ushtarë të njësitit BIA edhe disa
3 ushtarë të tjerë dhe tani po thua që ky vend nuk ruhej fare me
4 roje?

5 Pë. I nderuar Prokuror, unë nuk kam pa roje, për këtë
6 periudhë unë sa kam qëndruar unë. Them me siguri të plotë që
7 unë nuk kam taku roje. Dhe Fatmir Sopi edhe ai ma herët kish
8 thënë që nuk ka pasë spital. Ai është vendi që këtu janë shëru
9 të plagosurit. Domethënë unë n - Fatmir Sopi ka mujt me ja [e
10 pakuptueshme] unë nuk kam taku roje. Për periudhën që jam kanë
11 edhe ça kam pa unë. Këtu kam ardh të them të vërtetën edhe [e
12 pakuptueshme].

13 Py. Z. Ajeti, a do të pajtohesh me atë që tha Fatmir Sopi se
14 në çdo vend, në çdo objekt ku kishte ushtarë, duhet të ketë
15 disa ushtarë përreth. Atë e tha vetë ai. A pajtohesh ti me
16 këtë?

17 Pë. Unë vetëm ça them vetë i qëndroj, deklaratave të tjera
18 nuk muj me i komentu. Unë - ti po më pyet a ke pa, unë nuk kam
19 pa roje në këtë periudhë sa kam qëndru unë. Sa janë një javë a
20 -- në dhjetor edhe në këtë periudhën e prillit, nuk kam taku.

21 Py. Sa për ta përmbledhur tani këtë pjesë lidhur me praninë
22 apo mungesën e rojeve në kompleksin e Zllashit. Salih Mustafa,
23 komandanti që ka thënë se kishte roje. Fatmir Sopi, një nga
24 komandantët e Brigadës 153 gjithashtu thotë se kishte roje dhe
25 se në çdo vend ku kishte UÇK kishte roje, njerëzit caktohen

1 për të bërë roje dhe ti po thua se në kompleksin e Zllashit që
2 ishte një objekt i UÇK-së dhe nuk kishte roje? Ta kuptoj më
3 mirë këtë gjë, është një vend ushtarak, objekt ushtarak dhe ka
4 ushtarë nga njësite të ndryshme dhe ti thua që nuk kishte
5 roje?

6 Pë. I nderuar Prokuror, unë jam ardh me dëshmu çka ka pa unë
7 edhe çka kam ni unë. Nuk kam pa për këtë periudhë. Ti nëse më
8 pyet për shembull, në Shalë të Bajgorës, në atë shkollë, ka
9 pasë roje, kam pa roje. A po kupton. Por këtu në këtë
10 periudhë, unë kam qenë shkurt, në këtë pjesë. Domethënë, për
11 një kohë të shkurtër. Kohën që kam qëndru unë nuk kam pa. Nëse
12 është ruajtur ma poshtë dikun unë nuk e di, po qitu unë nuk
13 kam taku roje.

14 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Kam edhe disa pyetje të fundit,
15 të nderuar Gjykatës, dhe mbase mund të vazhdojmë pa pushim
16 nëse më lejoni.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk
18 kemi pushim, do të vazhdojmë deri në pesë e gjysmë pastaj do
19 të vazhdojmë. Mbase një mundësi është që ta thërresim përsëri
20 Dëshmitarin në qoftë se do të kemi më shumë pyetje pas kësaj
21 ore.

22 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]:

23 Py. Z. Ajeti, unë të pyeta më parë nëse në këtë kompleks për
24 të cilin po diskutojmë dhe që ti e ke përpara në fotografi, a
25 përdornin ushtarë të njësitit ndonjë nga këto ndërtesat dhe ti

1 the "po". E di ti nëse ndonjë prej këtyre ndërtesave ishte si
2 shtëpi e sigurt e njësitit tënd BIA?

3 Pë. Unë s'po di çfarë kuptimi është "shtëpi e sigurt" këtu.
4 Domethënë kanë qendru ushtarë të ndryshme, në periudha të
5 ndryshme. Ka pasë banorë, civilë, domethënë.

6 Py. A kishte ndonjë vend në këtë kompleks ku rrinin vetëm
7 ushtarët e BIA-s, vetëm ata kur ishin aty?

8 Pë. Unë për shembull me të tregu për periudhën dhjetor. Në
9 dhjetor kemi qendru vetëm në ato shtëpia në anën e djathtë. Në
10 dhjetor aty a kanë edhe një pjesë e zonës së Karadakut, a kanë
11 Muhamet Isufi, a kanë me disa ushtarë të tijna. Jam kanë unë
12 me këta katër shokë të mi a pesë, a kanë Rrahman Dini, Agron
13 Xhemajli. Krejt kemi fjetë në atë pjesë. Tash unë jam kanë i
14 gueriljes ata janë kanë të Karadakut. Domethënë kryesisht ma
15 shumë qaty a banu. Kjo shtëpia ma vonë, me sa kam kuptu unë,
16 është gëlqeros edhe kanë nis me fjetë edhe popullatë, si
17 ushtarë në këtë pjesën tjetër. Kështu një vend të saktë [e
18 pakuptueshme] nuk e di domethënë. Kanë fjetë ku kanë mujt
19 brenda kësaj hapësire, sa e di unë.

20 Py. Po në prill 1999 a kishte ndonjë vend në këtë ndërtesë që
21 përdorej vetëm ekskluzivisht nga njësitit BIA?

22 Pë. Nuk e di unë çka ka pasë ekskluzivisht për BIA-n ai vend.

23 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, dua të
24 lexoj një pjesë të deklaratës së Salih Mustafës lidhur me këtë
25 shtëpinë e sigurt.

1 Është deklaratë e Salih Mustafës 069404-TR-ET Pjesa 7,
2 faqja 5, rreshtat 8-24.

3 Salih Mustafa me shumë saktësi ka folur për këtë çështje.
4 Dhe dëgjoje shkëmbimin e fjalëve midis Prokurorit dhe Salih
5 Mustafës.

6 "Py. Sa herë e ke vizituar këtë vend?"

7 "Pë. Nuk e di me saktësi po shumë herë."

8 "Py. Pse e ke vizituar?"

9 "Pë. Sepse kjo ishte shtëpia ku flinin edhe ushtarët e
10 mi. Këtë shtëpi e përdornim si shtëpi të sigurt."

11 "Py. Në këtë shtëpi që e kanë përdorur ushtarët në çfarë
12 vendi, në çfarë pjese të saj qëndronin?"

13 "Pë. Në dy dhomat e para."

14 "Py. Se the se kishte edhe një pjesë poshtë edhe një
15 pjesë lartë, pra ku ishte lart apo poshtë?"

16 "Pë. Ishte lartë."

17 "Py. Të kujt të ishin këto shtëpi, kush i kontrollonte?"

18 "Pë. UÇK-ja."

19 "Py. Cila njësi e UÇK-së?"

20 Salih Mustafa tha:

21 "Unë dhe ushtarët e mi i kishim nën kontroll këto dy
22 dhoma konkrete të cilat i përdornin për vete."

23 Pra, si pjesëtar i BIA-s, që ke qëndruar në Zllash në
24 dhjetor, në prill, a do ta konfirmosh këtë që ka thënë Salih
25 Mustafa, se kishte disa dhoma në atë shtëpi që përdorehin nga

1 BIA kur ata, ushtarët e njësitit ishin aty?

2 Pë. Unë në kohën e dhjetorit kam qëndru në njërën prej
3 dhomave. Por mendoj që a kanë ma e fundit. Ka pasë do shtretër
4 dy kate, aty kam qëndru unë. Në një dhomë tjetër kanë qëndru
5 këta pjesa e Zonës së Karadakut, një pjesë e kena pasë një
6 dhomë e ndjenjës. Domethënë kështu nuk më kujtohet që a kanë
7 special diçka kështu për guerilen.

8 Py. Por në prill 1999, e përdorte BIA këtë vend?

9 Pë. Z. Prokuror, a kanë katrahura, ça me thonë, aty kanë
10 fjetë qysh kanë mujt, civilë, ushtarë, nuk kam detaje kështu
11 për prill. Janë kanë civilë, familje, fëmijë. Janë kanë --

12 Py. E the edhe më përpara që kishte shumë njerëzit, ushtarë.

13 Pyetja që kam unë është kjo: Në prill 1999 ushtarët e BIA-s
14 përdornin ndonjë vend të kësaj shtëpie për veten e tyre?

15 Pë. Po brenda këtij oborri kanë qëndru. Po saktësisht nuk e
16 di në cilat dhoma kanë fjetë. Unë kur kam fjetë një natë a dy,
17 q'aty dikund prej njonës, por tash janë bo 23 vjet, kur nuk e
18 di në cilën kam fjete në q'ato ditë, se a kanë --

19 Py. Ti ke qenë anëtar i BIA-s. Ti njihje edhe pjesëtarë të
20 tjerë dhe nuk e di se ku rrinin ata në atë shtëpi, si
21 komandant mundësi?

22 Pë. Jo nuk po them nuk e di. Kryesisht kjo shtëpia në të
23 djathtë ku janë katër dhoma aty kanë fjetë domethënë ushtarë,
24 edhe të BIA-s edhe një pjese që po jua tregoj ma herët, të
25 Karadakut, Agron Xhemajli e këta. Nga prilli janë kanë të

1 përzim, unë mendoj.

2 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës edhe një
3 citim të fundit dhe besoj nuk do të kem më pyetje. Me lejen
4 tuaj me shumë kënaqësi do t'i tregoja një pjesë tjetër të
5 transkript nga dëshmia e Fatmir Humollit për të njëjtën
6 çështje, lidhur me BIA-n në Zllash.

7 Py. Z. Ajeti, Fatmir Sopi dëshmoi për këtë çështje në 18
8 janar 2022. Dhe këtë e kemi në faqen 2045, rreshtat 11 deri në
9 19. Dhe ai po fliste për përdorimin e të gjithë kompleksit si
10 bazë e BIA-s. Ai tha sa më poshtë:

11 "Py. Njësia e BIA-s kishte ndonjë vend në Zllash ku ishte
12 e vendosur?"

13 "Pë. Po kishin një vend në Zllash."

14 "Py. Ku ishte vendosur njësia, ku ishte ky vend?"

15 "Pë. Ishte në pikën më të lartë në Zllash në pjesën veri-
16 lindore të fshatit."

17 "Py. Sa larg ishte shtëpia jote, z. Sopi dhe ky vendi në
18 Zllash?"

19 "Pë. Nuk jam i sigurt, ndoshta dy-tre kilometra, ndoshta
20 diçka e tillë."

21 Dhe vazhdojmë më tutje faqja 2049 rreshtat 4 deri në
22 pesë.

23 "Py. Po thua se BIA e kishte zënë të gjithë këtë
24 kompleksin?"

25 "Pë. Po, po në atë shtëpi po."

1 Pastaj Fatmir Sopit i treguan fotografi të këtij
2 kompleksit.

3 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Me numër SPOE00123888. Mund t'i
4 kthehemi përsëri fotografisë që iu tregua Dëshmitarit me ato
5 shenja.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
7 Vazhdoni.

8 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Ose mund t'i tregojmë
9 fotografinë pa shenja që është në listën e provave materiale.
10 Mbase është më mirë të Prokurorisë SPOE00128, 388.

11 Py. Fatmir Sopit i treguan fotografinë që diskutuam sot gjatë
12 e gjatë, që përshkruan këto tre ndërtesa. Dhe në faqen 2053,
13 rreshtat 22 dhe në faqen 2054 rreshtat 1-7 ai ka thënë kështu:

14 "Py. z. Sopi do të të tregoj një fotografi tjetër. Për
15 procesverbal numri është SPOE00128388."

16 "Py. Z. Sopi e shikon këtë fotografi që ke përpara?"

17 "Pë. Po."

18 "Py. Çfarë tregon kjo fotografi?"

19 "Pë. Një shtëpi."

20 "Py. Sot para pak minutash ne diskutuam vendosjen e BIA-
21 s. Për këtë bëhej fjalë për këtë vend?"

22 "Përgjigje. Po. Shtëpia e madhe në anën e djathtë të
23 fotos."

24 "Py. Kjo është shtëpia që e kanë përdorur ushtarët e BIA-
25 s si vendndodhje?"

1 "Pë. Nuk e di cilën pjesë kanë përdorur, përse e kanë
2 përdorur por është pjesë e këtij kompleksi."

3 "Py. Pra përpara sot ju thatë se BIA e ka përdorur të
4 gjithë kompleksin, kështu është?"

5 Dhe z. Sopi ka thënë "po".

6 "Py. E kuptojmë drejt se BIA e ka përdorur të gjithë
7 kompleksin që duket në fotografi që ta kemi për procesverbal?"

8 "Pë. Po, po."

9 Pra sipas Fatmir Sopit, një nga komandantët e Brigadës
10 153, BIA e ka përdorur këtë kompleks, më saktësisht shtëpinë
11 në anën e djathtë të fotografisë. Të njëjtin kompleksin të
12 cilin e njeh dhe ti dhe ku ke kaluar dhe ti ca kohë në prill.

13 Pra, e ka përdorur BIA këtë shtëpi siç ka shpjeguar z.
14 Fatmir Sopi?

15 Pë. Këtë [e pakuptueshme] ma herët. I nderuar Prokuror, --

16 Py. Është i njëjti, është e njëjta fotografi. Po e para ishte
17 me shënimet që kishe bërë ti, me ato A, B, C, D, në qoftë se
18 të kujtohet. Është e njëjta fotografi po pa këto shënimet.

19 Është e njëjta fotografi që i është treguar edhe Fatmir Sopit
20 kur ka dëshmuar në këtë Gjykatë.

21 Pra pajtohesh me Fatmir Sopin se BIA, njësia jote, ishte
22 vendosur aty dhe e ka përdorur këtë kompleks për qëllimet e
23 veta?

24 Pë. Unë nuk e mohova që BIA nuk ka qendru këtu. Po unë
25 mendova për atë pjesën tjetër që janë diskutu edhe ku janë

1 kanë katër dhomë. Dhe pyetja ishte sikur a kanë njëra dhomë
2 speciale veç për BIA-n. Kryesisht në anën e djathtë kanë
3 qëndru guerilja BIA.

4 Edhe për sa i përket Fatmir Sopit ça ka thënë, -- tash
5 Fatmir Sopi ka lind aty edhe me thanë 3 km i ka shkolla prej
6 kësaj shpie, -- unë 3 km gati arrij në Prishtinë. Kjo është 7-
7 800 metra me kilometër. Edhe nuk po them që guerilja nuk kanë
8 fjetë këtu. Jo në këtë, se kjo pjesë a kanë deri janë ardh të
9 plagosurit edhe popullata. A pjesën tjetër kryesisht kanë
10 qëndruar ushtarët e gueriles. Unë nuk jam tue - unë veç
11 mendova se po më pyet njëren pjesë a kanë një dhomë speciale,
12 qashtu diçka, mendova. Kryesisht është shfrytëzuar prej
13 gueriljes q'ajo pjesa në anën e djathtë.

14 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Më lejoni të konsultohem për
15 pak me kolegët të nderuar Gjykatës.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pas
17 pak minutash do të pushojmë do ta ndërpresim punën.

18 [Përfaqësuesit Prokurorisë këshillohen]

19 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Kaq kisha për pyetjet tona.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
21 Faleminderit z. Prokuror.

22 Tani do të pyes, të shoh se ku jemi me pjesën tjetër të
23 pyetjeve.

24 Mbrojtësja e Viktimave sa kohë afërsisht do t'ju duhej

1 për t'i bërë pyetje dëshmitarit?

2 ZNJ. PUES: [Përkthim] Kam vetëm dy tema të shkurtra për
3 të cilat duhet të pyes dhe mbase për 15 minuta unë mbaroj, në
4 vartësi të përgjigjeve.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do të
6 shohim. Deri në pesë e gjysëm duhet të kemi mbaruar. Dhe duhet
7 të bëjmë atë që duhet.

8 Por së pari po pyes Mbrojtësin nëse do të bëjë pyetje të
9 tjera shtesë.

10 Z. VON BONE: [Përkthim] Nuk besoj.

11 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po e
13 provojmë një herë, po duke pasur parasysh se cilësia është
14 përpara shpejtësisë. Por do të ishte një mrekulli nëse arrijmë
15 ta përfundojmë sot. Por kohën e kemi të kufizuar.

16 Keni fjalën.

17 ZNJ. PUES: [Përkthim] Faleminderit.

18 Pyetje nga Mbrojtësja e Viktimave:

19 Py. Mirëdita z. Dëshmitar. Faleminderit për ato që na ke
20 thënë deri tani. Unë jam Mbrojtësja e Viktimave dhe kam pak
21 pyetje që rezultojnë nga këto që na the sot.

22 Si keni vendosur kontakt me Mbrojtjen?

23 Py. Më ka kontakti Mbrojtja, nëse s'gaboj Fatmir Pelaj më ka
24 thirrë.

25 Py. Në rregull. Kur të kanë kontakti për herë të parë?

1 Py. Nuk më kujtohet saktë.

2 Py. Këtë vit, vitin që shkoi?

3 Pë. Në shkurt 2022. Besoj një javë para se me u taku, q'ashtu
4 diçka a kanë thirrja e parë.

5 Py. Faleminderit. Atëherë është e saktë që deklarata jote
6 është marrë në 20 shkurt 2022?

7 Pë. Po.

8 Py. Faleminderit. Çdo dëshmitar tjetër i Mbrojtjes, shokët,
9 kolegë të tu, Selatin Krasniqi, e të tjerë, Brahim Mehmetaj
10 janë intervistuar nga shkurti, në shkurt 2021, një vit më
11 përpara. Në maj -- nga maji deri në shkurt 2021. Keni ndonjë
12 shpjegim juve për këtë?

13 Pë. Jo nuk kam shpjegim për atë. Unë jam kontakti domethënë
14 kam dhënë intervistën në shkurt 2022.

15 Py. Ose mos vallë keni nguruar që të diskutoni me ta sepse
16 keni pasur frikë se mos vetëinkriminoheshit me ato që do të
17 thoshit?

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Hiqi
19 pak ato dëgjueset, të lutem.

20 Z. SHALA: [Përkthim] Kjo pyetje është për Mbrojtjen, jo
21 për Dëshmitarin. Ne vendosëm se ku dhe kur të bënim deklaratë
22 -- kështu intervista me dëshmitarët dhe nuk duhet t'i
23 përgjigjet dëshmitar.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Më
25 lejo të mbaroj unë pastaj. Çfarë doni të thoni lidhur me këtë

1 pyetje.

2 Z. SHALA: [Përkthim] Ajo që dua të them është se nuk
3 është dëshmitari ai që vendos nëse do të japi apo dëshmi për
4 Mbrojtjen, përpara se ai të thërritet.

5 Pra, në kohën që ne e thirrëm ai vendosi që të jepte
6 dëshmi. Dhe kjo ndodhi në shkurt të këtij viti.

7 Pra nuk është çështje që i përgjigjet dëshmitari një
8 pyetje e tillë.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
10 Faleminderit për sqarimin. Tani ja jap fjalën Mbrojtëses së
11 Viktimave. Në qoftë se ajo mendon se kjo që thatë e sqaron
12 pyetjen e saj në rregull. Në qoftë se do që ta riformulojë
13 pyetjen ndryshe duke mos lënë - duke mos lënë të nënkuptojë
14 diçka apo mbase do të nënkuptojë diçka. Po jua lë ju në dorë
15 Mbrojtëse e Viktimave nëse mjafton kjo që u tha pra. Se e
16 morën me vonesën, e lajmëruan me vonesë.

17 ZNJ. PUES: [Përkthim] Do ta riformuloj pyetjen.

18 Py. Z. Dëshmitar, dëgjuam dhe për të qenë të drejtë, gjatë
19 dëshmime të mëparshme për shembull në 23 shtator 2021 dhe kjo
20 gjendet në transkriptin në faqen 728, për Trupin Gjykses se
21 një person që siç u tha është ndaluar është torturuar dhe më
22 vonë është vrarë në Zllash, ja dhanë ja dorëzuan një personi
23 me pseudonimin Shyti, Shutit. Dhe mbase kjo shpjegon pse ju
24 mund të keni nguruar të dëshmoni këtu më herët?

25 Pë. Jo s'kam nguruar me dëshmu. Momentin që më kanë kontaktuar

1 kam ardhë, domethënë. S'kam pasë ndonjë farë presioni, jam
2 ardhë me vetëdëshirë momentin që më ka kontakti Mbrojtja.
3 Py. Në rregull. Faleminderit po e lë me kaq dhe po kthehem
4 një teme tjetër. Ne dëgjuam sot më herët në momente të
5 ndryshme se në prill 1999, përpara largimit të të plagosurve
6 nga Zllashi se ju keni fjetur në Keçekoll në shtëpinë e axhës
7 apo të dajës që gjendet në faqen 53, rreshtat 16, 17 të
8 transkriptit dhe pastaj gjatë ditës ktheheshe në Zllash. Cila
9 ishte arsyeja, pse gjatë ditës ktheheshe në Zllash nga
10 Keçekolli?
11 Pë. Ma mirë me pyet pse ishte arsyeja që shkojshe në
12 Keçekollë. Arsyeja ishte për shkak se vendi ishte i mbingarkum
13 me njerz, kushtet ma të vështira me flejt edhe shkoja flejsha
14 te dajet. Edhe ma shumë arsyeja ka qenë pse jam shku. Unë kam
15 shku për shkak të kushteve. Edhe deshta me fjet ma shlirt edhe
16 prind i kam pasë në atë vend dhe për këtë jam shku.
17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
18 Pyetjet i vendos Mbrojtësja e Viktimave, jo juve.
19 DËSHMITARI: Më fal, [e pakuptueshme] Gjykatëse.
20 ZNJ. PUES: [Përkthim]:
21 Py. Pra cilat ishin detyrat apo arsyet përse ti ktheheshe në
22 Zllash gjatë ditës?
23 Py. Po ish -- arsyeja ishte me u kthy në zonën ku qëndronin
24 ushtarët, kurse natën shkojshe me fjete me prind, ditën u
25 kthesha edhe nuk ka pasë ndonjë aktivet përveç që e

1 ndihmojshim popullatës me i vendos me ndonjë fshat tjetër.

2 S'ka pasë ndonjë detyrë diçka kështu. Vetëm që u deshke me

3 ardh me qëndru ku janë ushtria jo me ndejt me një fshat

4 tjetër. A kanë afër aty.

5 Py. Sa për të qenë të qartë, je duke na thënë se nuk ke pasë

6 ndonjë detyrë konkrete në Zllash në prill 1999 në mes të

7 luftës?

8 Pë. Kurrfarë detyre diçka s'kam pas. Përveç si ditë të

9 zakonshme. Detyra kryesore kur ka kërcitë lufta jena kanë me

10 shku atje me mbrojt atë vijën e frontit në Marec. Që ajo a

11 kanë, domethënë detyrë tjetër s'kam pasë.

12 Py. Atëherë çfarë bëje ti gjatë ditës në Zllash? A mund të na

13 e përshkruash një ditë të zakonshme që kaloje në Zllash gjatë

14 pjesës së parë të prillit derisa u zhvendosën të plagosurit?

15 Çfarë bëje, si e kaloje ditën?

16 Pë. Ditën lëvizsha i nimojshim ndonjë popullatë, s'ka pasë

17 diçka. S'më kujtohet kështu konkretisht ndonjë kështu si ditë

18 të zakonshme. Veç lëvizshin njerëzit, ndonjë harxh vinte,

19 domethënë, bijshin njerëzit gjana ushqimore i shkarkojshim

20 ato. Kjo a kanë domethënë. Bishin domethënë traktorat me miell

21 ose me gjana ushqimore, që po më kujtohet për momentin.

22 Py. Atëherë a e përdornit atë hyrjen që na përshkrove ti në

23 këtë kompleksin për të pritur njerëzit apo për të marrë mallra

24 apo furnizime?

25 Py. Hyrja aty nuk më kujtohet ka i kanë prue, sigurisht nëse

- 1 a kanë ndonjë traktor [e pakuptueshme] anës së poshtme. A po
2 më kupton? A hi në derë në oborr i kena shkarku. Me këmbë ke
3 mujt me hy për një derë aty në mes të shtëpisë, nëse je ardhë
4 prej drejtimit të shkollës. Nëse je ardhë prej Prapashticës
5 dhe Marecit ke mund me hi poshtë. Ka pasë tri-katër mundësi.
6 Po nëse ka ardh diçka me ndonjë traktor [e pakuptueshme]
7 hyrjes poshtë a kanë ma e gjanë kështu ma --
- 8 Py. Në qoftë se vinte ndonjë person nga pjesa e poshtme, a
9 ishte ti një nga ata që e prisnit atë person për shembull?
- 10 Pë. Jo.
- 11 Py. Po traktorët ti i prisje?
- 12 Pë. Jo, jo [e pakuptueshme] aktivitetet the. Thashë nëse ka
13 ardh ndonjë traktor i kena ndihmu me i shkarku është fjala. A
14 po kupton. Nëse ka ardh ndonjë traktor diçka ndonjë detyrë
15 s'kena pasë kështu. Ato ditë ka qenë qetë deri me 16, ndoshta
16 nja dy ditë më vonë ja kanë nisë veç me lëvizë helikopter dhe
17 aty kena nisë me u bë gati domethënë, kur po na binë. Ajo
18 periudha domethënë, krejt noshta ça a kanë detyra me ardh me u
19 sjellë [e pakuptueshme] me na një katund tjetër ndonjë civil
20 është fjala, me ndihmu. Se ka ditë ku është Gllogovica, i kena
21 orientu. Nëse ka ardh me mall thashë e kena ndihmu me e
22 shkarku, ndonjë miell ose diçka kështu.
- 23 Py. Në Zllash, në atë kompleks ishte qetësi apo ishte shumë
24 rrëmujë njerëz?
- 25 Pë. Koha e prillit a kanë rrëmujë prej njerëzve.

Dëshmitari: Muhamet Ajeti (Seancë private)
Pyetje vijuese nga z. Von Bone

Faqe 175

1 Py. Faleminderit shumë z. Dëshmitar.

2 ZNJ. PUES: [Përkthim] Po e lë këtu. Faleminderit

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

4 Faleminderit Mbrojtësja e Viktimave.

5 Avokat keni ndonjë pyetje shtesë? E kemi kohën vërtetë
6 shumë të kufizuar, po të lutem vazhdo.

7 Z. VON BONE: [Përkthim] Pyetjen e parë e kam pra për
8 seancë private.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Të
10 kalojmë në seancë private ju lutem.

11 [Seancë private]

12 [Seancë private teksti i fshirë]

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3 [Seancë e hapur]

4 SEKRETARJA E GJYKATËS: [përkthim] Jemi në seancë të
5 hapur.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
7 mirë. Vazhdoni Mbrojtës.

8 Z. VON BONE: [Përkthim]:

9 Py. Z. Dëshmitar të ka marrë në pyetje Mbrojtja. Të mbahet
10 mend kjo apo jo?

11 Pë. Po.

12 Py. A të është afruar ndonjëherë dikush për të të thënë që të
13 thuash ndonjë gjë tjetër që s'ka të bëjë me të vërtetën,
14 lidhur me atë që ke përjetuar që ke dëgjuar apo që ke parë. Të
15 ka thënë njeri ndonjë herë, të është afruar njeri që të të
16 thonë "thuj këtë thuj atë"?

17 Pë. Jo mu kurrkush nuk më ka ardh me më thanë dhe se ka ditë
18 kurrkush që kam ma dhanë intervistë.

19 Py. Dhe i përmbahesh deklaratës që i ke dhënë Mbrojtjes?

20 Pë. Sigurisht ju kam përmbajt edhe pse ju nuk më keni thënë
21 masanej që me e mbajt konfidenciale që kam dhënë dëshmi. Por
22 të vetmit persona që kam diskutu është normal që bashkëshortes
23 i kam kallxu se është e pamundshme mos me i kallëzu gruas dhe
24 i kam tregu edhe vëllaut tem i cili gjendet në Gjermani. Është
25 më i madh, e kena si traditë me i njoftu njerëzit më të

1 mëdhenj. Ja kam tregu si ngjarje që kam me shku me dëshmu
2 konkret. Kurrqja, veç kaq a kanë. Kam me shku me dëshmu në
3 procesin e Salih Mustafës si dëshmitar i Mbrojtjes. Këtë send
4 jam kam thënë vëllaut dhe ja kam thënë grusë. Me njerëz të
5 tjerë nuk e kam përmend.

6 Py. Në rregull. A të ka ndiku njeri në ndonjë farë mënyrë
7 përpara se të vije këtu në Hagë për të dëshmuar në këtë
8 çështje?

9 Pë. Jo kurrkush.

10 Py. Faleminderit shumë.

11 [Përfaqësuesit e Mbrojtjes këshillohen]

12 Z. VON BONE: [Përkthim] Nuk kemi pyetje të tjera e
13 nderuar Gjykatëse.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
15 Faleminderit.

16 Keni pyetje? Ndoshta [e padëgjueshme].

17 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Një
19 minutë s'kemi më kohë. Duhet të përfundojmë. Po nëse keni
20 vetëm një pyetje ju lutem bëjeni.

21 Pyetje nga Trupi Gjykses:

22 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Faleminderit Gjykatëse
23 kryesore.

24 Z. Dëshmitar kam vetëm një pyetje, një sqarim në fakt. Më
25 20 prill u ktheve me të plagosurit në Zllash dhe pastaj të

1 nesërmen më 21 prill u largove nga kompleksi për të shkuar në
2 drejtim të Koliqit, kështu?

3 Pë. Në drejtim normal të Koliqit dhe në Majac.

4 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Faleminderit shumë. Nuk kam
5 pyetje të tjera.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
7 Faleminderit.

8 Ka ndonjë pyetje shtesë nga Prokuroria?

9 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Jo.

10 ZNJ. PUES: [Përkthim] As ne nuk kemi.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
12 Atëherë po e përmbledhim.

13 Z. Dëshmitar kemi ardhur në fund të dëshmisë tuaj. Ka
14 qenë një ditë intensive e lodhshme, nuk e mohoj dot. Dua të të
15 falënderoj për përpjekjet që ke bërë për dhënien e kësaj
16 dëshmie dhe jam e sigurt se do të na ndihmojë ne si Trup
17 Gjykes që të kuptojmë atë që ka ndodhur në atë kohë dhe të
18 gjejmë të vërtetën.

19 Ju uroj rrugë të mbarë në shtëpi dhe po ju them që nuk
20 duhet ta diskutoni dëshminë e dhënë përpara kësaj Gjykate me
21 askënd.

22 Faleminderit.

23 Do t'ju shoqërojë punonjësja e Gjykatës jashtë nga kjo
24 sallë.

25 DËSHMITARI: Faleminderit edhe prej ju z. Gjykatëse prej

1 të gjithëve edhe i përshëndes të gjithëve.

2 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
4 mirë. A ka ndonjë gjë tjetër që dëshironi ta ngrini?

5 Z. VON BONE: [Përkthim] Do ta informoj Trupin Gjykses për
6 diçka në seancat e tjera.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
8 mirë. Do të rifillojmë punën më 11 maj të mërkurën në orën
9 9.30 me dëshminë e dëshmitar 900 të Mbrojtjes.

10 I falënderoj palët, Mbrojtësen e Viktimave për praninë. I
11 falënderoj përkthyeset për durimin, punën e vështirë këtë javë
12 dhe stenografen. Ka qenë vërtetë shumë e ngarkuar. Falënderoj
13 personelin e sigurisë dhe të gjithë të tjerë.

14 Faleminderit. Dhe këtu mbarojmë.

15 --- Seanca mbyllet në orën 17.36

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25